



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“E Drejte Civile dhe Tregtare”

ofruar nga

Universiteti “Luarasi”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Ketsrin Katro

Prof. Asoc. Flutura Kola Tafaj

Mars / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkenave në “E drejtë civile dhe tregtare**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Luarasi”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i së Drejtës Private
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 490, datë 23.06.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 122, datë 16.05.2023
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 08, datë 24.01.2020
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit për vitin akademik 2023 - 2024	7 PAE / 2 PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023 47 studentë; 2023-2024 15 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Luarasi" (në vijim UL) është themeluar në vitin 2003, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 611, datë 11.09.2003, "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Luarasi" dhe ka nisur veprimtarinë e tij akademike në vitin 2003-2004 fillimisht me Fakultetin e Drejtësisë me një program studimi, për të vijuar me hapjen e disa programe të tjera të ciklit të parë dhe të dytë. Me Urdhërin Nr. 494, datë 11.10.2019 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë është bërë riorganizimi institucional i Kolegjit Universitar "Luarasi" në Universiteti "Luarasi". Me Urdhërin Nr. 71, datë 18.02.2008, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës "Për akreditimin institucional, të programit dhe diplomës të SHLUJ Luarasi", është realizuar akreditimi i parë institucional si edhe akreditimi i programit të studimit të Ciklit të parë dhe Diplomës me titull "Jurist". UL është riorganizuar sipas Rregullores së UL-s (neni 6) në 4 njësi kryesore, si më poshtë:

1. Fakulteti i Drejtësisë (FD);
2. Fakulteti i Ekonomisë (FE) ;
3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore (FSHM);
4. Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit dhe Inovacionit (FTII);

Fakulteti i Drejtësisë është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe veprimtaritë kërkimore-shkencore në fushën e studimeve në drejtësi. FD-ja ofron programe në të gjitha ciklet e studimit në fushën e drejtësisë. Fakulteti i Drejtësisë në UL përbëhet nga 3 njësi bazë, që janë:

1. Departamenti i të Drejtës Private;
2. Departamenti i të Drejtës Publike;
3. Departamenti i të Drejtës Penale;

Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Civile dhe Tregtare" (në vijim MSHDCT) është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 490, datë 23.06.2010 "Për hapjen e programeve të reja të studimeve, në Shkollën e Lartë Universitare Private "Luarasi".

Me Urdhër Nr. 323, datë 15.08.2013 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës është bërë akreditimi i parë i programit "Master i Shkencave" në "E Drejtë Civile dhe Tregtare", dhe me Vendim të Bordit të Akreditimit (në vijim VBA) Nr. 08, datë 24.01.2020 është riakredituar ky program për një kohëzgjatje akreditimi prej 4 vitesh, deri në datën 30.09.2024.

Me anë të shkresës me nr. 266 prot, datë 02.10.2023, UL ka përcjellë në ASCAL aplikimin për riakreditimin e programit. Departamenti i të Drejtës Private është njësi bazë përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Civile dhe Tregtare". Ky program studimi është organizuar në lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje, të vlerësuara në kredite, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", (i ndryshuar), si dhe udhëzimeve dhe akteve të tjera të MASR.

Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale dy vite akademike (*katër semestra*), në përfundim të të cilit studentët pajisen me diplomë të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në "E Drejtë Civile dhe Tregtare". Ky program studimi synon edukimin dhe kualifikimi shkencor të studentëve në fushën e së drejtës civile dhe tregtare, përmes integritetit të dijeve në auditor me praktikën në institucionet e zbatimit të ligjit, shoqëri tregtare, administratë publike etj. Në zbatim të ligjit 80/2015, UL ka një Plan strategjik të zhvillimit të Institucionit i cili është dhe dokumenti bazë ku përcaktohen objektivat e institucionit të arsimit të lartë apo të njësisë përbërëse si dhe mënyrat për realizimin e tyre.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Në datën 03.10.2023, me anë të shkresës me nr. 266 prot, datë 02.10.2023, Universiteti "Luarasi" (UL) ka dorëzuar pranë ASCAL formularin e aplikimit për akreditimin e programit të studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Civile dhe Tregtare". ASCAL bazuar në "*Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017*" ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UL, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje **Prof. Dr. Kestrin Katro** pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Departamenti i të Drejtës Civile dhe **Prof. Assoc. Flutura Kola Tafaj**, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Departamenti i të Drejtës Civile. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Msc. Majlinda Demirmeli.

Ekspertët e jashtëm u pajisën respektivisht me kodet e hyrjes në sistemin e ASCAL ku lehtësisht u aksesuan të gjithë dokumnetat e paraqitur nga UL në lidhje me procedurën e akreditimit të programit. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe axhenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datat 9 dhe 10 Tetor 2024 në ambientet e UL-s. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas axhendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët pas vizitës në Institucion u vu në dispozicion në sistemin e informacionit të ASCAL respektivisht në datat 14, dhe 18 Tetor 2024.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave të zhvilluara me pedagogë dhe studentë në ambjentet e Institucionit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) paraqet si më poshtë vlerësimin e tij për programin e studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Civile dhe Tregtare".



Në përmbyllje të raportit, paraqiten rekomandimet për institucionin dhe një analizë e pikave të forta dhe të dobëta të këtij programi studimi. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Universiteti "Luarasi" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 24.01.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 54. Prot, datë 24.01.2025. Universiteti "Luarasi" njofton nëpërmjet sistemit më datë 20.02.2025, se nuk ka komente mbi draft raportin. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr 08 datë 24.01.2020 janë si vijon:

1. Institucioni të realizojë një studim të mirëfilltë mbi nevojat reale të tregut të punës për këtë program studimi, me qëllim që programi t'i përgjigjet sa më mirë tregut;

Plotësimi i rekomandimit nga Institucioni

Nga studimi i dokumenteve të paraqitura nga Institucioni, konstatohet se programi është në përputhje të plotë me Strategjinë kombëtare të zhvillimit të arsimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit. Kurrikula është hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojën e tregut shqiptar për juristë të kualifikuar në të drejtën civile dhe tregtare. Në Rregulloren e programit Master i shkencave në "E Drejtë Civile dhe Tregtare", parashikohet shprehimisht objektivi i programit që të jetë në përputhje me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë sipas specifikimeve në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe programi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit. Në dokumentet e paraqitura GVJ konstatoi statistika shumë positive në lidhje me punësimin e të diplomuarve në këtë program studimi,¹ dhe Institucioni ka bërë një studim të mirëfilltë mbi nevojat reale të tregut të punës për të diplomuarit në këtë program studimi². GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

¹ Evidenca nr. 51 Alumni MSc Civile dhe Tregtare

² Evidenca nr 37 Studim i tregut të punës

2. Institucioni, të marrë masa për pasurimin e fondit fizik të teksteve në bibliotekë me tituj të përditësuar dhe literaturë ndërkombëtare bashkëkohore, të sigurojë në bibliotekë të gjithë titujt e detyrueshëm të programit të studimit, si dhe të përmirësojë infrastrukturën fizike të bibliotekës;

Plotësimi i rekomandimit nga Institucioni

Referuar dokumentave shoqëruese të RVB, GVJ konstatoi që për të gjithë lëndët që zhvillohen në këtë program studimi vihet në dispozicion të studentëve literaturë kryesisht në gjuhën e programit (shqip). Gjatë vizitës në bibliotekë u konstatua edhe literaturë ndihmëse në gjuhë të huaj (kryesisht anglisht) në formë hard copy dhe digitale.³

Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UL vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar në këtë program studimi bibliotekën e cila ndodhet në katin e tretë me sipërfaqe prej 43 m², si sallë studimi, për 20 persona me akses të palimituar në internet. GVJ është i vetëdijshëm për faktin që në ditët e sotme era digitale është shumë prezente në përditshmërinë tonë dhe nëpërmjet bibliotekave online aksesit në literaturën e kërkuar është i kudogjendur. Duke qënë se numri i studentëve të programit të studimit “Master i Shkencave” nuk është shumë i lartë, për këtë program studimi gjykojmë që aksesit në infrastrukturën e bibliotekës së institucionit mund të konsiderohet i pranueshëm. **GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur kryesisht.**

3. Institucioni, të përditësojë rregulloren e programit të studimit, duke reflektuar në të gjuhën e huaj si kriter hyrës të studentëve;

Plotësimi i rekomandimit nga Institucioni

GVJ konstaton se, ndërkohë që Statuti i UL-s, dhe Rregullorja e Fakultetit të Drejtësisë (neni 31) parashikojnë gjuhën e huaj si kriter hyrës të studentëve në program të ciklit të dytë, ky kriter nuk reflektohet në Programin e Masterit Shkencor në “E Drejtë Civile dhe Tregtare” Nga kontrolli i ushtruar në dosjet e disa studentëve gjatë vizitës në Institucion, si dhe në një dosje të përfshirë në DVV konstatohet qartazi që ky kriter zbatohet nga Institucioni. **GVJ vlerëson se ky rekomandim vetëm formalisht nuk është përmbushur.**

4. Institucioni, të hartojë strategjinë e kërkimit ku të përcaktohen shtyllat kryesore të kërkimit shkencor për të patur sinergji midis stafit akademik të këtij programi studimi për kërkimin

³ Evidenca - Database i bibliotekës së Universitetit Luarasi

shkencor, si dhe të marrë masa për përmirësimin sasior dhe cilësor të kërkimit shkencor e botimin në revista prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare;

Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Në zbatim të ligjit 80/2015, UL (*me Vendim të Senatit Akademik*) ka miratuar një Plan të Zhvillimit Strategjik të Institucionit (2020-2025)⁴, i cili është dhe dokumenti bazë ku përcaktohen objektivat e institucionit të arsimit të lartë apo të njësive përbërëse. Në bazë të këtij Plani, UL ka marrë përsipër t'u ofrojë studentëve dhe shoqërisë një qendër edukimi që integron plotësisht tre drejtimit bazë të procesit akademik: Mësimdhënie cilësore, Dije të qëndrueshme dhe Kërkimin shkencor dhe Inovacion (MDKI-UL). Këto përgjegjësi janë në përputhje të plotë si me prioritetet e zhvillimit të vendit, ashtu edhe me sfidat globale të shekullit që po jetojmë, duke kontribuar, si në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë shqiptare, ashtu edhe në rritjen e standardeve të demokracisë në vend. Statuti i UL-s parashikon shprehimisht që misioni i i këtij institucioni është që të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal (*neni 2*) dhe garanton lirinë akademike (*neni 3*)

Njësia kryesore (FD) i jep një vëmendje të vecantë kërkimit shkencor, duke parashikuar shprehimisht në Rregulloren e saj (*neni 11*) ngritjen e një Komisioni të përhershëm për kërkimin dhe zhvillimin shkencor. Në Rregulloren e Departamentit të së Drejtës Private parashikohet shprehimisht roli i Departamentit për të nxitur, bashkërenduar dhe administruar veprimtaritë mësimdhënëse dhe veprimtaritë e kërkimit shkencorë, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet material dhe financiare në dispozicion të departamentit (*neni 4*).

Në *nenin 4* të Rregulloreve të programit MSHDCT parashikohet shprehimisht që "ky program përputhet me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Shqipëri sipas specifikimeve në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor, si dhe me Strategjinë për zhvillim të UL-s. Dokumenti tregues i planifikimit të kërkimit shkencor ishte i pasur dhe nga dokumente të tjera (si conference proceedings, lista e aktiviteteve shkencore etj) u konstatua zbatueshmëria e tyre.

Gjatë vizitës, stafi akademik u shpreh se kishte gjithë mbështetjen e nevojshme për rritjen akademike të tyre si nëpërmjet kërkimit shkencor ashtu edhe projekte apo aktivitete të tjera në fushën e mësimdhënies. Bazuar në përshkrimin dhe ndarjen e detyrave dhe të përgjegjësi, GVJ konstaton se njësia kryesore dhe ajo bazë u japin lirinë dhe nxitjen e nevojshme stafit akademik për zhvillimin e aktiviteteve didaktike dhe kërkimore e shkencore të programit të studimit. **GVJ e vlerëson këtë rekomandim të përmbushur plotësisht.**

⁴ *Plani i Zhvillimit Strategjik të UL*

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “E Drejtë Civile dhe Tregtare”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Referuar Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 (fq. 90-111), qëllimi i politikës kombëtare është që arsimit të lartë të jetë gjithëpërfshirës dhe të plotësojë standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës, dhe të jetë promotor i zhvillimit ekonomik. Më konkretisht kjo strategji është zbërthyer në disa objektiva specifike që përmbledhtas janë: Rritja e cilësisë së arsimit të lartë nëpërmjet riorganizimit të programeve të studimit; Nxitja e përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor; Ndërlidhja më e mirë e arsimit të lartë me tregun e punës; Sigurimi i integritetit akademik, transparencës dhe llogaridhënie; Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë dhe integrimi në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) etj; Në Rregulloren e programit Master i shkencave në “E drejtë Civile dhe Tregtare, parashikohet shprehimisht objektivi i programit që të jetë në përputhje me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë sipas specifikimeve në Ligjin për Arsimin e Lartë (neni 4 (1) (a). Sipas kësaj Rregulloreje, programi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare (neni 4(1)c)). Programi ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, njohuritë dhe aftësitë profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij.

	Referencë: <i>Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026</i> <i>Rregullore e programit Master i Shkencave "E drejtë Civile dhe Tregtare"</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Universiteti "Luarasi" (UL) ka si mision të përcjellë dije përmes mësimdhënies dhe të nxis kërkim shkencor në përputhje me Standardet e Hapsësirës Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL). (neni 2 i Statutit të UL-s) Objektiva të tjera të UL-s janë: përsosja dhe konsolidimi i formimit akademik, si dhe zgjidhja e problemeve të rëndësishme kërkimore shkencore në shkallë vendi dhe rajoni. Krijimi i një universiteti në shërbim të vlerave më të larta njerëzore, promotor të zhvillimeve, me shërbime cilësore dhe të integruara në të gjithë Shqipërinë është një tjetër objektivi i UL-s. (Plani i Zhvillimit Strategjik fq. 5) Departamenti si njësi bazë për zhvillimin e programit Master i Shkencave në "E drejtë Civile dhe Tregtare" nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. (Rregullore e Departamentit të së Drejtës Private, neni 3). Programi është në përputhje të plotë me qëllimin dhe misionin e UL-s. Referencë: <i>Statuti i UL-s</i> <i>Plani i Zhvillimit Strategjik të UL</i> <i>Rregullore e Departamentit të së Drejtës Private</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.	Në zbatim të ligjit 80/2015, UL (me Vendim të Senatit Akademik) ka miratuar një Plan të Zhvillimit Strategjik të Institucionit (2020-2025), i cili është dhe dokumenti bazë ku përcaktohen objektivat e institucionit të arsimit të lartë apo të njësive përbërëse. Në bazë të këtij Plani, UL ka marrë përsipër t'u ofrojë studentëve dhe shoqërisë një qendër edukimi që integron plotësisht tre drejtimit bazë të procesit akademik: Mësimdhënie cilësore, Dije të qëndrueshme dhe Kërkimin shkencor dhe Inovacion (MDKI-UL).

	Këto përgjegjësi janë në përputhje të plotë si me prioritetet e zhvillimit të vendit, ashtu edhe me sfidat globale të shekullit që po jetojmë, duke kontribuar, si në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë shqiptare, ashtu edhe në rritjen e standardeve të demokracisë në vend. Statuti i UL-s parashikon shprehimisht që misioni i këtij institucioni është që të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal (<i>neni 2</i>) dhe garanton lirinë akademike (<i>neni 3</i>) Në Rregulloren e UL-s parashikohet e drejta e UL-s për të hapur, ndër të tjera, edhe programe të ciklit të dytë (<i>neni 4</i>), të cilët pajisin studentët me njohuri të thelluara teorike, si dhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe duhet të realizohen me jo më pak se 120 ECTS (<i>neni 58</i>) dhe Masteri i Shkencave në “E drejtë Civile dhe Tregtare” realizohet me 120 ECTS. Referenca: <i>Statuti i UL-s</i> <i>Plani i Zhvillimit Strategjik të UL</i> <i>Rregullore e Departamentit të së Drejtës Private</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Referuar Strategjise Kombëtare të Arsimit 2021-2026, qëllimi politikës kombëtare është arsimi i lartë të jetë gjithëpërfshirës dhe të plotësojë standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës, dhe të jetë promotor i zhvillimit ekonomik. Më konkretisht kjo strategji është zbërthyer në disa objektiva specifike që përmbledhtas janë: Rritja e cilësisë së arsimit të lartë nëpërmjet riorganizimit të programeve të studimit; Rritja e cilësisë së arsimit të lartë nëpërmjet riorganizimit të programeve të studimit; Nxitja e përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor; Ndërlidhja më e mirë e arsimit të lartë me tregun e punës; Sigurimi i integritetit akademik, transparencës dhe llogaridhënie;

	Ndërkombtarizimi i arsimit të lartë dhe integrimi në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) etj; Rregullorja e Programit të studimit MSHDCT mbështetet në ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin dhe Rregulloren e UL-s dhe të Departamentit të së Dretës Private. Programi është hartuar është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare. Ky program studimi ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij; ky program studimi është organizuar në lëndë, ku secila nga lëndët është e vlerësuar me kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Disa objektiva specifike të këtij programi studimi janë: 1. Tu japë studentëve njohuritë dhe formimin e tyre si specialistë në fushën e të drejtës civile dhe tregtare; 2. Formimi i ekspertëve dhe specialistëve në aspektet teorike ashtu edhe në aftësitë aplikative në fushën e së drejtës civile dhe tregtare; 3. Pajisja e studentëve me njohuritë themelore teorike, njohje e thelluar e praktikave bashkëkohore ndërkombëtare si dhe eksperiencës shqiptare në fushën e së drejtës së biznesit, të drejtave reale dhe trashëgimore, të drejtës evropiane private; etj; 4. Njohuri në disa fusha të reja të së drejtës dhe biznesit, praktikat e të cilave janë risi, sepse duke u bazuar në ndryshimet thelbësore të aktualitetit të së drejtës, këto fusha bëhen të domosdoshme për mirëqënien dhe ekonominë e komunitetit, si psh: njohuritë që jepen mbi sistemin bankar, pronësinë intelektuale dhe ate të falimentimit; Referencë: <i>Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026, fq. 90-111</i> Gjendet:
--	---

	<i>Rregullore e Programit të Ciklit të Dytë të Studimit, Master i Shkencave në "E Drejtë Civile dhe Tregtare"</i>			
Konkluzione	<i>Në vlerësimin e GVJ, programi i studimit MSHDCT është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit dhe synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. Programi është në përputhje të plotë me Strategjinë kombëtare të zhvillimit të arsimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit. Kurrikula është hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojën e tregut shqiptar për juristë të kualifikuar në të drejtën civile dhe tregtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Universiteti "Luarasi" (UL) është themeluar në vitin 2003, me VKM Nr. 611, datë 11.09.2003, "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Luarasi" dhe ka nisur veprimtarinë e tij akademike në vitin 2003-2004 fillimisht me Fakultetin e Drejtësisë me një program studimi, për të vijuar me hapjen e disa programe të tjera të ciklit të parë dhe të dytë. I themeluar 20 vite më parë, Fakulteti i Drejtësisë së UL-s që është përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Civile dhe Tregtare" ka një histori të gjatë në fushën akademike në Republikën e Shqipërisë, duke ofruar programe studimi të ciklit të parë "Bachelor në Drejtësi" dhe programe studimi të ciklit të dytë "PIND në Drejtësi", Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", Master Profesional në "Rendi dhe Siguria", si dhe programin Master i Shkencave në "E Drejtë Civile dhe Tregtare". Fakulteti i Drejtësisë, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2023-2024 ka gjithsej 36

pedagogë, nga të cilët 23 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 13 pedagogë me kontratë (PAK) me kualifikimin e mëposhtëm:

Personeli akademik pranë Fakultetit të Drejtësisë

Grada/titulli	PAE	PAK
Prof.Dr	1	1
Prof.Asoc.	4	2
Dr.	18	9
Msc	-	1
Gjithsej	23	13

Departamenti i të drejtës private që ofron këtë program studimi për vitin akademik 2023-2024 ka gjithsej 9 pedagogë, nga të cilët 7 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 2 pedagogë me kontratë (PAK) me kualifikimin e mëposhtëm:

Personeli akademik pranë Departamentit të së Drejtës Private

Grada/titulli	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-
Prof.Asoc.	-	-
Dr.	9	2
Msc	-	-
Gjithsej	9	2

Për zhvillimin e këtij programi, FD ka angazhuar pedagogë nga Departamenti i të Drejtës Private dhe Departamenti i të Drejtës Publike. Referuar dosjeve (CV) të personelit të angazhuar në programin e studimit, kualifikimet e tyre vitet e fundit dhe trajnimet jashtë vendit, përputhshmërinë e formimit të stafit me angazhimin e tyre pranë departamentit, Institucioni demonstroi se ka burime njerëzore të nevojshme dhe të kualifikuara për të ofruar programe studimi në këtë fushë.

Referencë:

	<i>CV e stafit akademik të angazhuar në programin MSHDCT</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Njësia kryesore për zbatimin e programit Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare” është Fakulteti i Drejtësisë. FD është njësia kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe veprimtaritë kërkimore-shkencore në fushën e studimeve në drejtësi. FD ofron programe në të gjitha ciklet e studimit në fushën e drejtësisë, të hapura dhe të akredituara në përputhje me aktet ligjore në fuqi. (neni 8(1) i Statutit të UL). Për rrjedhojë, në vlerësimin e GVJ-së, edhe programi Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare” është hapur dhe zhvillohet tërësisht në përputhje me fushën e veprimtarisë së Fakultetit të Drejtësisë të UL-s. Referencë: <i>Statuti i UL-s</i> <i>Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë</i> <i>Rregullore e Programit të Ciklit të Dytë të Studimit “Master i Shkencave” në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Njësia bazë për programin e studimit është Departamenti i të Drejtës Private. Qëllimi i këtij Departamenti “është krijimi, transmetimi, zhvillimi, mbrojtja e dijeve nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve” (neni 3.2 i Rregullores). Misioni i Departamentit lidhet me garantimin e cilësisë dhe plotësimin e standardeve akademike për të gjitha programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimit, si edhe nxit dhe mbështet aktiviteti akademik e shkencor të pedagogëve dhe studentëve. Po ashtu, “Departamenti bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore shkencore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe të drejtën për të shfrytëzuar burimet material dhe financiare në dispozicion të departamentit”. (neni 4 i Rregullores) Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare” përcaktohet në nenin 4 të Rregullores së programit, sipas të cilit, ky program studimi ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentet për

	tu aftësuar në fushën e të drejtës civile dhe tregtare. Nëpërmjet këtij programi, synohet jo vetëm përgatitja e ekspertëve dhe specialistëve me aspektet teorike të ligjit, por edhe aftësimi praktik i tyre në fushën e së drejtës civile dhe tregtare, dhe më konkretisht në të drejtën e biznesit, të drejtat reale dhe trashëgimore, të drejtën evropiane private, të drejtën bankare, falimentin, arbitrazhin etj. Referencë: <i>Rregullore e Departamentit të së Drejtës Private (Evidenca 16)</i> <i>Rregullore e Programit të Ciklit të Dytë të Studimit "Master i Shkencave" në "E Drejtë Civile dhe Tregtare"</i>			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	N / A			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	N / A			
Konkluzione	<i>GVJ gjen përputhje të plotë mes fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit MSHDCT dhe fushës akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, Fakultetit të Drejtësisë dhe njësisë bazë, Departamentit të së Drejtës Private.</i> <i>Mbështetja profesionale dhe përfshirja e stafit akademik nga njësia bazë garanton cilësi dhe koherencë në ofrimin e programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Dokumentacioni i vendosur në dispozicion të GVJ për këtë kriter ishte i plotë dhe gjithëpërfshirës duke përfshirë statutin dhe rregullore të të gjitha niveleve (Institucionale, njësi kryesore, njësi bazë, program studimit) që mbulonin pothuajse cdo aspekt të organizimit të detyrave dhe përgjegjësiwe në funksion të mbarëvajtjes së aktiviteteve të programit të studimit. Bashkëpunimi përbrenda personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ përshkruhet qartë në Statutin e Institucionit dhe Rregulloret e funksionimit në nivel institucioni, njësi kryesore dhe njësi bazë, si edhe në rregulloren e programit të studimit, dhe të gjitha këto ishin, në opinionin e GVJ, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015. Departamenti i të Drejtës Private, si njësi bazë përgjegjëse, siguron realizimin sasior dhe cilësor të zhvillimit të programit mësimor. Nga rezultatet e analizës vjetore të veprimtarsisë së FD-s, si dhe në raportin vjetor mbi veprimtarinë akademike të UL-s, vlerësohet realizimi i objektivave të programit të studimit dhe problematikat për të ardhmen. Bashkëpunimi i njësive bazë dhe njësive kryesore realizohet në përputhje me nivelin hierarkik të përcaktuar në strukturën organizative të FD (<i>neni 5 e më tej të Rregullores së FD-s</i>) Referencë: <i>Statuti i UL-s</i> <i>Rregullorja e FD-s</i> <i>Organigrama e UL-s</i>

	<i>Organigrama e Fakultetit të Drejtësisë</i> <i>Raporti vjetor i veprimtarisë së FD-s, vitit akademik 2023-2024</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Nga dokumentacioni i konsultuar, rezulton se UL ka nënshkruar disa marrëveshje me institucione homologe brenda dhe jashtë. Disa prej tyre janë: Marrëveshje me subjekte jashtë vendit, si më poshtë (por jo vetëm): • Marrëveshje bashkëpunimi me Eëstern Balkan Fund • Marrëveshje në kuadër të programit Erasmus (2019-2020) me Pan European University, Universiteti Politeknik Bari Itay, Universiteti i Foxhias, Itali, Universiteti i Bolonjës Itali etj); Marrëveshje me subjekte brenda vendit si më poshtë (por jo vetëm): • Akademia e Sigurisë; • Autoriteti i Mbyqyrjes Financiare; • Universiteti "A. Moisiu", Durrës; • Universiteti Luigj Gurakuqi Shkodër etj; Këto marrëveshje parashikojnë shkëmbim personeli akademik, kryerje praktikash të studentëve, organizim konferencash shkencore etj. Referencë: <i>Marrëveshje bashkëpunimi me Eëstern Balkan Fund (Evidence 22 &44)</i> <i>Marrëveshje në kuadër të programit Erasmus (Evidenca 52)</i> <i>Marrëveshje me Institucione dhe organizata bashkëpunuese (Evidenca 24)</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për	UL ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me kompani shqiptare dhe të huaja, të cilat mundësojnë realizimin e praktikave mësimore të studentëve të programit MSHDCT. Për të realizuar një praktikë efektive dhe të dobishme, UL ka miratuar në Senatin akademik një udhëzues për realizimin e praktikës profesionale. Në varësi të programit të studimit, këto praktika janë realizuar pranë zyrave ligjore, noteriale,

realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	kompanive, bankave, shoqërive të sigurimeve, institucione publike etj. Më konkretisht, UL ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave të studentëve me subjektet e mëposhtëme (<i>po jo vetëm</i>): • Tetra Solutions/CCS • SiCREA DHA • PROTIK • ICT Media • Kontrolli i Lartë I Shtetit • DITAK shp • Hysenbelliu Group • Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike etj UL ka hartuar një udhëzues për zhvillimin e praktikave profesionale, i cili është miratuar nga Senati akademik I UL-s. Sipas këtij udhëzimi, Strukturat përgjegjëse për ndjekjen e praktikës janë: - Njësitë kryesore dhe njësitë bazë të UL-s nëpërmjet zbatimit të ekërkesave dhe detyrimeve të planeve mësimore, lidhur me praktikën; - Departamentet nëpërmjet caktimit të pedagogëve përgjegjës për ndjekjen e studentëve gjatë praktikës dhe menaxhimit të procesit që nga momenti i caktimit të studentëve në institucione/organizata/kompani e deri në vlerësimin e tyre me notë; - Departamentet nëpërmjet caktimit të pedagogëve që do të zhvillojnë orët në auditor për praktikën - Pedagogët përgjegjës për ndjekjen e zhvillimit të praktikës së studentëve, nëpërmjet kontrollit të zbatimit të ekërkesave të udhëzuesit për zhvillimin e praktikës; - Komisioni i marrjes në provim të studentëve nëpërmjet vlerësimit të njohurive të studentëve përsa i përket përmbajtjes së udhëzuesit për zhvillimin e praktikës; - Zyra e Zhvillimit të Karrierës dhe Zyra e Studentit, nëpërmjet parapërgatitjes së studentëve për procesin e praktikës dhe caktimin e tyre në institucione/organizata/kompani.
--	---

	Referencë: <i>Marrëveshje me Institucione dhe organizata bashkëpunuese (Evidenca 24)</i> <i>Udhëzues për realizimin e praktikës profesionale (Evidence 23)</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Praktikat e studentëve mbikqyren nga punëdhënësit e qendrave ku kryhet praktika, të cilët nënshkruajnë edhe një raport për mënyrën e zhvillimit të praktikës. Njësia ka përgatitur një model raporti TIP (formular), i cili plotësohet nga studenti dhe dorëzohet pranë sekretarisë së njësisë kryesore (FD) pasi është firmosur nga mbikqyrësi në vendin e praktikës dhe pasi është marrë vula e institucionit përkatës. Ky Raport përcillet për vlerësim në Komisionin e Vlerësimit. Njëkohësisht praktika mësimore monitorohet nga Përgjegjësi i Departamentit të së Drejtës private ose një pedagog i caktuar nga ky i fundit. <i>Nga konsultimi me raportin vjetor të Departamentit të së Drejtës private nuk u konstatua raportim konkret në lidhje me zhvillimin e praktikës mësimore, pavarësisht se në përputhje me nenin 7 të Udhëzimit për realizimin e praktikës profesionale ata kanë një rol të rëndësishëm në zbatimin e praktikave mësimore profesionale.</i> FD si njësi kryesore në mbështetje të njësisë bazë, harton analizën vjetore mbi mbarëvajtjen e marrëveshjeve, ku evidenton marrëveshjet e zbatueshme për vitin akademik, llojin e bashkëpunimit (psh shkëmbim studentësh, praktika mësimore, etj), pikat e forta dhe të dobëta të këtij bashkëpunimi, dhe për rrjedhojë nevojën për ndryshimë apo përmirësime. GVJ konstaton se FD ka përfshirë në raport analizën e marrëveshjeve konkrete të realizuara. (<i>Raporti i FD 2022-2023 faqe 20-23</i>) Raporti i FD-s bëhet pjesë e raportit të UL-s i cili miratohet nga Senati akademik i UL-s. Hartimi i raportit vjetor të UL-s mbështetet në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe Udhëzimin Nr. 5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 24, datë 21.10.2019.

	Referencë: <i>Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Fianciare të UL-s 2022-2023 fq. 28 (Evidenca 20)</i> <i>Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike të FD-s 2022-2023 fq. 22-23 (Evidenca 19)</i> <i>Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike të Departamentit të së Drejtës Private 2022-2023 (Evidenca 26)</i> <i>Model raporti TIP për kryerjen e praktikës profesionale</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UL ka realizuar me sukses organizimin eficient të ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi për të garantuar mbarëvajtjen e aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe shkencore në funksion të programit të studimit MSHDCT.</i> <i>UL disponon një një listë të pasur të marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë, IAL dhe shoqëri biznesi nëpërmjet të cilëve siguron zhvillimin e praktikave profesionale për studentët e programit MSHDCT.</i> <i>FD raporton në mënyrë korrekte periodike (vjetore) për ecurinë e këtyre marrëveshjeve. Raportimet duhet të jenë pjesë e raportit vjetor edhe të Departamentit të së Drejtës Private, në zbatim të nenit 7 të Udhëzimit për realizimin e praktikës profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave “E Drejtë Civile dhe Tregtare” është miratuar nga Senati Akademik i UL-s dhe zhvillohet për një kohëzgjatje prej 2 vite akademike (4 semestra). Ky program ka 120 ECTS dhe forma e studimit është me kohë të plotë. Procesi mësimor organizohet në vite akademike. Viti akademik zgjat normalisht 30 jave mësimore. Studenti zhvillon jo më shumë se 25 orë mësimore në auditor/javë. <i>(Neni 5 i Rregullores së MSHDCT)</i> Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit janë të organizuara në 5 kategori, nga A - E, në përputhje me VKM nr. 41/2018 të ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr. 185/2021 <i>(neni 6 i Rregullores së MSHDCT)</i> Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, C, D dhe E janë të ndërthurura, të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe vlerësohen secila me kredite. (Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr. 185/2021, Tabela nr 1, për programet e Masterit Shkencor, në kategorinë A ku bëjnë pjesë lëndët bazë dhe disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme duhet të kenë 5 – 10% të krediteve; në kategorinë B, që janë lëndët karakterizuese, përfshihen disiplina të formimit karakterizues të programit për përgatitje shkencore dhe duhet të ketë 50 – 60% të krediteve; në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore dhe integruese, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje dhe duhet të ketë 12 – 20% të krediteve; në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si dhe praktika profesionale dhe duhet të ketë 10% të krediteve. Ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmbyllëse për diplomim dhe duhet të ketë 10 – 15% të krediteve.) Në këtë program: • Lëndët e detyrueshme janë të vlerësuara me nga 6-8 dhe 10 kredite (ECTS); • Lëndët me zgjedhje janë vlerësuar me nga 6 kredite (ECTS); • Punimi i diplomës është vlerësuar me 18 ECTS; • Praktika mësimore vlerësohet me 12 ECTS;

	Referencë: <i>Tabelat përmbledhëse e RVB-se për programin e studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Civile dhe Tregtare. (Evidenca Anex)</i> <i>Plani mësimor i programit të studimit (Evidenca 27)</i> <i>Rregullore e Programit të Ciklit të Dytë të Studimit "Master i Shkencave" në "E Drejtë Civile dhe Tregtare" (Evidenca 10)</i> <i>Vendimi i Bordit të Akreditimit nr. 08, datë 24.01.2020</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	GVJ konstaton se rregullorja e programit të studimit MSHDCT në UL (neni 4) parashikon se ky program studimi synon: a) t'u japë studentëve njohuritë e formimin e tyre si specialistë në fushën e të drejtës civile dhe tregtare; b) formimin e ekspertëve dhe specialistëve në aspektet teorike, ashtu edhe aftësitë aplikative në fushën e së drejtës civile dhe tregtare; c) pajisjen e tyre me njohuritë themelore teorike, njohje e thelluar e debateve dhe praktikave bashkëkohore ndërkombëtare si dhe eksperiencës shqiptare në fushën e së drejtës së biznesit, të drejtave reale dhe trashëgimore, të drejtës evropiane private, etj; d) marrjen e njohurive në disa sektorë të rinj të së drejtës dhe biznesit, praktikat e të cilave janë risi, pasi duke u bazuar në ndryshimet thelbësore të aktualitetit të së drejtës këto fusha bëhen të domosdoshme për mirëqënien dhe ekonominë e komunitetit (psh njohuritë mbi sistemin bankar, pronësinë intelektuale dhe atë të falimentimit); Për të gjykuar mbi shkallën e arritshmërisë së këtyre synimeve dhe objektivave të programit të studimit, GVJ shqyrtoi Planin Mësimor dhe syllabuset përkatëse. GVJ është e mendimit se tërësia e moduleve dhe lëndëve të organizuara në kurrikulën e këtij programi (tabelat e RVB), me larminë e tyre dhe me ngarkesën e parashikuar mundësojnë përmbushjen e synimeve dhe objektivave të përmendura në rregulloren e programit. <i>GVJ vëren se në pothuajse të gjitha lëndët (kategoritë, A, B, C, D) janë parashikuar më shumë orë leksioni kundrejt seminareve, cka, në vlerësimin e GVJ e kufizon pjesërisht kohën e studentëve</i>

	<i>për t'u praktikuar në cdo lëndë.</i> Lidhur me këtë vëzhgim, GVJ u informua gjatë vizitës në Institucion se organizimi i orëve në auditor ishte lënë i lirë dhe pedagogët kishin mundësinë të shtonin kohën e trajtimit të ushtrimeve dhe rasteve praktike e të kufizonin kohën e trajtimit të materialit teorik. Në përfundim të këtij programi, studenti aftësohet për t'u punësuar në sektorin publik, privat ose si i vetëpunësuar. Njohuritë që ofrohen nga ky program krijojnë bazën për një karrierë kërkimore dhe akademike duke mundësuar vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë. Kurrikula e ofruar jo vetëm që optimizon njohuritë, por dhe krijon fleksibilitetin e nevojshëm për t'u përshtatur me vecoritë që kërkon tregu specifik i juristëve. Referencë: <i>Tabelat përmbledhëse e RVB-se për programin e studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Civile dhe Tregtare. (Evidenca Anex)</i> <i>Rregullore e Programit të Ciklit të Dytë të Studimit "Master i Shkencave" në "E Drejtë Civile dhe Tregtare" (Evidenca 10)</i> <i>Syllabus (Evidenca 28)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Nga analiza e Planit Mësimor të programit të studimit MSHDCT konstatohet se janë përcaktuar ngarkesa në kredite, si edhe elementet e tjera (<i>orët mësimore për leksionet, punë individuale dhe aktivitete të tjera</i>) për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Studentët e këtij programi studi i nënshtrohen praktikës profesionale e cila zhvillohet në semestrin e fundit të studimeve, është e monitoruar nga një pedagog udhëheqës dhe është e vlerësuar me 12 ECTS. Si detyrim përmbyllës, studentët e këtij programi i nënshtrohen mbrojtjes së diplomës (<i>Tema e Diplomës</i>) e cila është e vlerësuar me 18 ECTS. Referencë: <i>Plani mësimor i programi të studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Civile dhe Tregtare. (Evidenca 27)</i>

	<i>për programin e studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Civile dhe Tregtare. (Evidenca Anex)</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.	N / A
Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N / A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në	Programi i studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Civile dhe Tregtare" në UL është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015 dhe, as programi i studimit dhe as Institucioni nuk gëzojnë status të veçantë.

kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Në RVB nuk analizohet ky kriter, por theksohet fakti që “Ky program ka qenë vazhdimësi e programit të ciklit të parë të studimit “Bachelor” në “Drejtësi” dhe pas riorganizimit të programit të studimit të ciklit të parë në përputhje me ligjin Nr. 80/2015, programi Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare” është plotësuar i profilizuar i programit të ciklit të dytë të studimit “PIND” në “Drejtësi”. Në fakt, në plotësim të këtij kriteri kërkohej nga GVB që të analizonte në aspektin krahasimor, programe të tjera studimi, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, dhe të shprehej me përqindje, për ngjashmërinë mes tyre. Bazuar në kurrikulën e programit Master i Shkencave “E Drejtë Civile dhe Tregtare” dhe në përmbajtjen e programeve lëndore të tij, GVJ shprehet se, mesa ka dijeni dhe informacion, duke e krahasuar me programe me të njëjtin emërtim dhe nivel në IAL të tjera të vendit, përmbajtja e këtij programi studimi në UL ka një nivel ngjashmërie afërsisht 80%. Diferencat prej afro 20% lidhen kryesisht: (i) me lëndën Antropologjia e ligjit (<i>të cilën nuk e ndeshim në programe të ngjashme kombëtare</i>); (ii) shpërndarje e ndryshme mes orëve të leksioneve dhe seminareve. Programi ka gjithashtu një balancë mes lëndëve publike dhe private; <i>GVJ sugjeron rishikimin e lëndëve për të përfshirë më shumë lëndë që lidhen me fushën tregtare si psh “Qeverisja e korporatave” apo “E Drejtë Tregtare Evropiane”, brenda kufijve të lejuar ligjor për ndryshime.</i> Referencë: <i>Plani mësimor i programi të studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare. (Evidenca 27)</i> <i>Rregullore e Programit të Ciklit të Dytë të Studimit “Master i Shkencave” në “E Drejtë Civile dhe Tregtare” (Evidenca 10)</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimet në institucion konstatohet se lëndët që ofrohen më programin e

kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	studimit të ciklit të dytë master i shkencave në ‘E drejtë Civile dhe tregtare’ nuk janë të pajisura me kodin përkatës. <i>GVJ rekomandon Departamentin e së Drejtës Private që të marrë masa për të përmbushur sa më parë këtë detyrim.</i>			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimeve të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe tregtare” ofrohet nga Fakulteti i Drejtës si njësi kryesore dhe nga Departamenti i të drejtës Private si njësi bazë.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit MSHDCT është i organizuar, në përputhje me elementet e kërkuara ligjore, në veprimtari formuese të emërtuara në kredite europiane. Programi i studimit është afërsisht 80% i ngjashëm në përmbajtje dhe strukturë me programe të tjera kombëtare me të njëjtin emërtim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet	UL është themeluar në vitin 2003, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 611, datë 11.09.2003, “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Luarasi” dhe ka nisur veprimtarinë e tij akademike në vitin 2003-2004 fillimisht me Fakultetin e Drejtësisë me një program studimi, për të vijuar me hapjen e disa programe të tjera të ciklit të parë dhe të dytë. UL është riorganizuar sipas Rregullores së UL-s (neni 6) në 4 njësi kryesore, si më poshtë:

akademike vlerësimin dhe akreditimin.

1. Fakulteti i Drejtësisë (FD);
2. Fakulteti i Ekonomisë (FE);
3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore (FSHM);
4. Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit dhe Inovacionit (FTII);

Programi i studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Civile dhe Private" ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë, si njësi kryesore. Bazuar Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 52, datë 27.11.2020, Universiteti Luarasi është akredituar në nivel Institucional deri në 14/12/2023, tashmë është në proces riakreditimi, duke përmbushur kërkesën ligjore për akreditim institucioni.

GVJ analizoi shkallën e përmbushjes së kërkesave ligjore në fuqi që specifikojnë se "njësia kryesore duhet të organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente", dhe konstaton se Fakulteti i Drejtësisë në UL, e përmbush këtë kriter pasi ka në përbërjen e tij tre departamente (njësi bazë), që janë:

1. Departamenti i të Drejtës Private;
2. Departamenti i të Drejtës Publike;
3. Departamenti i të Drejtës Penale;

Bazuar në RVB (Anex 1 Tabela fq 73) Fakulteti i Drejtësisë në UL ofron në total 4 programe studimi, si më poshtë:

1. Program i integruar i ciklit të dytë të studimeve në "Drejtësi";
2. "Master i Shkencave" në "E Drejtë Civile dhe Tregtare";
3. "Master i Shkencave" në "E Drejtë Penale";
4. "Master Profesional" në "Siguria dhe Rendi Publik";

Në zbatim të nenit 5 të Rregullores së DDP (RVB Anex 1) për këtë program, departamentet e Fakultetit të Drejtësisë përmbushin kërkesat ligjore për numrin e stafit akademik efektiv, PAE (cdo njësi bazë duhet të ketë të paktën 7 PAE, ndër të cilët 3 të jenë me tituj dhe grada).

Fakulteti i Drejtësisë, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2023-2024 ka gjithsej 36 pedagogë, nga të cilët 23 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 13 pedagogë me kontratë (PAK) me kualifikimin e mëposhtëm:

Personeli akademik pranë Fakultetit të Drejtësisë

Grada/titulli	PAE	PAK
Prof.Dr	1	1
Prof.Asoc.	4	2
Dr.	18	9
Msc	-	1
Gjithsej	23	13

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare” në UL është Departamenti i të Drejtës Private. Referuar të dhënave të RVB (Anex 1, Tabela 2), GVJ konstaton se kjo njësi bazë përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit akademik të brendshëm (PAE) dhe atë me kontratë (PAK).

Tituj/ grada	Departamenti i të Drejtës Private					
	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	-	-	-	-	-	-
Prof. Asoc.	2	-	-	-	-	-
Dr/Phd/Doc	3	3	7	2	7	2
Msc.	2	-	-	1	-	-
Gjithsej	7	3	7	3	7	2

GVJ konstaton se njësia kryesore dhe ajo bazë përmbushin kërkesat ligjore për organizimin, strukturën dhe kualifikimin e tyre, si edhe për raportet mes personelit PAE dhe PAK.

Referenca:

Tabelat përmbledhëse të RVB

Organigrama e UL (Evidenca 33)

Cv e stafit akademik (Evidenca 34)

	<i>VKM Nr, 490 dt 23.06.2010 për hapjen e Programit MSHDCT</i> <i>VBA për akreditimin e programit Master i Shkencave në të Drejtë Civile dhe Tregtare</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Në përmbushje të këtij kriteri, në RVB janë referuar në mënyrë të gabuar të dhëna në lidhje me personat përgjegjës të angazhuar për ndjekjen e praktikës profesionale brenda dhe jashtë UL-s (në institucione dhe kompani të ndryshme). Referenca do të duhej të ishte Statuti i UL-s, Rregullorja e Departamentit të së Drejtës Private (DDP), si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”, sipas së cilës parashikohet angazhimi i një personeli ndihmës akademik (PNA) dhe një personeli administrative (PA) në DDP. Bazuar në <i>nenin 52</i> të Statutit të UL-s, personeli ndihmës akademik ndahet në personel ndihmës akademik me karakter mësimor (PAM) dhe ndihmës akademik me karakter administrative (PAA). PAM ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose kërkimit shkencor. Ai është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Në këtë kategori futen laborantët dhe teknikët. (<i>neni 52 para. 2 i Statutit të UL-s</i>) PAA ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të insitucionit në nivel njësie baze, njësi kryesore ose në nivel institucional. Në këtë kategori bëjnë pjesë personeli i përcaktuar në rregulloren e brendshme. (<i>neni 52 parag. 3 i Statutit të UL-s</i>) <i>Neni 53</i> i Statutit të UL-s parashikon edhe funksionin e personelit administrative (PA), i cili kryen veprimtari administrative dhe teknike në ndihmë të procesit mësimor dhe atij kërkimor. Në përputhje me Statutin, Rregullorja e DDP parashikon që PAM angazhohet në punë mësimore-shkencore në ndihmë të lektorëve titullarë të lëndëve, si dhe në mbarëvajtjen e departamentit (<i>neni 16 i Rregullores së DDP</i>). Pjesë e detyrave të PNA është edhe angazhimi për realizimin e praktikave në funksion të arritjes së objektivave të programit të studimit.

	Ndërsa PA punësohet si personel me detyra të caktuara dhe me kohë të plotë në pozicione të ndryshme. (neni 17 i Rregullores së DDP). Kriteret e punësimit të personelit ndihmës akademik, me kohë të plotë, propozohen nga njësia së cilës ky personel i shërben, bazuar në nevojat e kësaj të fundit. Konkursi drejtohet nga një komision <i>ad hoc</i>, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë përkatëse, sipas përcaktimeve të rregullores. (neni 52 parag. 4 i Statutit të UL-s) Referenca: <i>Statuti i UL-s</i> <i>Tabelat përmbledhëse të RVB</i> <i>Rregullore e Departamentit të së Drejtës Private (Evidenca 10)</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	As Rregullorja e njësisë bazë dhe as e njësisë kryesore nuk parashikojnë rolin e kordinatorit të programit të studimit. Këtë funksion e kryen drejtuesja e njësisë bazë, që është përgjegjëse për këtë program studimi. <i>Neni 30 i Statutit të UL-s</i>, parashikon si një nga funksionet e drejtuesit të njësisë bazë që të “sigurojë zbatimin e planeve dhe programeve të studimeve, të cikleve të ndryshme”. Gjithashtu, neni 8/d) i Rregullores së DDP ngarkon drejtuesin e departamentit me funksionin e mbikqyrjes së “programeve të mësimdhënies në kohën e në mënyrën e caktuar dhe veprimtarive të tjera të procesit mësimor.” Edhe nga takimet në UL u konfirmua që përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe ecurinë e programit të studimit MSHDCT është përgjegjësja e DDP-s. Referencë: <i>Rregullore e Departamentit të së Drejtës Private (Evidenca 10)</i> <i>Rregullore e FDUL-s</i> <i>Statuti i UL-s</i>
Konkluzione	<i>Sipas konstatimeve të GVJ, Fakulteti i Drejtësisë dhe Departamenti i të Drejtës Private që janë njësitë përkatëse përgjegjëse për ndjekjen e programit të studimit MSHDCT</i>

	përbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për sa i përket organizimit dhe strukturës akademike, numrit të stafëve akademike efektive dhe me kontratë dhe në lidhje me vlerësimin dhe akreditimin.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ shqyrtoi dhe vlerësoi dokumentat kryesorë strategjik të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë që ofrojnë këtë program studimi (Rregullorja e Fakultetit të Drejtësisë; Rregullorja e Departamentit të së Drejtës Private, dhe Rregullorja e Programit të studimit MSHDCT (nenet 5 deri në 8)), të cilat përmbajnë elementet e nevojshme në lidhje me programin si kohëzgjatjen e tij, organizimin në vite akademike dhe në semestra, në lidhje me strukturën dhe përmbajtjen e elementëve dhe lëndëve të programit. Informacioni dhe dokumentet e mësipërm (por jo vetëm) gjenden të publikuar në "Share Point" të brendshëm të UL-s në një folder të vecantë të dedikuar për këtë program studimi. Cdo anëtar i personelit akademik dhe administrativ ka akses të plotë në informacionin e sipërpërmendur. Programet mësimore, syllabus-et dhe materialet e leximit për secilën lëndë, nga semestri i dytë i vitit akademik 2018-2019 hidhen edhe në sistemin "moodle" të përshatur nga personeli i brendshëm i IT-s të UL-s. Të dhënat e detajuara për programin e studimeve gjenden edhe në faqen e internetit të UL-s: https://luarasi-univ.edu.al/sq/master-profesional/ Referencë: <i>Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë</i> <i>Rregullore e Departamentit të së Drejtës Private</i>

	<i>Rregullore e Programit të studimit MSHDCT</i> <i>Udhëzues për përdorimin e strukturës Moodle Luarasi</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	GVJ shqyrtoi Planin Mësimor të programit të MSHDCT (<i>Anexi I</i>) dhe konfirmon se në të janë parashikuar lëndët që do të zhvillohen sipas semestrave dhe viteve akademike, së bashku me numrin e krediteve ECTS në total dhe për cdo veprimtari, si leksione në auditor, aktivitete të tjera mësimore, dhe orë studimi individual jashtë auditorit. Lëndët e programit të studimit janë të organizuara sipas veprimtarive formuese nga A – E në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Referencë: <i>Plani mësimor i programit të studimit MSHDCT (Evidenca 27)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë parashikuar në mënyrë kumulative në Statutin e UL-s (<i>neni 59</i>), në Rregulloren e FDUL-s dhe në Rregulloren e programit të studimit MSHDCT (<i>neni 9</i>). Sipas <i>nenit 59</i> të Statutit të UL-s, njësia bazë, për cdo vit akademik, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore, propozojnë numrin e studentëve, për cdo program studimi, si dhe kriteret e pranimi të studentëve që miratohen nga njësia kryesore. Përzgjedhja e studentëve fitues bëhet nga njësia bazë dhe miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, sipas procedurës së përcaktuar në rregullore. Pranimi në programet e studimit të ciklit të dytë është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimi. Kriteri specifik pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në nivelin B 1. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Më konkretisht kriteret e pranimi të studentëve të programit Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”

	parashikohen edhe në nenin 9 të Rregullores së MSHDCT, sipas të cilit: - Pranimi në Programin e Ciklit e Dytë të Studimit, Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”, bëhet sipas rregullave dhe kuotave të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave, ministria përgjegjëse për arsimin, dhe FDUL, për vitin akademik përkatës; - Në këtë Program Studimi mund të pranohen vetëm ata persona që kanë përfunduar ciklin e parë Bachelor në fushën e Drejtësisë; - Në këtë Program Studimi mund të pranohen edhe ata persona që kanë marrë një diplomë të shkollës së lartë jashtë vendit. Për këtë kategori kërkohet që të jetë bërë ekuivalentimi i diplomës së fituar prej tyre në vendin e huaj, nga komisioni përkatës në ministrinë përgjegjëse për arsimin; - Dokumentet e aplikimit dhe ato të regjistrimit do të jenë në përputhje me aktet ligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave apo ministria përgjegjëse për arsimin për vitin akademik përkatës; Si një formë e pranimi të studentëve është parashikuar edhe transferimi. UL lejon transferimet e studentëve në hyrje dhe në dalje të programeve të të njëjtit cikël studimi, ndërmjet IAL publike ose jopublike të huaja, sipas procedurave të parashikuara në aktet nënligjore që rregullohen në Rregulloren e UL-s. <i>GVJ konstaton se, ndërkohë që Statuti i UL-s, dhe Rregullorja e Fakultetit të Drejtësisë (neni 31) parashikojnë gjuhën e huaj si kriter hyrës të studentëve në program të ciklit të dytë, <u>ky kriter nuk reflektohet në Programin e Masterit Shkencor në “E Drejtë Civile dhe Tregtare” megjithëse në rekomandimet e Bordit të Akreditimit të mëparshëm ishte lënë shprehimisht si rekomandim që: Institucioni të përditësojë rregulloren e programit të studimit duke reflektuar në të gjuhën e huaj si kriter hyrës të studentëve.” Nga kontrolli i ushtruar në dosjet e disa studentëve gjatë vizitës në Institucion, si dhe në një dosje të përfshirë në DVV konstatohet qartazi që ky kriter zbatohet nga Institucioni.</u></i> Referencë:
--	--

	<i>Statuti i UL-s</i> <i>Rregullorja e Departamentit të së Drejtës Private</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Për të analizuar këtë kriter, GVJ ka shqyrtuar jo vetëm Planin Mësimor që është pjesë e tabelave të RVB dhe e rregullores së programit të studimit, por edhe programet lëndore përkatëse të programit të studimit MSHDCT në UL. Referuar këtyre të dhënave GVJ konstaton se syllabusi i cdo lënde përmban kryesisht informacionet e nevojshme të detajuara, në lidhje me orët në auditor dhe orët e studimit individual. Komponentët formues të programit konstatohet se janë formuluar konform formateve të kërkuara sipas VKM nr. 41 të ndryshuar nga VKM nr. 879 datë 18.12.2018. <i>Neni 8 i Rregullores së MSHDCT</i> parashikon se, “plani mësimor pasqyron periudhën kohore të organizimit të secilës prej lëndëve dhe veprimtarive formuese në auditor për secilën prej lëndëve të programit të studimit, ngarkesën e tyre në ECTS, orët përkatëse në auditor (të ndara në leksione, seminare, ushtrime, detyra kursi, projekte etj) si dhe orët përkatëse për punë individuale, të ndara sipas viteve akademike dhe semestrave. Ky plan u bëhet me dije stafit akademik dhe studentëve dhe afishohet në standat e njoftimit të Fakultetit si edhe në faqen e internetit të Fakultetit të Drejtësisë.” GVJ pasi verifikoi syllabus-et e 12 lëndëve të programit të MSHDCT konstatoi se në përgjithësi ato ishin të përditësuara (me pak përjashtime), si dhe në zbatim të VKM Nr 879 datë 18.12.2018, të nenit 30 të Statutit të UL-s ato ishin të miratuara nga drejtuesi i Departamenti të së Drejtës Private. Referencë: <i>Rregullorja e Departamentit të së Drejtës Private</i> <i>Rregullorja e programit të studimit MSHDCT</i> <i>Statuti UL-s</i> <i>Syllabus-et e programit MSHDCT</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm	Bazuar në <i>nenin 6</i> të Rregullores së MSHDCT, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program dhe kriteret për secilën prej tyre mund të rishikohen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Ndryshimet propozohen nga

dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	departamenti përkatës. Pas miratimit nga Fakulteti i Drejtesise duhet të përcillen për miratim në Senatin Akademik. Vetëm pas miratimit në Senat ato bëhen përfundimtare. Në vitin 2020-2021 programi i studimit ka patur një ndryshim. Është hequr lënda "E Drejtë Private Evropiane" sepse është përfshirë në programin PIND dhe është përfshirë lënda "Arbitrazh ndërkombëtar". Në gjykimin e GVJ këto ndryshime janë brenda nivelit 20% dhe janë në kahun e përmirësimit të përmbajtjes së programit dhe të mospërsëritjes me programin bazë PIND. Duke qenë se programi i studimit ofrohet në gjuhën shqipe edhe arkivimi i dokumentacionit për këtë program bëhet në gjuhën shqipe. Referenca: <i>RVB Anex 1 Tabela 11</i> <i>Rregullore e MSHDCT</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit përmban Planin Mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. Përmbajtja e programit është në përmirësim të vazhdueshëm sipas një procedure të përshkruar në mënyrë të qartë dhe transparente në dokumentat bazë strategjike të institucionit. Programi ka të dhëna jo të plota në lidhje me kriteret për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve.</i> <i>GVJ rekomandon përditësimin e rregullores së programit të studimit duke specifikuar në të gjuhën e huaj si kriter hyrës të studentëve. (rekomandim ky i lënë që nga akreditimi paraardhës)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ ka shqyrtuar Planin mësimor të programit të studimit MSHDCT rregulloren e programit të studimit, si edhe përmbajtjen e veprimtarive formuese dhe akademike të cdo lënde në kurrikul, sic gjenden në dosjen e syllabuseve të programit. GVJ konfirmon përfshirjen në këtë program studimi të disa lëndëve në fushën e së drejtës civile dhe tregtare që garantojnë kryesisht thellimin e njohurive të marra edhe më herët nga ana e studentëve në studimet në ciklin e parë, si edhe aftësimin profesional të tyre për të garantuar punësimin në pozicione pranë njësive publike dhe private. Organizimi i lëndëve në semestra ofron një balancim të arsyeshëm të njohurive të dhëna dhe progresion drejt rritjes graduale të njohurive dhe aftësive të studentëve, që kulmojnë me praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse në semestrin e fundit. Referencë: <i>Rregullorja e programit të studimit MSHDCT</i> <i>Syllabuset e Programit Master i Shkencave në "E Drejtë Civile dhe Tregtare"</i> <i>RVB Tabelat përmbledhëse (Anex 1)</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Rregullorja e programit të studimit MSHDCT (neni 4) parashikon që misioni i këtij programi studimi është që: (i) në përfundim të tij, studenti duhet të aftësohet për t'u punësuar në sektorin publik, privat ose si i vetëpunësuar. Njohuritë që ofrohen nga ky program dhe kompetencat që marrin studentet nëpërmjet tij krijojnë bazën për një karrierë kërkimore dhe akademike duke mundësuar vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë; (ii) kurrikula e ofruar jo vetëm që optimizon njohuritë, por dhe krijon fleksibilitetin e nevojshëm për t'u përshtatur me vecoritë që kërkon tregu specifik i juristëve; Në funksion të qëllimit dhe objektivave formues të synuar në program, studentëve u jepen njohuri në lëndë të ndryshme të së drejtës civile, tregtare, kushtetuese, bankare etj. Përgjatë dy viteve akademike (të ndarë në katër semestrale) (RVB Anex 1,

	<i>Tabela 9). Në total, MSHDCT ka 120 ECTS të shpërndara me rregullin:</i> Cdo lëndë e bazë e kategorisë A (formimi i përgjithshëm) – 6 ECTS; Cdo lëndë e bazë e kategorisë B (lëndë karakterizuese) – 8 ose 10 ECTS; Cdo lëndë e bazë e kategorisë C (lëndë ndërdisiplinore) – 6 ECTS; GVJ konstaton një shpërndarje të krediteve mes lëndëve të kategorive të ndryshme, ku lëndët e kategorisë A vlerësohen me 6 kredite, ato të kategorisë C me 6 kredite dhe lëndët karakterizuese (kategoria B), me 8 ose 10 kredite. Gjatë vizitës në institucion kjo u argumentua me faktin se lëndët karakterizuese janë më të rëndësishme për dhënien e njohurive në profesion. Referenca: <i>RVB Tabela përmbledhëse (Anex 1) Tabela 9</i> <i>Rregullorja e Programit të studimit MSHDCT</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Përsa i përket strukturës së programit, organizimit në vite akademike dhe semestra, numrit total të krediteve dhe renditjes së lëndëve sipas semestrave, GVJ konstaton që lëndët dhe renditja tyre janë në të njëjtën linjë me programe të ngjashme ndërkombëtare (dhe kombëtare). GVJ rikonfirmon se UL ndjek një qasje të ndarjes së pabarabartë të krediteve, bazuar në peshën specifike të lëndëve karakterizuese, e cila përputhet me modele të universiteteve të tjera brenda dhe jashtë vendit. Referenca: <i>Rregullorja e Programit të studimit MSHDCT</i> <i>RVB Tabela përmbledhëse (Anex 1) Tabela 9</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit	Përsa i përket ngarkesës totale në auditor, programi MSHDCT ka strukturën e mëposhtme (<i>tabela 13 në RVB</i>):

teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	• Leksione 675 orë; • Seminare 285 orë; • Praktikë profesionale 75 orë; • Forma të kontrollit të vazhdueshëm 75 orë; • Diploma 150 orë; Totali 1.260 orë Raporti Teori (leksione) / Praktikë (sem+usht+proj+prakt.prof) rezulton 675 orë teori / 585 orë praktikë ose afërsisht 53% / 47%. Kjo balancë mundëson arritjen e objektivave formuese të cilat sic renditen në rregulloren e programit të studimit, ndër të tjera përfshijnë edhe që “programi ka si objektiv të pajisë studentët me njohuri bashkëkohore shkencore në disiplinat e së drejtës civile dhe tregtare, por edhe me aftësitë e duhura për t’u integruar në tregun e punës dhe shpalosur njohuritë e fituara dhe zotësinë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme, ofrimin e sugjerimeve dhe ideve të reja në këto disiplina.” Referencë: <i>Plani mësimor i Programi të studimit (Evidenca 27)</i> <i>RVB Tabela përmbledhëse (Anex 1 tabela 13)</i> <i>Syllabus-et e lëndëve të programit të studimit MSHDCT</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Syllabuset përmbajnë literaturë të detyrueshme dhe literaturë të rekomanduar. Nga analiza e tyre, GVJ konstaton se në tërësi ato janë kryesisht të përditësuar, jo vetëm në aspektin formal, por edhe atë përmbajtësor. Përditësimi i literaturës ka hapësirë për përmirësim. Në pjesën më të madhe të lëndëve literatura është më e vjetër se e 5 viteve të fundit. Në vlerësimin e GVJ-s, kjo mangësi nuk mund të marri peshë të madhe duke ditur se literatura e përditësuar në fushën e së drejtës nuk është gjithnjë e mundur të plotësohet qartësisht si kriter, sidomos në kontekstin e lëndëve që i referohen legjislacionit shqiptar. Zëvendësimi i tyre me literaturë të huaj (<i>sic do të mund të bëhej në lëndët shkencore</i>) në kuadrin e zbatueshmërisë së legjislacionit shqiptar është i padobishëm.

	Në këto kushte, <u>GVJ sugjeron</u>, për sa është e mundur, të pasurohet literatura me artikuj shencorë të botuara në revista shkencore juridike me ISBN. Referencë: <i>Syllabuset e lëndëve të Programit MSHDCT</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	GVJ është e mendimit se përmbajtja e programit të studimit MSHFK garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Rregullorja e programit të studimit MSHDCT (neni 4) parashikon që misioni i këtij programi studimi është që: (i) në përfundim të tij, studenti duhet të aftësohet për t'u punësuar në sektorin publik, privat ose si i vetëpunësuar. Njohuritë që ofrohen nga ky program dhe kompetencat që marrin studentet nëpërmjet tij krijojnë bazën për një karrierë kërkimore dhe akademike duke mundësuar vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë; (ii) kurrikula e ofruar jo vetëm që optimizon njohuritë, por dhe krijon fleksibilitetin e nevojshëm për t'u përshtatur me vecoritë që kërkon tregu specifik i juristëve; Në funksion të qëllimit dhe objektivave formues të synuar në program, studentëve u jepen njohuri në lëndë të ndryshme të së drejtës civile, tregtare, kushtetuese, bankare etj. Në drejtim të kurrikulës së programit të studimit <u>GVJ sugjeron</u> rishikimin e lëndëve për të përfshirë më shumë lëndë që lidhen me fushën tregtare si psh “Qeverisja e korporatave” apo “E Drejtë Tregtare Evropiane”, brenda kufijve të lejuar ligjor për ndryshime. Referencë: <i>Syllabuset e lëndëve të Programit MSHDCT</i> <i>Plani mësimor i Programi të studimit (Evidenca 27)</i> <i>Rregullorja e Programit të studimit MSHDCT</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e	GVJ vlerëson se përmbajtja e programit të studimit MSHDCT mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit të studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e

mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	punës. Programi kombinon teorinë, kërkimin shkencor dhe praktikën duke mundësuar përvetësimin e dijeve bashkëkohore, nxitjen e mendimit krijues dhe kritik te studentët, në pëpruthje me qëllimin e programit. Në këtë mënyrë program mundëson si vijimin e rrrugës akademike, ashtu edhe atë praktike në tregun e punës. Referencë: <i>Syllabuset e lëndëve të Programit MSHDCT</i> <i>Plani mësimor i Programi të studimit (Evidenca 27)</i> <i>Rregullorja e Programit të studimit MSHDCT</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon përfshirjen në këtë program studimi të disa lëndëve në fushën e së drejtës civile dhe tregtare që garantojnë kryesisht thellimin e njohurive të marra edhe më herët nga ana e studentëve në studimet në ciklin e parë, si edhe aftësimin profesional të tyre për të garantuar punësimin në pozicione pranë njësive publike dhe private.</i> <i>Programi kombinon teorinë, kërkimin shkencor dhe praktikën duke mundësuar përvetësimin e dijeve bashkëkohore, nxitjen e mendimit krijues dhe kritik te studentët, në pëpruthje me qëllimin e programit. Në bazë të këtyre konstatimeve, emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave të programit të studimit, mundësojnë plotësisht thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</i> <i>GVJ rekomandon:</i> - <i>Të pasurohet literatura për sa është e mundur, me artikuj shkencorë të botuara në revista shkencore juridike me ISBN;</i> - <i>Të rishikohen lëndët e programit duke përfshirë më shumë lëndë që lidhen me fushën tregtare si psh "Qeverisja e korporatave" apo "E Drejtë Tregtare Evropiane", brenda kufijve të lejuar ligjor për ndryshime;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Rregullorja e MSHDCT parashikon shprehimisht në <i>nenin 6</i> të saj mundësinë e rishikimit të përmbajtjes së programit të studimit. Ndryshimet propozohen nga departamenti përkatës dhe pas miratimit nga Fakulteti i Drejtësisë duhet të përcillen për miratim në Senatin Akademik. Vetëm pas miratimit në Senat ato bëhen përfundimtare. Në lidhje me këtë kriter në RVB nuk pasqyrohet nëse ka patur apo jo rekomandime të institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës në lidhje me përmirësimin e cilësisë së programit të studimit dhe nëse po cilat kanë qenë dhe a janë marrë ato në konsideratë nga UL. Nga krahasimi i përmbajtjes së programit aktual të studimit të MSHDCT me atë të programit fillestar, konstatohet se është bërë vetëm një ndryshim në vitin 2021-2022, duke u hequr lënda “E Drejtë Private Evropiane” dhe duke u përfshirë lënda “Arbitrazh Ndërkombëtar”. Ky ndryshim nuk është ndikuar as nga kërkesat e tregut të punës, dhe as nuk ka ardhur si propozim i institucioneve partnere, të diplomuarve, apo aktorëve të tjerë nga tregu i punës. Ky ndryshim ka ardhur sepse lënda “E Drejtë Private Evropiane” është përfshirë në programin PIND. Ndryshime vihen re në mënyrën e organizimit të praktikave mësimore, shtimin e projekteve dhe rritjen e cilësisë së stafit akademik. Nga bisedat me pedagogët GVJ konstatoi se temat e diplomave përcaktoheshin edhe nga studentët apo partnerët në tregun e punës. Pas kryerjes së praktikës, një pjesë e konsiderueshme e studentëve, në bashkëpunim me mbikqyrësit e praktikës në institucion apo kompani private, vinin me ide të qarta për temën e diplomës që do të donin të trajtonin. Në bazë edhe të këtyre propozimeve, Institucioni përcaktonte listën e temave. Referencë:

	<i>Shkresë për propozimin e temave të diplomave</i> <i>Rregullorja e Programit të studimit MSHDCT</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Në DVV, Institucioni ka përfshirë informacione dhe dokumenta që faktojnë përfshirjen e studentëve në struktura institucionale, në procesin e vlerësimit të procesit akademik dhe dhënien e opinionëve për përmirësimin e programit të studimit si analiza e tregut të punës, pyetësi me studentët, përfshirja e studentëve në vendimarrje, dhe raporti Alumni Netëork. Sipas Statutit të UL-s (<i>neni 93</i>) Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) përbëhet nga 5 anëtarë, ku njëri prej tyre është një student i përzgjedhur nga Këshilli i Studentëve të UL-s. Për çdo vlerësim të brendshëm, NJBSC organizon një Grup Vlerësimi të Brendshëm (GVB), në përbërje të të cilit është një përfaqësues i studentëve të programit Master (<i>neni 2 & 5 të Manualit të NJBSC-s</i>) Në lidhje me kontaktet me studentët alumni, përsëri në RVB përfshihen referenca me lidhje të dobët me argumentimin e kriterit përkatës. Megjithatë, përsa i përket shkallës së reflektimit të sugjerimeve të tyre, drejtues të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë dhe stafi akademik i programit u pyetën gjatë vizitës në Institucion duke u shprehur se me studentët e diplomuar organizohen herë pas here takime për të marrë mendimet e tyre tashmë në rolin e të punësuarve në biznese të ndryshme. Referencë: <i>Alumni MSc Civile dhe Tregtare (Evidenca 51)</i> <i>Statuti i UL-s.</i> <i>Manuali i NJBSC (Evidenca 9)</i> <i>Raportet vjetore të NJBSC</i> <i>Vendim mbi ngritjen e NJSBC</i> <i>Formular i vlerësimit të personelit akademik</i> <i>Vendim Dekani FD, Nr 32, datë 30.05.2024 (Evidenca 4)</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat	Në lidhje me këtë kriter RVB nuk ofron informacion relevant. GVJ konsultoi dokumentet në DVV, duke analizuar ndër të tjera edhe opinionin e aktorëve të tregut.

programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Në analizën e marrëveshjeve të Departamentit të së Drejtës Private me aktorë të tregut si institucione publike apo private, shoqata, etj ofrohen evidenca që mbështesin bashkëpunimin e njësisë përgjegjëse me rrjete profesionistësh, që japin kontributin e tyre në drejtim të pasurimit të përmbajtjes dhe rritjes së cilësisë së programit të studimit. Një nga llojet e bashkëpunimit me këto aktorë është edhe shkëmbimi reciprok i risive, publikimeve, materialeve didaktike dhe shkencore etj. të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin dhe përditësimin e programit tëstudimit. Referenca: <i>Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>			
Konkluzione	<i>GVJ është e mendimit se Institucioni dëshmon përpjekje serioze dhe konsistente në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të përmbajtjes së programit të studimit MSHDCT duke përfshirë në këtë proces edhe studentët, edhe bashkëpunëtorët sidomos rrjete profesionale dhe përfaqësues të tregut në fushën përkatëse, edhe studentët alumni.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	UL mbështetur në ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 6/20, ka hartuar Strategjinë e Mësimdhënies, Dijeve të qëndrueshme, Kërkimit shkencor dhe Inovacionit (MDKI-UL) duke paraqitur politikat për prioritetet strategjike për vitet 2021-2025. Në Planin Strategjik 2001-2025 të UL-s parashikohet shprehimisht si prioritet kërkimi shkencor (pika 4.2) Më konkretisht ky Plan synon: - Revista shkencore (<i>E-Journal</i>) 2 hetë në vit;

	- Konferenca shkencore (kombetare dhe ndërkombetare); - 3 herë në vit Trajnime; - Tryeza të rumbullakta; - Forume; Ëorkshop-e, Ëebinare; - Pjesëmarrje në aktivitetet shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; - Bashkëpunim me profesorë të huaj që mund të influencojnë jetën akademike të institucionit; - Promovimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit duke nxitur bashkëpunimin me institucione joakademike industriale në vend dhe jashtë tij; - Bashkëpunim të ngushtë të Qendrës së Kërkimit Shkencor në nivel fakultet/departament/program akademik të institucionit dhe atij ndërinstitucional për të nxitur bashkëpunime akademike; UL ka një plan të detajuar për kërkimin shkencor, projektet & inovacioni për vitin akademik 2023-2024 dhe ka parashikuar një buxhet prej 25.000 Euro për vitin akademik 2023-2024, nga të cilat ¼ i takon FDUL. Misioni dhe objektivat e programit të MSHDCT janë tërësisht në përputhje me Planin Strategjik të UL-s dhe planin e detajuar të Kërkimit Shkencor të sipërpërmendur. Referencë: <i>Planifikimi – Kërkimi Shkencor Projektet & Inovacioni 2023-2024 (Evidenca 40)</i> <i>Buxheti mbi kërkimin shkencor (Evidenca 48)</i> <i>Plani Strategjik i Zhvillimit të UL-s për vitet akademike 2021-2025 (Evidenca 6)</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia kryesore (FD) i jep një vëmendje të vecantë kërkimit shkencor, duke parashikuar shprehimisht në Rregulloren e saj (neni 11) ngritjen e një Komisioni të përhershëm për kërkimin dhe zhvillimin shkencor. Në Rregulloren e Departamentit të së Drejtës Private parashikohet shprehimisht roli i Departamentit për të nxitur, bashkërenduar dhe administruar veprimtaritë mësimdhënëse dhe veprimtaritë e kerkimit shkencorë, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet material dhe financiare në dispozicion të departamentit (neni 4). Në <i>nenin 4</i> të Rregullores së programit MSHDCT parashikohet shprehimisht që “ky program përputhet me misionin e përgjithshëm

	të arsimit të lartë në Shqipëri sipas specifikimeve në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor, si dhe me Strategjinë për zhvillim të UL-s. Dokumenti tregues i planifikimit të kërkimit shkencor ishte i pasur dhe nga dokumente të tjera (si conference proceedings, lista e aktiviteteve shkencore etj) u konstatua zbatueshmëria e tyre. Liria akademike e personelit akademik të UL në tërësi parashikohet shprehimisht në Statutin e UL (<i>neni 3</i>), sipas të cilit “Liria akademike garantohej nëpërmjet të drejtës: a) për të organizuar veprimtaritë mësimdhënëse, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuese; b) për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore; c) për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademi.” Në Rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë (<i>neni 17</i>) parashikohet shprehimisht që personeli akademik ka të drejtë të gëzojë liri të plotë akademike dhe të mos jetë i diskriminuar, si edhe të përcaktojë lirisht metodat dhe brendinë e procesit mësimor në kuadër të programeve mësimore dhe në përputhje me politikat e institucionit. Gjatë vizitës, stafi akademik u shpreh se kishte gjithë mbështetjen e nevojshme për rritjen akademike të tyre si nëpërmjet kërkimit shkencor ashtu edhe projekte apo aktivitete të tjera në fushën e mësimdhënies. Bazuar në përshkrimin dhe ndarjen e detyrave dhe të përgjegjësisë, GVJ konstaton se njësia kryesore dhe ajo bazë u japin lirinë dhe nxitjen e nevojshme stafit akademik për zhvillimin e aktiviteteve didaktike dhe kërkimore e shkencore të programit të studimit. Referencë: <i>Statuti i UL-s</i> <i>Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë</i> <i>Rregullore e Departamentit të së Drejtës Private</i> <i>Rregullorja e programit të MSHDCT</i> <i>Lista e aktiviteteve shkencore</i>
--	---

Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Sipas dokumentave në DVV, GVJ konstatoi se studentët janë aktivë dhe marrin pjesë në projekte aktivitete të ndryshme të tilla si: (i) shkëmbimet në programet Erasmus; (ii) Moot Court; (iii) Debat studentor ndërkombëtar THIULDT 2024; (iv) Projekti Jane Monet etj; Nga konsultimi i dokumenteve në DVV nuk del qartë nëse në këto projekte janë përfshirë specifikisht studentët e programit MSHDCT, por nga intervistat me studentët ata pohuan se disa prej tyre ishin përfshirë në disa projekte. Referencë: <i>Moot Court (Evidenca 45)</i> <i>Marrëveshjet Erasmus (Evidenca 52)</i> <i>Debat studentor ndërkombëtar (Evidenca 46)</i> <i>Projekti Jane Monet (Evidenca 47)</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Nga dokumentet e konsultura të DVV dhe takimin me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi dhe Fakulteti i Drejtësisë në bashkëpunim me Qendrën e Kërkimit Shkencor- Projekteve dhe Inovacionit “FAB” kanë organizuar një sërë aktiviteteve shkencore. Drejuesja e njësive bazë (DPP) u shpreh se mbështetja financiare nga ana e Institucionit ka qenë e tejet e konsiderueshme. GVJ konsultoi edhe buxhetin e UL-s për kërkim shkencor dhe evidentoi se UL ka një buxhet orë 25.000Eur për vitin akademik 2023-2024, nga të cilat ¼ i takon FDUL. Referencë: <i>Buxheti mbi kërkimin shkencor (Evidenca 48)</i> <i>Planifikimi i Kërkimit shkencor (Evidenca 40)</i> <i>Vizita në institucion</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit MSHDCT është organizuar duke mundësuar, nxitur dhe motivuar studentët të angazhohen në</i>

	<i>studime, projekte dhe aktivitete kërkimore si shkëmbime Erasmus, konferenca studimore me caktime të cmimeve inkurajuese për kërkuesit e rinj, punime dhe projekte kërkimore të përbashkëta me pedagogët e programit.</i> <i>Edhe njësia bazë dhe stafi akademik mbështeten financiarisht nga Institucioni për të nxitur rezultate sa më të mira të punës kërkimore dhe shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Fakulteti i Drejtësisë në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional, për arritjen e objektivave në ofrimin e edukimit sa më cilësor ka qenë i anagzhuar, për zgjerimin e bashkëpunimit në planin ndërkombëtar në lidhjen e marrëveshjeve për fitimin e programeve Erasmus + (KA1 dhe KA2) si dhe bashkëpunime të tjera në kuadër të Projekteve Horizon 202, COST etj Departamenti është njësi bazë dhe përgjegjëse e zhvillimit të punës kërkimore shkencore <i>(neni 8 i Rregullores së DDP)</i> Referencë: <i>Raport për projektete Luarasi (Evidenca 56)</i> <i>Rregullore e Departamentit të së Drejtës Private</i> <i>Vlerësimi i programit të studimit nga Drejtuesi i DDP</i> <i>Relacion mbi veprimtarinë e Klinikës së ligjit</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon	Në rregulloret e organizimit të konferencave dhe veprimtarive shkencore në UL parashikohet shprehimisht pjesëmarrja dhe angazhimi i stafit akademik dhe studentëve. Nga studimi i dokumenteve në DVV, GVJ konstaton se në tërësi aktivitetet shkencore të përmendura në listën e aktiviteteve dhe në projektet kombëtare edhe ndërkombëtare, angazhimi i stafit

personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	akademik dhe studentëve ka qenë maksimal. Nxitja e vazhdueshme e stafit akademik për të zhvilluar kërkim shkencor evidentohet edhe në raportin e vlerësimit të programit të studimit nga Drejtuesi i Njesisë kryesore. Referencë: <i>Lista e aktiviteteve shkencore ndër vite (Evidenca 49)</i> <i>Rregullore e organizimit të konferencave dhe aktiviteteve shkencore.</i> <i>Vlerësimi i programit të studimit nga Drejtuesi i Njesisë kryesore (Evidenca 104)</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	GVJ konstatoi një listë të pasur të aktiviteteve shkencore konferencave dhe takimeve të tjera që ndihmojnë si stafin akademik, ashtu edhe studentët e programit të studimit. Leksionet e hapura, trajnimet dhe shkëmbimet në kuadër të marrëveshjeve Erasmus +, pjesëmarrja në dsa konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare si Moot Court apo Debat studentor ndërkombëtar etj, janë disa shembuj pozitivë të nxitjes së aktiviteteve në fushën e e së drejtës civile dhe tregatë, ndërgjegjësimi të studentëve në lidhje me çështje të rëndësishme të profesionit por edhe të punëdhënësve të cilët përmes këtyre aktiviteteve vijnë në kontakt me institucionin dhe me studentët. Referencë: <i>Lista e aktiviteteve shkencore ndër vite (Evidencë 49)</i> <i>Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit (Evidenca 38)</i> <i>Moot Court (Evidenca 45)</i> <i>Projekti ËBF (Evidenca 44)</i> <i>Debat studentor ndërkombëtar (Evidenca 46)</i> <i>Projekti Jane Mone (Evidenca 47)</i> <i>Marrëveshjet Erasmus (Evidenca 52)</i> <i>Raport për projektet Luarasi (Evidenca 56)</i> <i>Conference proceedings</i>

Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Në bazë të Planit Mësimor të programit të studimit MSHDCT dhe syllabuseve përkatëse, GVJ vlerëson se studentët e diplomuar janë përgjithësisht të aftë të punojnë në tregun e punës brenda dhe jashtë vendit. Ata janë konkurrues për këtë treg dhe mund të përshtaten me kërkesat e paraqitura nga punëdhënësi. Tregues në lidhje me këtë aspekt janë dhe statistikave të mëposhtme: - Në vitin 2018-2019 numri total i të diplomuarve në MSHDCT ishte 29, nga të cilët 14 u punësuan në përputhje me profilin e diplomës së tyre; - Në vitin 2019-2020 numri total i të diplomuarve në MSHDCT ishte 42, nga të cilët 25 u punësuan në përputhje me profilin e diplomës së tyre; - Në vitin 2020-2021 numri total i të diplomuarve në MSHDCT ishte 77, nga të cilët 35 u punësuan në përputhje me profilin e diplomës së tyre; - Në vitin 2021-2022 numri total i të diplomuarve në MSHDCT ishte 44, nga të cilët 29 u punësuan në përputhje me profilin e diplomës së tyre; - Në vitin 2022-2023 numri total i të diplomuarve në MSHDCT ishte 24, nga të cilët 12 u punësuan në përputhje me profilin e diplomës së tyre. (<i>Alumni MSHCDT</i>); Referencë: <i>Alumni MSCCDT</i> <i>Rregullorja e programit të studimit MSHCDT</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Në përfundimin me sukses të programit të studimit “Master i Shkencave” në: “E Drejtë Civile dhe Tregtare” studenti merr 120 ECTS, të cilat janë kriter hyrës në të gjitha provimet për marrjen e licencës për profesionet e lira në fushën e së drejtës (<i>si psh licencën e avokatisë, notërisë, ndërmjetësimi</i>). Nga bisedat me stafin akademik, u konstatua se njësia bazë mban marrëdhënie profesionale si me Dhomën e Avokatisë, ashtu edhe me të Noterisë dhe Ndërmjetësimi (<i>por jo vetëm</i>) për të diskutuar dhe konsultuar programin e studimit, me qëllim që këta studentë të jenë sa më mirë të përgatitur për ndjekjen e shkollave apo dhënien e provimeve profesionale pas përfundimit të programit të studimit.

	Referencë: <i>Vizita në Institucion</i>			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Në gjykimin e GVJ ky kriter nuk gjen aplikim për programin e studimit MSHDCT në UL.			
Konkluzione	<i>Numrat e lartë të aktiviteteve shkencore e kërkimore dhe personave pjesëmarrës në to, dëshmon për një politikë të suksesshme të UL-s dhe konkretisht të programit të studimit MSHDCT. GVJ konstaton mbështetjen institucionale në kuadër të organizimit të aktiviteteve kërkimore dhe shkencore në formën e hartimit të rregulloreve të posacme, mbështetjes financiare dhe logjistike si edhe krijimit të kushteve për nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve dhe stafit të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në lidhje me format e organizimit të mësimdhënies GVJ konstatoi se <i>neni 7</i> i Rregullores së MSHCDT parashikon format kryesore të mësimdhënies që janë: leksionet, seminarët, detyrat e kursit, ushtrimet (studim i çështjeve gjyqësore), projekte, etj. Në përfundim të secilës lëndë është parashikuar zhvillimi i provimit përkatës, si dhe teza e diplomës/provimi përfundimtar, pas përfundimit të të gjitha provimeve të lëndëve (moduleve) të programit. Forma e studimeve të Programit të ciklit të dytë të studimit MSHDCT është me kohë të plotë. Vlerësimi nga pikëpamja akademike e leksioneve, projekteve dhe detyrave, praktikave, seminarëve dhe punimeve të tjera të ngjashme bëhet në bazë të njësisë matëse “orë” të zhvilluar në auditor si dhe orë pune të pavarura studimore të kryer nga studenti. Një krediti formimi universitar i korrespondojnë 25 orë mësimore punë të studentit. Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh universitare nga një student me kohë të plotë është 60 kredite ose 1500 orë mësimore punë të studentit. Këto përfshijnë orë në auditor dhe orë për punë të pavarur të tij. Niveli i suksesit të studentit vlerësohet mbi bazën e provimeve semestrale, vjetore, provimeve të fundvitit, detyrave të kursit, prezantimeve, aktivizim në praktikën mësimore dhe përgatitjes së temave të diplomës. Referencë: <i>Rregullorja e programit të MSHDCT</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	UL ka miratuar (<i>me vendim Senatit</i>) një “Udhëzues strategjik për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies 2019-2024”, i cili paraqet drejtimet kryesore të zhvillimit pedagogjik dhe didaktik të stafit akademik të UL-s. Synimi kryesor i këtij udhëzuesi është përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe të mësimnxënies në UL. Nga konsultimi i Udhëzuesit (<i>Evidenca 54</i>) GVJ konstatoi se “Mësimdhënia me në qendër studentin”, “Të nxëniti gjatë gjithë

	jetës”, Standartet ESCO, E-learning, Zhvillimi i të menduarit kritik, Vlerësimi dhe motivimi i studentëve, Zhvillimi i të menduarit krijues dhe problemzgjidhja, ishin disa nga shtyllat kryesore të tij. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua që mësimdhënia zhvillohej në mënyrë interaktive jo vetëm në seminare por edhe në lëksione, duke vendosur studentin në qendër. Studentët njiheshin me temën që do trajtohej paraprakisht dhe kjo e bënte lëksionin më inetersant dhe frytdhënës në aspektin e mësimnxënies. Studentët e kontaktuar gjatë vizitës në Institucion u shprehën se ishin shumë të kënaqur me larminë e metodave didaktike të pedagogëve të cilët angazhohen për të përfshirë sa më shumë studentët dhe për t’iu përgjigjur nevojave të tyre. Rastet studimore, “role play”, puna në grupe, “learning by doing”, përdorimi i materialeve audio-vizive janë disa nga metodat inovative të përdorura në auditor, të cilat janë vlerësuar pozitivisht nga studentët në takimet e zhvilluara nga GVJ. Kushtet logjistike të klasave ishin të mira për të garantuar që personeli akademik të angazhohej në mënyra alternative mësimdhënieje (raste studimore apo lektorë të ftuar dhe aktivitete të tjera të organizuara nga njësia bazë) dhe duke përdorur mjete të ndryshme si kompjuterë, projektorë, etj. Referencë: <i>“Udhëzues strategjik për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies 2019-2024” (Evidenca 54)</i> <i>Rregullorja e programit të studimit MSHDCT</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Referuar Tabelave 12.1, 12.2, 12.3 (RVB Anex I) ku përcaktohet plani mësimor lidhur me personelin akademik, GVJ konstatoi se 80% e stafit janë të njëjtë në tre vitet e fundit të programit. Disa pedagogë janë pjesë e stafit akademik të UL-s që prej krijimit të tij. Ky stabilitet i stafit akademik dëshmon për trajtim dinjitoz, profesional dhe mbështetje të tyre nga ana e Institucionit. Këtë fakt e konfirmuan pa asnjë rezervë të gjithë pedagogët e kontaktuar gjatë vizitës në Institucion.

	UL ka mbështetur personelin akademik që të përfitojë nga programet e vizitave dhe shkëmbimit të personelit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohur me praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes. Referuar dokumentacionit në DVV dhe nga diskutimi me stafin akademik gjatë vizitës në Institucion, konstatohet se të paktën 5 pedagogë kishin përfituar nga trainimet në kuadër të marrëveshjeve të shkëmbimit Erasmus+ dhe konkretisht me Universitetin e Bolonjës në Itali, The Mazovian State University në Plock, Poloni, Universitetin Pan European në dy vitet e fundit. Referencë: <i>Marrëveshjet Erasmus Tabela (Evidenca 52)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga shqyrtimi i dosjeve të CV-ve të personelit akademik efektiv në programin e studimit MSHDCT, dosjet e vetëvlerësimit të tyre si edhe dokumenta në DVV si kualifikimet dhe kërkimet shkencore të PAE gjatë viteve të fundit dhe trajnimet dhe shkëmbimet në kuadrin e projekteve ndërkombëtare Erasmus +, pedagogët janë të përgatitur për të ofruar mësim cilësor dhe kanë përputhshmëri mes fushës së formimit të tyre akademik dhe njohurive të nevojshme për t'u përcuar tek studentët e programit të studimit. Në lidhje me angazhimin si titullarë lëndësh, referuar të dhënave mbi personelin akademik të përfshirë në programin e studimit si dhe syllabuset e lëndëve, GVJ evidentoi që titullarët e lëndëve të programit të studimit MSHDCT <u>nuk kanë titullin Profesor.</u> <u>GVJ rekomandon që Institucioni të marrë masa për të mundësuar si titullarë lëndësh në këtë program studimi personel akademik të kategorisë "Profesor", sipas pika 3 neni 59, Ligjit Nr. 80/2015.</u> Gjatë procesit mësimor, stafi akademik u shprehën se janë të prirur të nxisin pjesëmarrje dhe nivel të lartë të aktivizimit të studentëve, të zgjojnë tek ata të menduarin kritik dhe gjykimin profesional. Studentët u shprehën se procesi mësimor

	karakterizohet nga mbështetja dhe orientimi i stafit pedagogjik drejt aftësimit praktik të tyre. Referencë: <i>CV-t e lektorëve, Programi i studimit Master i Shkencave "E Drejtë Civile dhe Tregtare"</i> <i>Marrëveshjet Erasmus Tabela (Evidenca 52)</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Rregullorja e FDUL (neni 8) dhe Rregullorja e DDP (neni 8) parashikojnë se një nga funksionet e Përgjegjësit të Departamentit është "mbikqyrja e respektimit të programeve të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të veprimtarive të tjera". Në UL studentët bëhen rregullisht pjesë e procesit të vlerësimit të procesit të mësimin dhe të pedagogut nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve sipas modaliteteve të parashikuara në Rregulloren e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Sipas kësaj rregulloreje vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet: a. Pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, duke vlerësuar karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese dhe profesionale të pedagogut, etikën, metodat inovative të përdorura, korrektesën, vlerësimet e dijeve të studentit etj. Ky pyetësor zhvillohet në fund të çdo semestri, zakonisht javën e 13 dhe të 14. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies kryhet për të gjithë stafin PAE dhe PAK. Rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, njësive bazë, si dhe dekanëve përkatës. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ pati mundësinë të verifikojë kryerjen e rregullt të procesit të vlerësimit nga ana e studentëve. Fakte për këtë u gjendën edhe në DVV. Vetë studentët u shprehën për marrje në konsideratë të opinioneve të tyre rregullisht nëpërmjet pyetësorëve pavarësisht se nuk kishin pasur rastë ku të evidentoheshin problematika që do të kërkonin edhe reagimin e Institucionit; b. Vlerësimit të përgjegjësit të departamentit për çdo anëtar të stafit të tij me kohë të plotë. Ky formular (<i>Formular i vlerësimit të personelit akademik – Evidenca 88</i>), plotësohet në fund të semestrit të dytë, brenda muajit Qershor, dhe së

	bashku me vlerësimin e studentëve i vihet në dispozicion Rektoratit; c. Realizimit të sondazheve me studentët për të vlerësuar kryesisht qartësinë në prezantimin e programit të lëndës, përdorimin e mjeteve audio-vizuale, nxitjen e pjesëmarrjes aktive në diskutime dhe objektivitetin në vlerësimin e studentëve (2022-2023). Në përfundim të analizimit të të dhënave të përftuara nga ky sondazh NJBSC ka vënë theksin në rëndësinë e komunikimit dhe të metodave të mësimdhënies. Po ashtu, NJBSC ka orientuar drejtuesit e Institucionit për të bërë ndryshime të nevojshme në mënyrën e mësimdhënies, për të përmirësuar mjetet dhe metodat e vlerësimit, si dhe për të rritur angazhimin e pedagogëve për një përvojë më të mirë mësimore për studentët; Referencë: <i>Formular vlerësimi të personeli akademik nga studenti</i> <i>Raport vjetor i Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC).</i> <i>Universiteti "Luarasi" Viti akademik 2022-2023 (Evidenca 97)</i> <i>Rregullore e FDUL-s (Evidenca 17)</i> <i>Rregullore e DDP (Evidenca 16)</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë	Referuar manualit të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) (neni 1) UL ka ngritur struktura të posacme për kontrollin dhe garantimin e cilësisë në nivel institucional dhe janë: - Senati i Universitetit; - Rektori; - Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NjSBC); - Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (GVB); - Dekani; - GDB në cdo program; - Staf i akademik dhe administrative, studentët dhe palët e inetersuara; - Koordinator i Institucional pranë ASCAL (KIAL);

vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	- Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC); NJBSC planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë, në dy aspekte kryesore: 1. Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë të programeve të studimit; 2. Vlerësimin e Brendshëm Institucional; NJBSC është strukturë përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore që i raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë Rektorit. Njësia gëzon autonomi dhe akses në të dhënat e Institucionit. NJBSC i ushtron funksionet e saj në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili hartohet në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe miratohet nga Senati. Në fund të cdo semestri ose para sezonit të provimeve, NJBSC organizon pyetësin për studentët për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e cdo program studimi. NJBSC evidencion problematikat, propozon mjete dhe procedura mbi bazën e elgjislacionit të arsimit të lartë, standartet e cilësisë, praktikat më të mira ndërkombëtare, si dhe zgjedhje për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë. NJBSC përgatit raportin vjetor të vetëvlerësimit. Raportet e vlerësimeve përdoren si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në Raport NJBSC udhëzon njësitë bazë dhe kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre. Raporti përmban arritjet dhe jep sugjerimet përkatëse për përmirësimin e veprimtarisë. Propozimet e NJBSC shqyrtohen nga organet dhe autoritet drejtuese të Institucionit dhe reflektohen në vendimmarrjen konkrete. Referencë: <i>Manuali i Njësive të Sigurisë së Brendshme të Cilësisë UL</i> <i>Raport vjetor i NJBSC, viti akademik 2023-2024</i>
Konkluzione	<i>Institucioni organizon struktura të mjaftueshme që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe garantojnë procesin e të nxënies dhe aftësimin</i>

	<i>professional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin. Studentët përfshihen në procesin e vlerësimit të procesit mësimor.</i> <i>GVJ rekomandon që, në përputhje me kriteret ligjore në fuqi Institucioni të marrë masa për të mundësuar si titullarë lëndësh në këtë program studimi personel akademik të kategorisë "Profesor".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	UL ka hartuar rregullore në nivel institucional, njësie kryesore, dhe programi studimi, ku në të gjitha ato specifikohen kriteret e vlerësimit të njohurive të studentëve. Konkretisht, kriteret dhe mënyrat e testimit të vlerësimit të njohurive përcaktohen në Rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë; Rregulloren e programit MSHDCT; Rregulloren e provimeve dhe diplomimit; si dhe në Syllabus-et e lëndëve. Të gjitha këto akte janë publike dhe të aksesueshme në faqen e ëeb të UL-s. Sipas Rregullores së MSHDCT (neni 7), niveli i studentëve vlerësohet mbi bazën e provimeve sesmtrale/vjetore, detyrave të kursit, prezantimeve, aktivizimeve, praktikës mësimore dhe përgatitjes së temës së diplomës. Vlerësimi në fund të një lënde që përmban disa module bazohet në përlllogaritjen e rezultatit përfundimtar në bazë të vlerësimeve të vecanta të realizuara në secilin modul, evdientuar në process-verbalet përfundimtare të vlerësimit të modulit, në të njëjtën mënyrë si lëndët pa modul. (neni 19 i Rregullores së MSHDCT). Provimi, është forma kryesore për vlerësimin e nivelit të përvetësimit të njohurive që studenti ka përfutuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde. Studenti përfiton të drejtën për tu paraqitur në provimin e një lënde, kur ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin mësimor dhe në masën e përcaktuar në këtë rregullore

	si dhe në akte të tjera që rregullojnë këtë problematikë. Studenti përfiton të drejtën për t'u paraqitur në provim, kur shlyerja e detyrimeve të konfirmuar nga pedagogu në pasqyrën e rezultateve të detyrimeve që plotësohet në përfundim të procesit mësimor dhe dorëzohet në sekretarinë mësimore, të paktën një javë para fillimit të sezonit të provimeve". (neni 22 i Rregullores së MSHDCT) Provimi, si rregull, zhvillohet me shkrim ose me gojë. Mënyra e dhënies së provimit në cdo lëndë paracaktohet në syllabus-in përkatës. Komisioni i provimit të cdo lëndë përbëhet nga jo më pak se dy pedagogë të lëndës. Titullari i lëndës është përgjegjës dhe ndjek zhvillimin e provimit. Provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara. Në mungesë të një rregullimi të tillë, titullari i lëndës zbaton atë formë që mendon më efikase për të siguruar fshehtësinë dhe objektivitetin në korrigjim. (neni 23 i Rregullores së MSHDCT) Në zbatim të Rregullores së MSHDCT, pedagogët kanë parashikuar në syllabus-et e tyre mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm të dijeve, që ndryshon në varësi të lëndëve, por afërsisht ndjekin rregullin e mëposhtëm: ✓ Niveli i diskutimit të detyrave në seminare 10%-20%; ✓ Provim i ndërmjetëm 10%-20%; ✓ Dorëzim dhe prezantim projekti 30%; ✓ Provim përfundimtar me shkrim 50%-60%; Referuar Rregullores së Fakultetit të Drejtësisë (neni 46), shkalla e përvetësimit të dijeve bëhet me sistemin prej dhjetë notash. Notat nga pesë e lart janë kaluese. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, por rezultati kthehet detyrimisht në notë. Sistemi i vlerësimit me pikë i studentit (përfshirë pikët e vlerësimit gjatë vitit) dhe konvertimi në nota bëhen si më poshtë: - 41-50 pikë – Nota 5; - 51-60 pikë – Nota 6; - 61-70 pikë – Nota 7; - 71-80 pikë – Nota 8; - 81-90 pikë – Nota 9; - 91-100 pikë – Nota 10;
--	---

	Referencë: <i>Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë</i> <i>Rregullore e MSHDCT</i> <i>Syllabus-et e programit të studimit MSHDCT</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstaton se metodologjia e testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore është e parashikuar në të gjitha syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit, të cilat janë të aksesueshme nga të gjithë studentët që në fillim të vitit akademik. Nga informacioni i marrë dhe i kryqëzuar nga pedagogët e lëndëve dhe studentët gjatë vizitës në UL, rezulton se studentët vihen në dijeni të metodologjisë së vlerësimit që në orët e para të zhvillimit të lëndës. Referencë: <i>Syllabuset e programit të studimit (Evidenca 28)</i> <i>Vizita në UL</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sipas Rregullores së MSHDCT, niveli i studentëve vlerësohet mbi bazën e provimeve sesmtrale/vjetore, detyrave të kursit, prezantimeve, aktivizimeve, praktikës mësimore dhe përgatitjes së temës së diplomës. (neni 7 i Rregullores së MSHDCT) Në zbatim të Rregullores së MSHDCT, pedagogët kanë parashikuar në syllabus-et e tyre mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm të dijeve, që ndryshon në varësi të lëndëve, por afërsisht ndjekin rregullin e mëposhtëm: - Niveli i diskutimit të detyrave në seminare 10%-20%; - Provim i ndërmjetëm 10%-20%; - Dorëzim dhe prezantim projekti 30%; - Provim përfundimtar me shkrim 50%-60%; Pedagogët kanë liri akdemike të vlerësojnë peshën specifike të cdo komponenti në varësi të lëndës, në mënyrë që ti japi studentit mundësi të demonstrojë më së miri njohuritë dhe kompetencat e fituara. Referencë:

	<i>Syllabuset e programit të studimit (Evidenca 28)</i> <i>Rregullore e MSHDCT</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>Në programin e studimit të MSHDCT ka rregulla të qarta dhe të balancuara të vlerësimit të studentëve të cilat përfshihen në kuadrin rregullator të brendshëm të Institucionit, në syllabus-et e lëndëve, dhe u bëhen me dije studentëve në fillim të çdo lënde/moduli. Mënyra e vlerësimit është e diversifikuar mes disa formave të vlerësimit (provim me shkrim dhe/ose me gojë, detyra kursi, projekte etj) duke mundësuar që studentët të shfaqin aftësitë e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në zbatim të Rregullores së MSHDCT, pedagogët kanë parashikuar në syllabus-et e tyre mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm të dijeve, që ndryshon në varësi të lëndëve, por afërsisht ndjekin rregullin e mëposhtëm: - Niveli i diskutimit të detyrave në seminare 10%-20%; - Provim i ndërmjetëm 10%-20%; - Dorëzim dhe prezantim projekti 30%; - Provim përfundimtar me shkrim 50%-60%; Pedagogët kanë liri akademike të vlerësojnë peshën specifike të çdo komponenti në varësi të lëndës, në mënyrë që t'i japi studentit mundësi të demonstrojë më së miri njohuritë dhe kompetencat e fituara.
	Referencë: <i>Syllabuset e programit të studimit (Evidenca 28)</i>

	<i>Rregullore e MSHDCT</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në RVB dhe në dokumentet e DVV-s nuk rezulton që në Institucion të përdoret ndonjë metodë vlerësimi elektronik si psh CleanScore. Në lidhje me metodat e korrigjimit anonim të provimeve, <i>neni 49</i> i Rregullores së Fakultetit të Drejtësisë parashikon që provimet me shkrim bëhen me fletë të sekretuara të cilat vuloen nga sekretaria mësimore. Ato vendosen në zarf dhe hapen para studentëve dhe Komisionit. Referencë: <i>Rregullore e MSHDCT</i> <i>Vizita në Institucion</i> <i>Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nga diskutimet me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit MSHDCT në UL dhe me studentët e këtij programi, u konfirmua që vlerësimi përfundimtar i studentëve bëhet në përputhje me syllabus-in e lëndës, dhe këto të fundit (<i>nga analiza e kryer nga GVJ</i>) janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Referencë: <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Bazuar në Rregulloret e evdientuara në DVV, GVJ nuk gjeti ndonjë rregullim të posaçëm në lidhje me detyrimin e Komisionit të vlerësimit për të dhënë komente apo feedback për vlerësimin. Në <i>nenin 27</i> të Rregullores së programit të MSHDCT parashikohet që “shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash, ku nota kaluese është nota pesë dhe se në format e kontrollit me shkrim përdoret edhe sistemi i vlerësimit me pikë, i cili konvertohet në notë. Vlerësimi i studentit bëhet me konsensus të të gjithë Komisionit dhe në rast mosmarrëveshjes, vlerësimi i titullarit të lëndës është përcaktues. Rezultatet i bëhen të ditura studentëve”. Të pyetur gjatë vizitës, stafi akademik dhe studentët e programit të studimit konfirmuan këto modalitete të vlerësimit të njohurive të cilat parashikohen në rregulloren përkatëse. Referencë:

	<i>Rregullore e programit të studimit MSHDCT</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në Rregulloren e MSHDCT (<i>neni 25</i>) parashikohet se, në varësi të numrit të studentëve që merren në provim, në cdo provim mund të angazhohen pedagogë të tjerë në mbikqyrje, përvec atyre të komisionit të provimit, nëse janë të pamjaftueshëm për të mbikqyrtur të gjitha sallat ku zhvillohet provimi. Në varësi të numrit të studentëve që mbikqyren në një sallë, numri i pedagogëve mbikqyrës mund të jetë nga 1-3 pedagogë për cdo sallë. Drejtuesi i Departamentit përcakton se cilët do të jenë pedagogët që do të angazhohen me mbikqyrje në cdo provim. Po ashtu, në sallën e provimit nuk lejohet përdorimi i materialve që gjykohen si të tilla nga pedagogu i lëndës përkatëse, i cili para fillimit të provimit ose në tezën e provimit citon materialet që lejohen të përdoren gjatë kohës së zhvillimit të provimit. Shkelja e këtij rregulli nga studenti, sjell përjashtim të studentit nga provimi dhe pavlefshmëri të tezës së tij të provimit, në të cilën bëhet shënimi përkatës. Cdo komunikim i studentit në sallën e provimit, përvec rasteve kur ky bëhet me pedagogun e lëndës lidhur me tezën e provimit, është i ndaluar dhe sjell ulje të pikëve në vlerësimin pëfundimtar. Nëse komunikimi përsëritet, studenti mund të përjashtohet nga provimi duke u vlerësuar negativisht. (<i>neni 30 i Rregullores së MSHDCT</i>) Në lidhje me plagjiaturën, Rregullorja e diplomimit (<i>pika 9.1</i>) parashikon që tema e diplomës i nënshtrohet kontrollit antiplagjiaturë nga udhëheqësi i temës. Norma e pranuar e burimeve të cituara nuk duhet të kalojë 15%. Nga dokumnetet e DVV-s dhe nga diskutimet me stafin akademik në Institucion rezulton se nuk është përdorur ndonjë sistem i vecantë për kontrollin e plagjiaturave (<i>përvec kontrollit të zakonshëm që bën pedagogu i lëndës pa ndonjë system referues</i>). Ndërkohë në muajin tetor 2024, Institucioni rezulton që ka blerë një system antiplagjiaturë (<i>Turnitin accounts</i>) i cili është në fazë implemmentimi.
	Referencë: <i>Evidencë sistemi antiplagjiaturë</i>

	<i>Rregullore e diplomimit</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit MSHDCT, në rast se provimi zhvillohet me gojë, komisioni deklaron notat në përfundim të provimit. Në rast të zhvillimit të provimeve me shkrim korrigjimi i provimit të studentit bëhet nga komisioni i provimit i ngritur nga përgjegjësi i departamentit përkatës. Korrigjimi duhet të bëhet brenda 10 ditëve pune nga dita e zhvillimit. Në raste të vecanta e emergjente mund të kërkohet nga dekani që provimet të korrigjohen më shpejt. Në të tilla raste, komisioni duhet të njoftohet për këtë jo më vonë se 10 ditë para zhvillimit të provimit. (neni 27 i Rregullores së MSHDCT). Kjo procedurë u konfirmua edhe nga studentët e intervistuar nga vizita në Institucion. Nga vizita në Institucion, si studentët ashtu edhe stafi akademik pohuan që afati 2 javor (10 ditë pune) është zbatuar lehtësisht në cdo rast dhe nuk pasur asnjëherë vonesa. Referencë: <i>Rregullore e MSHDCT</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në rregulloren e programit MSHDCT parashikohen dy raste ankimi të studentëve në lidhje me provimin. - Së pari, Rregullorja e MSHDCT (neni 26) parashikon ankim për shkelje të procedurave të zhvillimit të provimit. Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit. Përgjegjësi i departamentit nëse verifikon shkelje të korrigjueshme, në bashkëpunim me komisionin e provimit bëjnë korrigjimet e duhura. Në rast se përgjegjësi i departamentit gjykon se e ka të pamundur të marrë vendim, i propozon dekanit, i cili pasi njihet me procedurën merr vendim. Nëse ai e gjen të drejtë ankesën e studentit, anulon provimin dhe merr vendim për rishikimin e provimit; - Së dyti, Rregullorja e MSHDCT (neni 28) parashikon të drejtën e ankimit ndaj rezultatit përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të

	departamentit brenda 48 orëve nga marrja dijëni e rezultatit të provimit. Me kalimin e këtij afati rezultatet bëhen përfundimtare e pasqyrohen në procesverbalin e rregullt të provimit; Në lidhje me afatin e ankimit ka një mospërputhje mes afatit të ankimit të parashikuar në Rregulloren e MSHDCT dhe atij të referuar në RVB. Sipas këtij të fundit afati i ankimit është 3 ditor. <u>Sugjerojmë që të respekohet afati 2 ditor i parashikuar në Rregullore.</u> Referencë: <i>Rregullore e MSHDCT</i> <i>RVB</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Bazuar në Rregulloren e programit MSHDCT (neni 28), në rast ankese për rezultatin përfundimtar të provimit, përgjegjësi i departamentit bën verifikimet e duhura në bashkëpunim me komisionin e provimit dhe i jep përgjigje ankuesit. Procesverbali i rregullt duhet të firmoset nga i gjithë komisioni. Më pas procesverbali depozitohet në sekretarinë mësimore. Nëse pas hedhjes së notave në procesverbalin përfundimtar, studenti konstaton mospërputhje të vlerësimit të njohur prej tij me atë të pasqyruar në procesverbal si rrjedhojë e një gabimi material në plotësimin e procesverbalit, ai mund të kërkojë në dekanat ndreqjen e gabimit. Dekanati merr vendim vetëm pasi merr deklaratën e komisionit të lëndës. Nëse vendimi parashikon korrigjimin e procesverbalit të dorëzuar në sekretarinë mësimore, ky vendim i përcillet sekretarisë, e cila duhet të gjenerojë një procesverbal të ri. Më pas bëhet korrigjimi në regjistrat përkatës, si dhe pasqyrohet rezultati i duhur në sistemin për menaxhimin e studentit. Referencë: <i>Rregullore e MSHDCT</i> <i>Vizita në Institucion</i>

Konkluzione	Në programin MSHDCT procedura e organizimit të provimeve dhe e vlerësimit të njohurive të studentëve është e rregulluar dhe zbatohet në përputhje me cfarë është parashikuar në rregulloret institucionale. Studentët informohen në lidhje me vlerësimin e tyre dhe mangësitë që kanë sjellë rezultatin përkatës dhe kanë të drejtën të ankimojnë jo vetëm vlerësimin përfundimtar por edhe procedurën e kryerjes së provimit. Procedura e ankimimit të vlerësimit është e parashikuar në rregullore dhe ndiqet në tërësi. Në përfundim të procedurës, dokumentacioni arkivohet në sekretarinë mësimore. Konstatohet mospërputhje mes afatit të ankimit të parashikuar në Rregulloren e MSHDCT dhe atij të referuar në RVB. <u>Sugjerojmë</u> që të respekohet afati 2 ditor i parashikuar në Rregullore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Sipas Rregullores së MSHDCT (neni 4), programi synon: (i) formimin e ekspertëve dhe specialistëve në aspektet teorike ashtu edhe në aftësitë aplikative në fushën e së drejtës civile dhe tregtare; (ii) pajisjen e tyre me njohuritë themelore teorike, njohje e thelluar e debateve dhe praktikave bashkëkohore ndërkombetare, si dhe eksperiencës shqiptare në fushën e së drejtës së biznesit, të drejtave reale dhe trashëgimore, të drejtës evropiane private etj; (iii) njohuri të disa sektorëve të rinj të së drejtës dhe biznesit, praktikat e të cilave janë risi, pasi duke u bazuar në ndryshimet thelbësore të aktualitetit të së drejtës këto fusha bëhen të domosdoshme për mirëqënien dhe ekonominë e komunitetit, si psh njohuritë që jepen mbi sistemin bankar, pronësinë intelektuale dhe ate të falimentimit;

	Duke konsultuar planet mësimore dhe syllabuset, GVJ vlerëson se temat e përshfshira në to janë të vecanta dhe mbulojnë fusha konkrete të së drejtës civile dhe tregtare, duke mundësuar aftësimin e studentëve në fusha specifike. Referencë: <i>Rregullore e MSHDCT</i> <i>Syllabuset e programit të studimit (Evidenca 28)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Ky program studimi nuk garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë dhe informacionit. Ndërsa për aftësitë e tjera të kërkuara në këtë kriter (aftësi në fushën humane, sociale, komunikimi dhe ndërveprimi), GVJ gjykon se disa prej tyre (p.sh, komunikimi) mund të përftohen në mënyrë indirekte nga përgatitja dhe prezantimi i detyrave të kursit që nxisin punën në grup, dhe përmirësimin e komunikimit profesional dhe ndërveprimit në komunitet. Referencë: <i>Syllabuset e programit të studimit (Evidenca 28)</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Misioni i programit MSHDCT është që në përfundim të programit, student të aftësohet për t'u punësuar në sektorin publik, privat ose si i vetëpunësuar. Njohuritë që ofrohen nga ky program krijojnë bazën për një karrierë kërkimore dhe akademike për të mundësuar vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë. Kurrikula e ofruar jo vetëm që optimizon njohuritë, por dhe krijon fleksibilitetin e nevojshëm për t'u përshtatur me vecoritë që kërkon tregu specifik i juristëve. (<i>Rregullore MSHDCT</i>) Në përputhje me Rregulloren e programit MSHDCT dhe sic parashikohet edhe në syllabuset përkatëse, java e fundit e semestrit dedikohet për të bërë një përmbledhje të njohurive të shpjeguara përgjatë semestrit. GVJ u informua nga studentët e programit të studimit se kjo përmbledhje e njohurive e kërkuar nga ky kriter, zbatohet me rigozitet dhe ishte tejet e nevojshme për ta. Gjatë përmbledhjes dhe përsëritjes së njohurive kyce, pedagogët japin informacion në lidhje me detyrimet përmbyllëse të lëndës dhe studentët kanë të drejtë të pyesin dhe të sqarohen në lidhje me paqartësi të fundit që mund të kenë.

	Referencë: <i>Rregullore e MSHDCT</i> <i>Syllabuset e programit të studimit (Evidenca 28)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Rregullorja e programit të studimit MSHDCT parashikon si forma kryesore të mësimdhënies: leksionet, seminarët, detyrat e kursit, studim i çështjeve gjyqësore, projekte, etj. Gjatë diskutimeve me stafin e angazhuar në programin e studimit, GVJ krijoi përshtypjen se ata ishin të angazhuar që të realizonin një proces mësimor serioz dhe të orientuar nga përfitimi i kompetencave në favor të studentëve. Përdorimi i burimeve logjistike të Institucionit, si laboratorët dhe bibliotekat (fizike dhe online) ishin instrumente që stafi i përdorte për të nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve. Puna në grup mbështetej dhe inkurajohej. Metodatat interaktive të mësimdhënies përdoren gjerësisht nga stafi akademik i angazhuar në programin MSHDCT. Pedagogët bëjnë përpjekjen maksimale të përdorin leksione të zgjeruara, pyetje dhe diskutime, shkrimin në klasë, debate, mësimdhënie të bazuara në kompjutera, etj. Referencë: <i>Rregullore e MSHDCT</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në DVV institucioni ka prezantuar një listë të gjatë me aktivitete shkencore, ku vendin kryesor e zënë leksionet e hapura (<i>jashtë strukturës mësimore</i>). Vihet re që në këto leksione të hapura lektorët janë kryesisht jo personel akademik efektiv apo me kontratë me Institucionin. Këta të fundit konfirmuan gjatë vizitës në institucion që kanë qenë gjithnjë pjesëmarrës në këto leksione të hapura dhe se periodikisht organizojnë tavolina të rrumbullakta, debate dhe orë të hapura që drejtohen prej tyre. Referencë: <i>Lista e aktiviteteve shkencore</i>

	<i>Vizita në Institucion</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	UL ofon mbështetje financiare për kërkimin shkencor dhe botimet akademike të stafit akademik. Rregullorja e Zyrës së Kërkimit Shkencor, përcakton rregull në këtë fushë dhe mbështet stafin akademik në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe në funksion të procesit mësimor.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit MSHDCT garanton rritjen e aftësive krijuese tek studentët dhe mësimdhënia në këtë program kryhet në bazë të kompetencave dhe në mënyrë interaktive. Personeli akademik nxit punën në grup dhe aftësitë shkencore dhe kërkimore tek studentët e programit. Stafi angazhon lektorë të ftuar (nga jashtë institucionit) që ndajnë eksperiencat e tyre në fusha të ndryshme të së drejtës (pa u kufizuar vetëm në të drejtë civile dhe tregtare). Në të gjithë procesin, studentët nxiten dhe inkurajohen të bëhen pjesë e procesit cilësor didaktik dhe shkencor. Ky program studim, për vetë matyrën që ka, nuk garanton zhvillimin e aftësive të vecanta në fushën e teknologjisë dhe informacionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Rregullorja e MSHDCT (neni 34) parashikon se studentët e në këtë program studimi diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Gjithsesi sipas kurrikulës së programit, si detyrim përmbyllës i studimeve për programin e studimit MSHDCT parashikohet punimi i diplomës i cili vlerësohet me 18 kredite dhe të gjithë studentët kanë të drejtë të mbrojnë temë diploma, pavarësisht mesatares. Në DVV gjendet Rregullorja e diplomimit e cila është hartuar në mënyrë të posaçme për të rregulluar organizimin dhe zhvillimin

	e procesit të diplomimit për të gjitha ciklet e studimit të UL-s. Konkretisht në Rregulloren e diplomimit janë normuar: (i) përgatitja për mbrojtjen e diplomës (neni 5); (ii) mbrojtja e diplomës (neni 7); (iii) Vlerësimi i Komisionit (neni 9); (iv) lëshimi i diplomës dhe suplementi përkatës (neni 10); (v) ceremonia e diplomimit (neni 15); Gjithashtu UL ka miratuar një “Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës” i cili është një dokumnet i rëndësishëm për përgatitjen e temës nga studentët dhe asistimine tyre nga profesorët udhëheqës. Referencë: <i>Rregullore e MSHDCT</i> <i>Rregullore e diplomimit</i> <i>Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Sipas Rregullores së MSHDCT dhe Rregullores së diplomimit, drejtuesit e temave të diplomës miratohen me urdhër të Dekanit të Fakultetit pas konsultimit me Drejtuesin e Departamenti të së Drejtës Private. Departamenti brenda një muaji nga dita e fillimit të semestrit të parë të vitit të fundit u bën të njohur studentëve të vitit të fundit temat e diplomave. Cdo departament përcakton procedurat që duhet të ndiqen për përcaktimin e ndarjes së temave të diplomave, si dhe për informimin e studentëve. Personeli akademik i ngarkuar me udhëheqjen e studentit është në kontakt të vazhdueshëm me studentin dhe e asiston atë jo vetëm me udhëzime, por edhe me materiale konkrete orientuese, të cilat ata vetë i siguronin nga libraritë elektronike. Studentët e intervistuar në Institucion, që ishin në proces përgatitje të temës së diplomës ishin tejet të kenaqur dhe falenderues për asistencën që u jepej nga stafi akademik dhe personeli administrative i fakultetit (si psh punonjësi i bibliotekës). Referencë: <i>Rregullore e MSHDCT</i>

	<i>Rregullore e diplomimit</i> <i>Vizitë në Institucion</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Ky kriter nuk aplikohet në këtë program studimi sepse sipas kurrikulës së programit, si detyrim përmbyllës i studimeve për programin e studimit MSHDCT parashikohet punimi i diplomës.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Bazuar në Rregulloren e MSHDCT (neni 34) dhe në Rregulloren e diplomimit (neni 7), për udhëheqjen e diplomave të studentëve në programin e studimit të ciklit të dytë kërkohet që pedagogu udhëheqës të ketë të paktën gradë shkencore, dhe konkretisht të jetë Doktor; Prof. Assoc; Prof.Dr. Pedagogu udhëheqës, nuk mund të udhëhqë më shumë se 10 tema në një sezon. Bazuar në “Udhëzuesin për për përgatitjen e punimit të diplomës” udhëheqësi zgjidhet duke patur parasysh këto kritere: a) të jetë lector I UL-s; b) të ketë një diplomë të avancuar në fushën në të cilën studentin do të përgatisë punimin e diplomës; c) të ketë kryer punë kërkimore-shkencore në atë fushë; d) të ketë kualifikimin jo më pak se Dr në rastin e programeve të ciklit të dytë; Referuar këtij Udhëzuesi, roli i udhëheqësit është kryesisht drejtues, këshillues dhe konsultues. Rekomandimet e tij janë të rëndësishme vecanërisht për përcaktimin e një structure të temës, nxjerrjen e grupçështjeve, trajtimin e problematikave teoriko-praktike, rekomandimine literaturës, sugjerimin e mënyrave efikase të shfrytëzimit të literaturës, përcaktimine afateve të punës etj. Në këtë Udhëzues, parashikohen edhe realizimi i disa seancave metodologjike, të cilat janë orë në auditor, që realizohen nga udhëheqësi i temës dhe kanë për qëllim që të ndihmojnë studentët që të përpunojë aspektin metodologjik të punës së tyre për hartimin e temës së diplomës. Orët e seancave metodologjike duhet të trajtojnë çështje të tilla si: (i) Përcaktimi shkencor i

	objektit të marrënë shqyrtim; (ii) sqarimi i dobësisë praktike të punimit; (iii) përzgjedhja e problematikës dhe tematikës që do të trajtohet; (iv) përcaktimi i terreneve empirike të studimit; (vi) ndërtimi i hipotezave dhe verifikimi i tyre; (vii) trajtimi i anëve metodologjike si dhe i metodës së anketimit dhe intervistimit; (viii) ndërtimi i strukturës së punimit; (ix) përpilimi dhe debatimi i materialit bibliografik; (x) përpunimi i metodave të paraqitjes sasiore (<i>diagrame, kurba etj</i>) cilësore ose mikes; (xii) hartimi i materialit prezantues para komisionit (xiii) debatimi i përfundimeve të studimit. Referencë: <i>Rregullore e MSHDCT</i> <i>Rregullore e diplomimit</i> <i>Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	N / A
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Bazuar në Rregulloren e diplomimit (<i>neni 9</i>), studenti në cdo rast e mbron diplomën përpara një Komisioni, i cili caktohet me Urdhër të Dekanit. Në vlerësimin përfundimtar komisioni merr në konsideratë edhe vlerësimet me shkrim të udhëheqësit dhe oponentit. Temat e diplomave merren në shqyrtim nëse ato janë të pranuar dhe nënshtruara nga udhëheqësi i punimit dhe studenti. Në përfundim të mbrojtjes së temës, Komisioni me dyer të mbullura, mer vendim, sipas mesatares së pikëve të secilit anëtar të Komisionit. Vlerësimi jepet me notë dhe ia komunikon studentit. Vlerësimet me notë janë nga nota 1 deri në 10. Nota më e ulët për kalim është 5. Referencë: <i>Rregullore e MSHDCT</i>

	<i>Rregullore e diplomimit</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pas përfundimit me sukses të mbrojtjes së diplomës dhe shpalljes së rezultateve, studenti ka të drejtë të pajiset me diplomën përkatës, e cila është dokument zyrtar. UL nuk lejohet të lëshojë dublikatë diploma. Lejohet vetëm dhënia e listës së notave të fituara dhe vërtetim me fotografi, i cili është ekuivalent me diplomën, pasi nënshkruhet nga Rektori i Universitetit, dekani dhe kancelari. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e institucionit. Në Rregulloren e FD-s (neni 45) dhe në Rregulloren e diplomimit (neni 10) parashikohet se, diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë, të dytë dhe të ciklit të dytë të integruar shoqërohen me suplementin e diplomës dhe listën e notave. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan në vecanti, natyrën, niveli, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbjatesi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin. Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin përkatës. Nëse prania e të diplomuarit është objektivist e pamundur, tërheqjen e diplomës mund ta bëjë një nga pjestarët e familjes me prokurë të posacme, që i bashkangjitet në regjistrin e tërheqjes së diplomës. Nëse diploma nuk është plotësuar në rregull, i interesuari nuk duhet ta tërheqë por ka të drejtë të kërkojë pajsijen me diplomë të rregullt. Nga tërësia e materialeve të konsultuara në përmbushje të këtij kriteri nuk rezulton që studentit ti vihet në dispozicion pa kërkesë të tij një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit, por sic del nga RVB dhe u konfirmua nga personeli akademik gjatë vizitës në institucion, me kërkesë të studentit atij i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit. Referencë: <i>Rregullore e MSHDCT</i> <i>Rregullore e diplomimit</i>

	<i>Vizita në institucion</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Bazuar në statutin e UL-s, cdo formë diploma dhe certifikate, përpara se të lëshohet nga institucioni, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit. (neni 69) Sipas RVB dhe nga vizita në institucion rezulton se, sekretaria mësimore mban në mënyrë të rregullt informacionet për studentët si të dhëna të përgjithshme në lidhje me ta që nga momenti i fillimit të studimeve si formularët e regjistrimit, kopje e dokumentit ID, kontrata e lidhur me studentët, ashtu edhe evidenca gjatë studimeve si evidencat për vlerësimet dhe notat, etj. Referencë: <i>Statuti i UL-s</i> <i>Vizita në institucion</i> <i>RVB</i>			
Konkluzione	<i>Sipas kurrikulës së programit të MSHDCT, si detyrim përmbyllës i studimeve parashikohet punimi i diplomës. Punimi i diplomës është individual dhe punohet në udhëheqjen shkencore të një pedagogu me eksperiencë dhe gradë shkencore. Gjatë punës, studenti këshillohet dhe asistohet nga pedagogu udhëheqës. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë "Master i shkencave në të Drejtë Civile dhe Tregtare" si edhe me suplementin e diplomës. Bazuar në këto elemente që u verifikuan edhe për shkallën e realizimit të tyre gjatë vizitës në Institucion, GVJ shprehet për përmbushjen e plotë të këtij standardi.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	N / A			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	N / A			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N / A			
Konkluzione	<i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Në bazë të RVB-së dhe evidencave shoqëruese rezultojnë se programi i studimit “Master i Shkencave” në “E drejtë Civile dhe Tregtare” ofrohet nga Departamenti i së Drejtës Private të FD, Universiteti “Luarasi”. Ky departament ka aktualisht 7 PAE dhe 2 PAK, të cilët mbajnë gradën shkencore “Doktor”. Në bazë të CV bashkëlidhur në evidenca kualifikimi i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi është në përputhje të plotë me fushën e studimit të këtij programi. Nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, janë angazhuar staf akademik në mësimdhënie për këtë program studimi për tre vite akademike si më poshtë vijon: 1. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 10 pedagogë gjithsej, nga të cilët 7 PAE dhe 3 PAK; (70 % PAE / 30 % PAK) 2. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 9 pedagogë gjithsej, nga të cilët 7 PAE dhe 2 PAK; (78 % PAE / 22 % PAK) 3. Për vitin akademik 2023- 2024 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 10 pedagogë gjithsej, nga të cilët 7 PAE dhe 3 PAK; (70 % PAE / 30 % PAK)								
	<u>Kualifikimi i tyre si më poshtë vijon:</u> <table><tr><th>Tituj/grada</th><th>2021 - 2022</th><th>2022 - 2023</th><th>2023 - 2024</th></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td></td></tr></table>	Tituj/grada	2021 - 2022	2022 - 2023	2023 - 2024				
Tituj/grada	2021 - 2022	2022 - 2023	2023 - 2024						

		PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
	Prof.Dr	-	-	-	-	-	-
	Prof.As.Dr	2	-	-	-	-	-
	Dr/PhD	3	3	7	2	7	3
	Msc	2	-	-	-	-	-
	Në total	7	3	7	2	7	3

Nga sa më sipër konstatohet se në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi janë angazhuar personel akademik me gradën shkencore “Doktor”, si dhe personel akademik me titullin akademik “Pofesor i Asociuar”, pervec rastit në (vitin akademik 2021-2022, 2 pedagog me Msc), gjë që është pëmirërsuar vitet në vijim.

Sa më sipër konkludohet se stafi akademik i angazhuar në programin e studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik të nevojshëm për përfshirjen në procesin e mësimdhënies në këtë cikël studimi.

Referencë:

Evidenca Nr. 15 - Lista e stafit të angazhuar në MSC për vitin 2023-2024

Evidenca nr. 34 - CV e stafit akademik të angazhuar në programin MSHDCT

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Numri dhe raporti i orëve mësimore të realizuara nga stafet akademike PAE / PAK në tre vitet e fundit akademike (sipas tab 12.1 - 12.3. tabelat permbledhese, dokumenti nr.122) jepet si më poshtë:				
	Orë mësimore	Programi i Studimit Msc në: “E Drejtë Civile dhe Tregtare”			
		Totali	PAE	PAK	
		2021 - 2022	960 orë	360 orë (40%)	600 orë (60%)
		2022 - 2023	960 orë	690 orë (72%)	270 orë (28%)

	2023 - 2024	960 orë	900 orë (94%)	60 orë (6%)
	Nga sa më sipër rezulton që për vitin akademik 2021 - 2022 ngarkesa mësimore për këtë program studimi, <i>nuk</i> është përballuar me <u>mbi</u> 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “<i>Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi</i>”, ndërsa për dy vitet pasardhëse plotësohen kërkesat ligjore në lidhje me mbulimin e ngarkesës nga stafi akademik efektiv. Referencë: <i>Evidenca Nr. 27 - Plan i mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare.</i> <i>Evidenca Aneks_ Tabelat permbledhese.pdf</i>			
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se stafi mësimdhënës për gjatë tre viteve akademike, është i qëndrueshëm. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ka nënshkruar kontrata me afat të pacaktuar me institucionin konform legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore në zbatim. Nga verifikimi me zgjedhje rezulton se në dosjen e çdo anëtari të stafit akademik të IAL-së, administrohet dokumentacioni personal dhe kontrata individuale të punës. Referencë: <i>Evidenca nr. 61 - Model Kontrate Pune PAE</i>			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe	Sipas evidencave të bashkëlidhura RVB-së dhe takimeve që GVJ pati me Zyrën e Burimeve Njerzore dhe stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi konfirmohet se procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit janë pjesë e parashikimeve të detajuara regullatore. Statuti dhe Rregullorja e Universitetit kanë parashikime mjaft të detajura në këtë drejtim. Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të Drejtësisë ka përcaktime të qarta mbi kriteret e punësimit të personelit akademik sipas kategorisë “Profesor”, “Lektor” apo “Asistent Lektorë”. Zyra e Burimeve Njerëzore administron			

përmbajtjen e programit të studimit.	dokumentacionin e plotë për të gjithë personelin akademik, ndihmës akademik dhe atë administrativ. Zyra përditëson dosjet prsonale të personelit akademik duke pasqyruar edhe ndryshimet mbi kualifikimin profesional dhe akademik. Procedura garanton transparencë dhe objektivitetin në rekturimin e stafit akademik nëpërmjet kritereve të paracaktuara të shpallura në procedurën e konkurimit. Referencë: <i>Evidenca Nr 62 - Rregullore e zyrës së burimeve njerëzore</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	N / A
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Rezulton se Zyra e Burimeve Njerëzore mbante evidenca për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik (PAE+PAK) për secilin semestër të vitit akademik, si dhe krijon dhe mban dosjen individuale të Stafit Akademik, me kohë të plotë dhe të pjesshëm dhe administrativ, në të cilat depozitohet i gjithë dokumentacioni. Referencë: <i>Evidenca Nr. 63 - Formati i Dosjes personale të stafit</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të	Nga dokumentat e paraqitura rezulton se Fakulteti i Drejtësisë së UL-s për realizimin dhe mbështetjen e programeve të studimit që ofron ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh

arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.

bashkëpunimi me institucionet të tjera të arsimit të lartë në vend, si dhe me institucione të rëndësishme të sistemit të drejtësisë. Ndër to përmenden:

- Marrëveshje Bashkëpunimi midis Universitetit "Luarasi" dhe Akademisë së Sigurisë;
- Marrëveshje Bashkëpunimi midis Universitetit "Luarasi" dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë;
- Marrëveshje Bashkëpunimi midis Universitetit "Luarasi" dhe PROTİK;
- Marrëveshje Bashkëpunimi midis Universitetit "Luarasi" dhe ICT Meia;
- Marrëveshje Bashkëpunimi midis Universitetit "Luarasi" dhe Tetra Solution;
- Marrëveshje Bashkëpunimi midis Universitetit "Luarasi" dhe AKCERT (Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike);
- Shoqatën Shqiptare Alumni "George C. Marshall" etj.
- Gjithashtu, Universitetit "Luarasi" ka marrëveshje shkëmbimi për projektin ERASMUS + stafi akademik dhe studentë me disa universitete.

Për zhvillimin e praktikave profesionale, departamenti cakton pedagogët përgjegjës. Parashikimet shtrihen edhe në detyrat dhe përgjegjësitë e pedagogëve udhëheqës në udhëheqjen e temave të diplomës, kriteret e kualifikimit të nevojshëm akademik për udhëheqje në përputhje me natyrën dhe ciklin e studimit, numrin maksimal të studentëve në udhëheqje etj. Për programin e ciklit të dytë të studimeve, udhëheqësi i temës përzgjidhet nga stafi akademik me kualifikimin Doktor/ ose i kategorisë Profesor.

Referencë:

Evidenca Nr. 52 - Marrëveshjet Erasmus;

Evidenca Nr. 24 - Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese

Evidence 22 & 44 - Marrëveshje bashkëpunimi me Eastern Balkan Fund

Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Praktikat profesionale zhvillohen në institucionet publike, kompani private apo profesione të lira të caktuara nga institucioni apo të propozuara nga studenti në drejtimin e pedagogut përgjegjës. Pedagogu përgjegjës mbikqyr dhe mbështet studentin gjatë gjithë kohëzgjatjes së praktikës profesionale. Në përfundim të praktikës, studenti vlerësohet me notë njësoj si në lëndët e tjera. Në programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë civile dhe tregtare” përvoja praktike ka një numër të konsiderueshëm prej 12 kreditesh. Si e tillë ajo zhvillohet përgjatë gjithë vitit akademik, në vitin e dytë të studimeve në këtë program. Gjatë zhvillimit të praktikës mësimore studentët përgatisin një dosje të plotësuar nga ata vetë dhe nga mentori në institucionin pritës, në të cilën përshkruhen detyrat dhe përgjegjësitë që studenti ka gjatë zhvillimit të praktikës, detyrat e realizuara në përfundim të praktikës dhe shprehitë e përfituara gjatë saj.			
Konkluzione	<i>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit, përbush kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik të nevojshëm për përfshirjen në procesin e mësimdhënies në këtë cikël studimi.</i> <i>Ndonëse në vitin akademik 2021 - 2022 mbulimi i ngarkesës mësimore nuk është mbuluar në masën 70 % nga stafi akademik efektiv, gjatë dy viteve në vijim, ngarkesa mësimore në këtë program studimi e takalon kriterin 70% të ngarkesës totale.</i> <i>Institucioni lidh marrëveshje me institucione, apo organizma të tjera, për të siguruar ambientin e nevojshëm për realizimin e praktikave profesionale, të cilët e aisojnë studentin në zhvillimin e këtyre praktikave.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet t kryesisht	Përbushet plotësisht X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga evidencat e paraqitura dhe nga vizita e bërë nga GVJ në institucion rezulton që IAL disponon të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit MsC “E drejtë Civile dhe Tregtare”. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi ambjente të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të zhvilluar veprimtaritë mësimore të programit Master i Shkencave në “E drejtë Civile dhe Tregtare”. Referencë: <i>Evidenca nr. 64 - Infrastruktura UL-s</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi që mjediset mësimore janë të pajisura me mjete të teknologjisë së lartë. Sallat ku zhvillohet mësimi janë të pajisur me PC dhe projektor të lëvizshëm, ndërkohë që laboratorët janë të pajisur me kompjutera, duke ju lehtësuar pedagogëve dhe studentëve procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në takimin me studentë u evidentua mundësia e përdorimit të sallave të laboratorëve edhe gjatë procesit të realizimit të detyrave të kursit dhe punimit të tezës së diplomës. Referencë: <i>Evidenca nr. 64 - Infrastruktura UL-s</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Mjediset që institucioni ofron përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit. Referencë: <i>Evidenca nr. 64 - Infrastruktura UL-s</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit,	Në bazë të evidencave të paraqitura dhe vizitës fizike të kryer, IAL disponon 4 laboratorë modernë të paisura me rreth 120 pc me parametra bashkëkohore.

të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.				
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	N / A			
Konkluzione	<i>Institucioni ofron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e këtij program studimi.</i> <i>Mjediset mësimore janë të pajisur me mjete të teknologjisë së lartë në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies në këtë program.</i> <i>Laboratorët mësimorë janë të pajisur me programe dhe softëare të nevojshëm dhe të përshtatshme për aftësimin praktik dhe shkencor të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Referuar dokumentave shoqëruese të RVB, GVJ konstatoi që për të gjithë lëndët që zhvillohen në këtë program studimi vihet në dispozicion të studentëve literaturë kryesisht në gjuhën e programit (shqip). Gjatë vizitës në bibliotekë u konstatua edhe literaturë ndihmëse në gjuhë të huaj (kryesisht anglisht) në formë hard copy dhe digjitale. <i>GVJ rekomandon institucionin të përditësojë në mënyrë periodike literaturën e detyrueshme të lëndëve përbërse të programit të studimit, si dhe të sigurojë kopje të kësaj literature në bibliotekën e IAL-së. Duhet të rritet numri i titujve të librave në bibliotekë.</i> Referencë: <i>Evidenca - Database i bibliotekës së Universitetit Luarasi</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ konstatoj se syllabuset e lëndëve shqyrtohen dhe miratohen çdo vit akademik nga drejtuesja e departamentit të së drejtës private dhe zyra e kurrikulës. Sipas intervistës së bërë me drejtuesen e departamentin nëse ajo konstaton që literatura e parashikuar nuk gjendet në bibliotekën e institucionit, ajo deklaroj se menjëherë merr masa dhe sigurohet që kjo literaturë të garantohet për studentin brenda një afati të arsyeshëm.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UL vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar në këtë program studimi bibliotekën e cila ndodhet në katin e tretë me sipërfaqe prej 43 m², si sallë studimi, për 20 persona me akses të palimituar në internet. GVJ është i vetëdijshëm për faktin që në ditët e sotme era digjitale është shumë prezente në përditshmërinë tonë dhe nëpërmjet bibliotekave online aksesit në literaturën e kërkuar është i kudogjendur. <i>Megjithatë GVJ rekomandon institucionin të vërë në dispozicion salla të tjera leximi. Duke qënë se numri i studentëve të</i>

	<i>programit të studimit "Master i Shkencave" nuk është shumë i lartë, për këtë program studimi gjykojmë që aksesin në infrastrukturën e bibliotekës së institucionit mund të konsiderohet i pranueshëm.</i> <i>Gjithësesi, mendojmë se ambientet në dispozicion të bibliotekës janë të pamjaftueshme, duke marrë në konsideratë faktin që ato nuk përdoren vetëm nga studentët e këtij programi.</i> Referencë: <i>Evidenca - Database i bibliotekës së Universitetit Luarasi</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e institucionit është e vendosur në katin e tretë dhe e aksesueshme nga të gjithë studentët. Biblioteka ka një sipërfaqe prej 43 m² dhe krijon mundësi akomodimi të njëkohshëm, si sallë studimi, për 20 persona dhe me akses të palimituar në internet. Si salla leximi për studentët janë në dispozicion edhe disa ambiente të tjera me akses të palimituar në kompjuter të dedikuar dhe internet, si dhe klasat e seminareve, që janë të hapura çdo ditë nga ora 09:00 – 19.00, si psh laboratorit 105 kati II-të. Duke qënë se numri i studentëve të programit të studimit nuk është shumë i lartë, gjykojmë që aksesin në infrastrukturën e bibliotekës së institucionit mund të konsiderohet i pranueshëm. <i>Gjithësesi, sic kemi theksuar edhe më lart, mendojmë se ambientet në dispozicion të bibliotekës janë të pamjaftueshme, duke marrë në konsideratë faktin që ato nuk përdoren vetëm nga studentët e këtij programi.</i> <i>GVJ sugjeron të rritet fondi fizik i bibliotekës, sepse në programet "Master i Shkencave" është me rëndësi vitale që të ofrohet një literaturë sa më e pasur.</i> Referencë: <i>Evidenca - Database i bibliotekës së Universitetit Luarasi</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në	Në bazë të evidencave të paraqitura dhe takimit me studentët GVJ-së i rezulton se Biblioteka siguron shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës dhe atë administrativ, si dhe për persona të tjerë të interesuar. E drejta për të shfrytëzuar bibliotekën është pjesë e katalogut të të drejtave të studentëve, në kuadrin e të drejtës për përdorimin e infrastrukturës në

bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	mëbështetje të programit të studimit. Akses i në bibliotekë është i lirë për të gjithë studentët e Universitetit "Luarasi" si dhe stafin akademik. <u>Mungon një abonim i vetë IAL-së në një bibliotekë online.</u> Referencë: <i>Evidenca Nr. 8 - Manual Përdoruesi Biblioteka Online</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ vizitoi ambientet e bibliotekës, ku u konstatua se biblioteka është e pajisur me një sistem elektronik informacioni për një shërbim efektiv ndaj studentëve dhe pedagogëve. Institucioni po mundëson marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tilla si Akademia e Shkencave të Shqipërisë për të mundësuar shfrytëzimin on-line të literaturës nëpërmjet burimeve dixhitale. Nëpërmjet adresës zyrtare studentët dhe personeli akademik mund të logohen dhe të marrin informacionin e kërkuar kudo që ndodhen. I gjithë fondi i bibliotekës është i informatizuar dhe i përpunuar sipas standardeve bibliografike ndërkombëtare (KDU). Referencë: <i>Evidenca Nr. 8 - Manual Përdoruesi Biblioteka Online</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është në shërbim të të interesuarve nga e hëna në të premten gjatë orarit administrativ të punës në Universitetin "Luarasi". Si salla leximi për studentët janë në dispozicion edhe disa ambiente të tjera me akses të palimituar në kompjuter të dedikuar dhe internet.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në	GVJ në takimet e kryera me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit, drejtuesen e departamentit të së drejtës private dhe punonjësen e bibliotekës së IAL-së konfirmuan deklarin e bërë në RVB. Nëpërmjet kërkesave të stafit akademik të këtij programi studi, sygjerohen/rekomandohen tituj literature ndihmëse, e cila pasuron në mënyrë të vazhdueshme planin mësimor të aplikuar. Drejtuesi i njësisë

shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	kryesore i adreson këto kërkesa për pasurim të literaturës tek administratori i përgjithshëm, i cili më pas vijon me blerjen e tyre.			
Konkluzione	<i>Literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar e këtij programi studimi është pjesë e syllabuseve të lëndëve.</i> <i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën dhe siguron akses të barabartë dha pa pagëse në fondin fizik dhe on line të saj.</i> <i>Gjithsesi GVJ konkludon se kriteret e parashikuara në këtë standard përmbushen kryesisht nga IAL në të gjitha elementët e kërkuar në lidhje me infrastrukturën bibliotekare në funksion të programit të studimit.</i> <i>GVJ rekomandon përditësimin e literaturës të detyrueshme dhe ndihmëse në funksion të programit të studimit, si dhe rritjen e ambienteve të bibliotekës, si për fondin e librave, ashtu edhe për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se ndërmjet institucionit dhe studentit lidhet një kontratë që përmban informacion personal në lidhje me studentin dhe ecurinë financiare të studentit nga momenti i regjistrimit e deri në diplomim. Aktet rregullatore të Institucionit, përcaktojnë detyrimin e mbajtjes së të dhënave në formë të shkruar dhe elektronike si: regjistrin themeltar të studentëve; regjistrin e arritjeve akademike; dhe regjistrin e lëshimit të diplomave. Ndërkohë sekretaria mësimore është struktura që administron të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për këtë program studimi. Gjatë vizitës në sekretari GVJ-ja verifikoi me zgjedhje dosjen e plotë të dy studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare” dhe përdorimin e regjistrave përkatës sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Referencë: <i>Evidenca nr. 67 - Udhëzues për përdorimin e Strukturës së IT-s, Manual Ngarkesa e Pedagogut.</i> <i>Evidenca 13-Rregullore e UL(part1)</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, Rregullores së UL-së dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja konstatoi se administrimi i informacionit për personelin e angazhuar në programin e studimit realizohet nga platforma “Sharepoint” platformë e përshtatur e Microsoft. Referencë: <i>Evidenca nr. 67 - Udhëzues për përdorimin e Strukturës së IT-s, Manual Ngarkesa e Pedagogut.</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Përdorimi i platformave elektronike mundëson një sistem të integruar të menaxhimit të informacionit si dhe akses të dedikuar në informacione dhe dokumente që i referohen këtij programi studimi. Platforma “Sharepoint” mundëson menaxhimin e informacionit si dhe aksesimin e këtij informacioni në desktop dhe mobile. Sistemi i ngarkesë së pedagogut është gjithashtu i aksesueshëm nga drejtuesit e departamenteve, dekanët apo

	administratorët e njësive kryesore. Shkëmbimet e informacionit ndërmjet përdoruesve të platformës përqendrohen kryesisht në përdorimin e platformës për konsultimin e informacioneve apo dokumenteve si syllabuset e çdo lënde, materialet e ofruara nga pedagogët e lëndës, frekuentimi i studentëve, vlerësimi i vazhduar, listat e notave dhe krediteve. Komunikimi (personel akademik, studentë, personel joakademik) realizohet edhe nëpërmjet adresave elektronike të emailit. Komunikimi nëpërmjet rrjeteve sociale është një formë tjetër interaktive në funksion të lehtësimit të këtij program studimi. Referencë: <i>Evidenca nr. 66 - Udhëzues për përdorimin e Strukturës së IT - Moodle tutorial, Luarasi</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Instiucioni përdor një sërë platformash dhe modulesh si Sharepoint, Pitagora etj, të cilat mundësojnë një sistem të menxhimit të integruar të informacionit. Mbi aspektet që i referohen procesit mësimor, marrja e informacionit mundësohet edhe nëpërmjet sistemeve të dedikuara si <i>portali</i>, i cili mundëson komunikimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi veprimtarinë mësimore, leksionet, detyrat e kursit, vlerësimet e lëndëve etj. Nëpërmjet kësaj platforme studentët marrin në kohë reale dhe në distancë një sërë informacionesh mbi veprimtarinë mësimore, si dhe komunikojnë me pedagogët e lëndëve për çështje që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Referencë: <i>Evidenca nr. 66 - Udhëzues për përdorimin e Strukturës së IT - Moodle tutorial, Luarasi</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për	Aktet rregullatore të institucionit sigurojnë monitorimin e aktivitetit akademik e administrativ. Aktiviteti mësimor monitorohet nëpërmjet regjistrimit mësimor i cili plotësohet dhe nënshkruhet nga pedagogu i lëndës, në fillim dhe mbarim të procesit mësimor. Sistemi Luarasi Moodle - LMS është edhe një mjet efikas në dispozicion të organeve drejtuese dhe titullarëve të lëndëve, për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit akademik, përmes të dhënave statistikore të gjeneruara nga ky sistem.

organet dhe autoritetet drejtuese.	Kontrolle të rastësishme në lidhje me zhvillimin e mësimimit bëhen nga njësia bazë, njësia kryesore si dhe nga njësia e sigurimit të cilësisë. Referencë: <i>Evidenca nr. 66 - Udhëzues për përdorimin e Strukturës së IT - Moodle tutorial, Luarasi</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Nga vëzhgimi i bërë rezultoi se faqja zyrtare e çeb e Universitetit Luarasi: ee.luarasi-univ.edu.al është një faqe aktive, e cila mban të gjithë informacionin e nevojshëm dhe të detajuar mbi aktivitetet akademike dhe extra kurrikulare që ofrohen nga UL. Sic deklarohet vetë edhe nga Institucioni hulumtimi i faqes zyrtare të institucionit, është i publikuar vetëm në gjuhën shqipe. Faqja në gjuhën angleze është ende në proces zhvillimi dhe përditësimi. <u>GVJ sugjeron vendosjen e rubrikave të ëbsite të UL-së edhe në gjuhën angleze.</u>			
Konkluzione	<i>Institucioni disponon sistem menaxhimi efektiv nëpërmjet të cilit administron informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</i> <i>Sistemi i menaxhimit ka të integruar disa platforma të cilat mundësojnë një komunikim interaktiv me studentët, si edhe shkëmbim informacioni, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</i> <u>GVJ sugjeron vendosjen e rubrikave të ëbsite të UL-së edhe në gjuhën angleze.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare është një komponent i rëndësishëm që siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe qëndrueshmërinë e programit të studimit. Bazuar në legjislacionin në fuqi, institucioni harton çdo vit planin buxhetor vjetor. Bordi i administrimit, me propozim të Senatit Akademik miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit, si dhe mbikqyr zbatimin e tyre. Referuar RVB-së, raportet hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë. Referencë: <i>Evidenca Nr. 13 - Rregullore e Universitetit Luarasi</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	UL nuk ka plan të financimit të njësisë bazë, por e harton këtë plan në nivel institucional. Nuk ka një plan të dedikuar financiar, por është i përfshirë në planin financiar të institucionit, ku janë të parashikuara sipas zërave kostot dhe të ardhurat përkatëse nga ky program studimi.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e	Është evidentuar nga GVJ se pjesë e evidencave të paraqitura nga GVB për këtë program studimi janë raportet vjetore të auditimit dhe pasqyrat financiare përkatëse për UL. Universiteti çdo vit, i

financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	nënshtrohet kontrollit dhe procesit të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm. Auditimi i brendshëm realizohet nga strukturat administrative të auditimit të brendshëm. Këto struktura hartojnë në mënyrë periodike raporte mbi veprimtarinë financiare të institucionit të cilat i paraqiten autoriteteve drejtuese. Struktura kryesore për mbarëvajtjen financiare dhe administrative është Bordi i Administrimit. Bordi përcakton rregulla për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni, si dhe mbikqyr përdorimin e burimeve të financimit. Referencë: <i>Evidenca nr. 68 - Pasqyrat Financiare 2023</i> <i>Evidenca nr. 69 - Raporti Audituesit 2023</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Është konstatuar nga GVJ që program i studimit “Master i Shkencave” në “E drejtë Civile dhe Tregtare” nuk ka një plan të dedikuar financiar, por është i përfshirë në planin financiar të institucionit, ku janë të parashikuara sipas zërave kostot dhe të ardhurat përkatëse nga ky program studimi.
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Konstatohet se UL ka kapacitetet për të mundur funksionimin normal të aktivitetit të tij dhe për të garantuar mbështetje financiare në veprimtarinë akademike shkencore dhe administrative. Të ardhurat e institucionit krijohen nga veprimtaritë e mësimdhënies, tarifat e studentëve, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, shërbimet, si dhe veprimtari të tjera ekonomike të ligjshme.
Konkluzione	<i>Universitetit “Luarasi” i nënshtrohet procesit të auditimit vjetor të brendshëm dhe të jashtëm financiar.</i>

	<i>UL nuk harton plan financimi (të ardhura dhe shpenzime) për programin e studimit në proces akreditimi, por e harton këtë plan vetëm në nivel institucional, si IAL.</i> <i>UL harton dhe zbaton buxhetin financiar duke mbajtur në konsideratë shpenzimet dhe nevojat për realizimin e të gjithë programeve të studimit, që ofron IAL-ja</i> <i>UL ka kapacitetet për të mundësuar funksionimin normal të aktivitetit të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe nga faqja ëeb e UL-së, GJV konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore. Institucioni ka hartuar dhe zbaton një bazë rregullatore mjaft të detajuar të përbërë nga rregullore në nivel institucional, njësie kryesore, njësie bazë si dhe programi studimi. Këto akte përmbajnë përcaktime mbi politikat që institucioni zbaton dhe procedurat që ndjek, dhe mbulojnë edhe aspektet lidhur me ciklin akademik të studentëve nga hyrja në dalje.

	Referencë: <i>Evidenca Nr. 12 - Statuti i UL-s ;</i> <i>Evidenca 13-Rregullore e UL(part1);</i> <i>Evidenca 17 - Rregullore e Fakultetit te Drejtësisë;</i> <i>Evidenca 16- Rregullore e Departamentit të së Drejtës Private;</i> <i>Evidenca Nr. 6 - VSA "Për miratimin e Planit Strategjik të Zhvillimit të UL, për vitet 2021-2025;</i> <i>Rregullore e programit Master i Shkencave "E drejtë Civile dhe Tregtare"</i> <i>Evidenca nr. 71 - Rregullore e Bursave Studentore & Formulari aplikimi për bursë.</i> <i>Evidenca nr. 72 - Tarifat studentore vitet akademike 2018-2023;</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Barazia e të drejtave për kandidatët dhe studentët e programit të studimit garantohej nga statuti i UL-së, rregullore e Fakultetit të Drejtësisë, rregullore e Departamentit dhe rregullore e Programit të studimit. Kriteret e përcaktuara për regjistrimin në këtë program studimi janë kriteret të hartuara në përputhje me udhëzimet dhe aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Kriteret të tilla si, përfundimi i ciklit të parë të studimeve, apo njohja e gjuhës së huaj, janë kriteret të përbashkëta për të gjitha programet e ciklit të dytë të studimeve. Nga takimi me studentët nuk u konstatuan mangësi në lidhje me njohjen dhe respektimin e barabartë të të drejtave të studentëve në këtë program studimi. Referencë: <i>Evidenca Nr. 12 - Statuti i UL-s</i> <i>Evidenca 13-Rregullore e UL(part1);</i> <i>Evidenca 17 - Rregullore e Fakultetit te Drejtësisë;</i> <i>Evidenca 16- Rregullore e Departamentit të së Drejtës Private;</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti	Kriteret specifike për pranimin e studentëve janë propozuar nga Departamenti dhe janë miratuar me Vendim të Senatit

akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Akademik për programin e studimit, në përputhje me kërkesat ligjore. Numri maksimal i studentëve që mund të regjistrohen dhe mënyrat e përzgjedhjes së tyre, janë bërë publike çdo fillim viti akademik para fillimit të regjistrimeve. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit të studentëve gjendet edhe online në adresën e institucionit. UL zhvillon edhe takime nëpër rrethe me maturanët, ditët e hapura në UL dhe pjesëmarrjet e përvitshme në panaire të ndryshme lidhur me punësimin, si dhe aktivitete të tjera, ku UL mund të prezantojë ofertën akademike të tij dhe mundësitë për bursa, i mundësojnë UL të pranojë çdo vit studentë nga shumë qytete të Shqipërisë. Referencë: <i>Evidenca nr. 74 - Të dhëna nga Faqja zyrtare e ËEB (për kriteret përkatëse)</i> <i>Evidenca 17 - Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë;</i> <i>Evidenca 16- Rregullore e Departamentit të së Drejtës Private;</i> <i>Evidenca Nr. 75 - Udhërrëfyshi i Studimit 2023-2024</i> <i>Evidenca nr. 73 - Praktika e plotë e miratimit të kuotave të pranimit në programet e studimit që janë ofruar në vitin akademik 2023-2024;</i> <i>Evidenca nr. 77 - Të dhëna statistikore: Raporti statistikor raportuar në MAS çdo vit akademik.</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, si dhe konsultimit të faqes ëeb të UL, GVJ konstatoi se kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimi përgjatë kursit të studimit, procedurave të transferimit, njohjes së plotë ose të pjesshme të studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të aksesueshme nga publiku: - Në sekretarinë mësimore të Fakultetit të Drejtësisë; - Afishimit të informacionit në stenda në ambjentet e Fakultetit dhe në godinat e tjera ku zhvillon aktivitetin UL; - Faqen ëeb të UL-së;

	Kriteret dhe procedura e pranimi të studentëve respektojnë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Referencë: <i>Evidenca nr. 10 - VSA për miratimin e Rregullores të PS ;</i> <i>Rregullore e programit Master i Shkencave "E drejtë Civile dhe Tregtare"</i> <i>Udhëzimi Nr. 18, datë 21.5.2018 Kreu IV/4 Dhe Kreu IV/5 Fq 20-22;</i> <i>Evidenca Nr. 77 - Të dhëna statistikore: Raporti statistikor raportuar në MAS çdo vit akademik</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Referuar RVB-së, Universiteti "Luarasi" nëpërmjet faqes zyrtare ëeb, publicitetit në televizionin Neës 24 dhe botimit të broshurës informuese, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të këtij programi studimi. Ky informacion përfshin aspekte mbi llojet e programeve që institucioni ofron, procedurën, bazën ligjore dhe kriteret e përzgjedhjes në këto programe. Referencë: <i>Faqja zyrtare UL:</i> <i>Evidenca Nr. 78 - Guida Luarasi</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Referuar RVB-së, UL harton dhe publikon në faqen zyrtare informacionin dhe guidën studentore në lidhje me kuotat, kriteret dokumentacionin e nevojshëm si dhe ofertat financiare, apo bursat e plota apo të pjesshme. Aktet rregullatore, përcaktojnë kriteret për përfitimin e bursave për kategori të ndryshme. Gjatë periudhës së regjistrimit, të interesuarve iu ofrohet i gjithë informacioni i nevojshëm mbi programin e studimit, përfshirë edhe mundësitë për përfitimin e bursave, apo lehtësitë për shtresat në nevojë. Bordi i administrimit merr vendime financiare edhe në situata të veçanta, sipas dinamikës së zhvillimeve institucionale, në bashkëpunim me Senatin Akademik.

	Referencë: <i>Evidenca nr. 78 - Guida Luarasi (Java e orientimit për studentët e rinj)</i> <i>Evidenca nr. 79 - Urdhër për ngritjen e Grupit të Punës për takime me maturantët.</i>			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Referuar RVB-së, UL publikon në faqen zyrtare informacionin dhe guidën studentore në lidhje me kuotat, kriteret dokumentacionin e nevojshëm për studentët nga shtete të tjera. Veç kësaj këta kandidatë duhet të paraqesin kopjen e diplomës dhe listës së notave të njehsuar nga QSHA. Referencë: <i>Faqja zyrtare UL: ee.luarasi-univ.edu.al</i> <i>Evidenca Nr. 78 - Guida Luarasi.</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UL ofron bursa të plota ose të pjesshme të studimit, mbi bazën e disa kriterëve përzgjedhjeje si: notës mesatare të lartë apo ata nga familje me probleme social-ekonomike apo familje në nevojë, me synimin për të nxitur cilësinë në hyrje të studentëve, si dhe për t'u ardhur në ndihmë shtresave në nevojë. Referencë: <i>Evidenca nr. 71 - Rregullore e Bursave Studentore & Formulari aplikimi për bursë.</i>			
Konkluzione	<i>Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe aprovimit prej MAS, duke qenë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</i> <i>Ka një bashkëpunim të mirë ndërmjet hallkave të ndryshme të institucionit në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me pranimin e studentëve.</i> <i>Institucioni ka të parashikuar ndjekjen e politikave lehtësuese për studentët që vijnë nga disa kategori të veçanta sociale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare ëeb të UL-së, GVJ konstatoi se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve dhe moduleve të mëparëshme në rast transferimi studimesh. Këto kriteret dhe procedura janë pjesë e Rregullores së UL-së, rregullores së Fakultetit dhe veçanërisht të Rregullores së programit të studimit. Rregullore e UL-së është e publikuar në faqen zyrtare ëeb të institucionit. Një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve luan edhe Këshilli Studentor, ose Komisioni i Veprimtarisë Akademike dhe Marëdhënieve me Studentët, i cili ka si pjesë të kompetencave të tij edhe marrjen e informacioneve nga njësitë përbërëse të institucionit për çështje dhe probleme të paraqitura nga studentët. Sekretaria mësimore informon studentët lidhur me orarin mësimor, kalendarin e provimeve, etj. Referencë: <i>Evidenca nr. 80 - Kalendar Akademik</i> <i>Evidenca nr. 10 - VSA "Për miratimit e Rregullores: Programi MSH E Drejtë Civile dhe Tregtare"</i> <i>Rregullore e programit Master i Shkencave "E drejtë Civile dhe Tregtare"</i> <i>Evidenca nr 28 - Syllabuse të lëndëve të programit të studimit.</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e	UL lejon transferimin e studentëve në hyrje dhe në dalje brenda programeve të të njëjtiti cikël studimi, nëpërmjet IAL publike dhe private, vendase apo të huaja në përputhje me procedurat e

njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	parashikuara në aktet nënligjore në fuqi dhe aktet të brendshme të institucionit. Rregullorja e programit ka të përcaktuar kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme të studentëve. Referencë: <i>Evidenca Nr. 10 - VSA "Për miratimin e Rregullores për "Programi MSH E Drejtë Civile dhe Tregtare"</i> <i>Rregullore e programit Master i Shkencave "E drejtë Civile dhe Tregtare"</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konkludoi që studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit. Elementë më të detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët përkatës në seancën e parë, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve të syllabusit të lëndës dhe duke detajuar tipologjinë e lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat përkatëse, metodologjinë e të nxënit (leksione, seminare, konsultime, punë në grup, punë individuale etj), mënyrën e vlerësimit (provim ndërmjetës, provim përfundimtar dhe komponentë të tjerë), kriteret e vlerësimit si dhe literaturën përkatëse. Referencë: <i>Evidenca Nr. 10 - VSA "Për miratimin e Rregullores për "Programi MSH E Drejtë Civile dhe Tregtare"</i> <i>Rregullore e programit Master i Shkencave "E drejtë Civile dhe Tregtare"</i> <i>Evidenca nr. 28 - Shembuj Syllabuse.</i> <i>Syllabus-et e lëndëve të programit të studimit MSHDCT</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të	Rregulloret e institucionit (UL, Fakultet, Departament, Program Studimi) japin një informacion të qartë mbi procedurën e diplomimit. Tema e diplomës vlerësohet me notë dhe kredite ECTS. Diploma në ciklin e dytë të studimeve mbrohet me temë diplome. Departamenti shpall brenda afatit të

diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	përcaktuar temat e diplomës. Tema dhe udhëheqësi i propozuar nga Departamenti miratohen nga Dekani i Fakultetit. Referuar takimit me studentët gjatë vizitës në institucion, studentët ishin të mirëinformuar për mënyrën dhe procedurat e diplomimit, gjatë viteve të studimeve. Referencë: <i>Evidenca Nr. 10 - VSA "Për miratimin e Rregullores për "Programi MSH E Drejtë Civile dhe Tregtare"</i> <i>Rregullore e programit Master i Shkencave "E drejtë Civile dhe Tregtare"</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë gjatë vizitës në institucion, si dhe në faqen ëeb të UL-së, GVJ konstatoi se Institucioni realizon aktivitete si: - fushatë sensibilizuese me studentët që aktualisht ndjekin studimet bachelor në UL; - afishim të informacionit në mjediset e UL-së; - komunikim në rrjetet sociale; - publicitetit në televizionin Neës 24; - vizitat e të interesuarve në institucion; - publikimi në faqen ëeb të UL-së; për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi këtë dhe programe të tjera studimi që ofron Institucioni. Referencë: <i>Evidenca nr. 74 - ËEB Programi mësimor</i> <i>Evidenca Nr. 78 - Guida Luarasi.</i>
Konkluzione	<i>Studentëve u vihet në dispozicion një informacion i gjerë në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, elementët detyrues të tij si dhe kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</i> <i>Në aktet e tij rregullatore UL-së ka të parashikuara dhe garantohen procedurat për njohjen dhe ekuivalentimin e kualifikimeve.</i>

	<i>Procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit janë të specifikuar në rregulloret e institucionit dhe syllabuset e lëndëve.</i> <i>Elementë të detajuar në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit jepen në udhëzuesin përkatës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjatë takimit me studentët e programit të studimit, GVJ konstatoi se ata janë të mirë informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Informimi i tyre realizohet nëpërmjet zyrave të Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Marketingut, Marrëdhënieve (në forma të ndryshme komunikimi) dhe në prezantimin e realizuar në fillim të studimeve. Gjithashtu një informacion i detajuar dhe i aksesueshëm në mënyrë të vazhdueshme është dhe ai nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të UL-së. Rrugë të tjera të përfuturit të informacionit janë Sekretaria Mësimore dhe rrjetet sociale. Referencë: <i>Evidenca Nr. 80 - Kalendar Akademik</i> <i>Evidenca Nr. 10 - VSA "Për miratimin e Rregullores për "Programi MSH E Drejtë Civile dhe Tregtare";</i> <i>Rregullore e programit Master i Shkencave "E drejtë Civile dhe Tregtare"</i> <i>Evidenca Nr. 74 - ËEB Programi mësimor</i> <i>Evidenca Nr. 78 - Guida Luarasi</i>

	<i>Evidenca Nr. 81 - Rregullore e Zyrës së Marketingut</i> <i>Evidenca Nr. 82 - Rregullore e Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun</i> <i>Evidenca Nr. 83 - Leksione te Hapura dhe Aktivitete të tjera të organizuara nga Universiteti Luarasi.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ u informua se institucioni shpërndan informacion nëpërmjet faqes së internetit, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës si dhe nëpërmjet pedagogëve të lëndëve. Syllabuset, që çdo pedagog prezanton në fillim të lëndës, japin një informacion të detajuar e të qartë për përmbajtjen e lëndës, veprimtaritë formuese dhe kërkesat që studenti duhet të plotësojë për përparimin e tij akademik. Gjithashtu Udhërrëfyshi i Studimit” i përvitshëm i UL u ofron studentëve informacion thelbësor në lidhje me programet e studimit që ofron UL.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ konstatoi se një rol të veçantë në drejtim të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës luan Zyra e Zhvillimit të Karrierës, e cila ka si mision zhvillimin personal të studentëve nëpërmjet leksioneve dhe trajnimeve rreth karrierës, nxjerrjen në pah të mundësitë të zhvillimit të karrierës, ndërthurjen e aftësive dhe vlerave, dhe lehtësimin e kalimit nga akademia në tregun e punës me anë të bashkëpunimeve/partneriteteve me organizata të ndryshme. Qëllimi i kësaj zyre është të ndihmojë studentët në përgatitjen dhe ndjekjen e karrierës së tyre për internshipe, punësim, evente dhe panairë karriere, trajnime dhe Ëorkshop-e me synim zhvillimin personal dhe profesional të karrierës etj. Zyra është përgjegjëse edhe për organizimin e ditëve të karrierës të dedikuara drejt informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit në përputhje me degët, profilet dhe ciklet e studimit që kanë zgjedhur. Referencë: <i>Evidenca nr. 84 - Rregullore “Zyra e Studentit dhe e Karrierës”.</i>

	<i>Evidenca nr. 24 – Institucionet dhe Organizat bashkëpunuese me Luarasin.</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstatoi se, pedagogët e departamentit, në javën e parë të fillimit të studimeve, pedagogët e angazhuar në këtë program studimi në orën e parë të fillimit të lëndës së tyre, sekretaria mësimore, luajnë një rol kyç në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Faqja ëeb e UL-së si dhe rrjetet sociale luajnë gjithashtu një rol thelbësor në ofrimin dhe përditësimin e informacionit në lidhje me elementë të rëndësishëm të procesit mësimor. Referencë: <i>Evidenca nr. 80 - Kalendari Akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca nr. 18 - Model Orari mësimor.</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nëpërmjet faqes Eëb të UL-se dhe hapësirës së dedikuar në platformat elektronike, studentët e këtij programi studimi mund të informohen edhe në distancë lidhur me strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, të konsultojnë vlerësimin e vazhduar dhe atë përfundimtar sipas lëndëve që kanë frekuentuar, orarin e provimeve, etj, si dhe të informohen lidhur me infrastrukturën dhe aktivitete të tjera të organizuara në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe universiteti. Këto platforma dhe module jo vetëm mundësojnë komunikimin në kohë reale midis studentëve dhe pedagogëve, por edhe monitorimin e veprimtarisë akademike dhe gjithë komponentëve të procesit të mësimdhënies. Referencë: <i>Evidenca nr. 66 - Udhëzues për përdorimin e Strukturës së IT - Moodle tutorial, Luarasi</i>
Konkluzione	<i>Studentët informohen në fillim të vitit akademik, si dhe gjatë gjithë periudhës së studimeve për të gjithë detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor si edhe elementët ndihmës në funksion të tij.</i>

	<i>Zyra e Zhvillimit të Karrierës, si dhe pedagogët e departamentit të së Drejtës Private, ofrojnë informacion për mundësitë e punësimit të studentëve.</i> <i>Studentët janë të përditësuar dhe kanë si akses fizik ashtu edhe online, në informacionin në lidhje me procesin mësimor, infrastrukturën, logjistikën dhe elementë të tjerë mbështetës të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Sekretaria mësimore e UL-së është një nga strukturat më të rëndësishme për mbajtjen e statistikave për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Të dhënat përpunohen prej saj dhe ruhen si në format fizik (regjistrat themeltar, regjistrat e lëshimit të diplomave) ashtu dhe në format elektronik. Këto statistika administrohen dhe gjenerohen në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore. Sekretaria Mësimore pranë Fakultetit të Drejtësisë mban dhe administron të dhëna mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar në programin e studimit. GVJ zhvilloi edhe një vizitë në Sekretarinë Mësimore dhe konstatoi se plotësimi i regjistratit themeltar dhe regjistratit të lëshimit të diplomave janë në përputhje me standardet dhe udhëzimet e MAS. Referencë: <i>Evidenca Nr. 12 - Statuti i UL-s</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të	Sekretaria mësimore e Fakultetit të Drejtësisë mbledh, regjistron dhe përditëson të dhënat lidhur me studentët e regjistruar në këtë program studimi, për ecurinë mësimore të

regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	tyre gjatë ciklit të studimeve dhe diplomimin e tyre. Regjistrat në sekretari janë të formatuar sipas standardeve shtetërore. Gjatë vizitës në sekretari, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecures akademike të dy studentëve të programit të studimit. Të dhëna për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi janë: Viti akademik 2021-2022 -- 62 studentë; Viti akademik 2022-2023 -- 47 studentë; Viti akademik 2023-2024 -- 15 studentë;
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UL-së. Pranë sekretarisë mësimore informacioni ruhet në formatin letër (versioni hard copy) dhe në sistemin e menaxhimit informatik ruhet në versionin elektronik (soft copy). Të dy mënyrat e ruajtjes lehtësojnë kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe japin siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Referencë: <i>Evidenca Nr. 85 - Të dhëna të plota për punësimin real të studentëve.</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Struktura kryesore përgjegjëse për administrimin e informacionit mbi të dhënat e studentëve është Sekretaria Mësimore. Informacion mbi të dhënat e studentëve disponojnë edhe një sërë strukturash të tjera si departamentet, dekanati, rektorati etj. GVJ Konstatoi se UL ka implementuar sistemin "Pitagora" të ofruar nga RASH. Nëpërmjet këtij sistemi institucioni administron dhe menaxhon informacionin mbi të dhënat akademike të studentëve në sistemin elektronik. Të dhënat e këtij sistemi administrohen edhe nga personeli përgjegjës i zyrës së IT.

Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Departamenti i së Drejtës Private analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve për secilin program studimi (statistika referuar notës mesatare në hyrje dhe në dalje të studentëve). Ky informacion është pjesë e analizës së veprimtarisë së departamentit për vitin akademik, i cila mbyllet me problematikat dhe shoqërohet me rekomandime për përmirësime. Nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohen të dhënat mbi cilësinë në hyrje të studentëve si vijon: - për vitin akademik 2021-2022, nota mesatare e studentëve në hyrje është 7.59; - për vitin akademik 2022-2023, nota mesatare në hyrje është 7.7; - për vitin akademik 2023-2024 nota mesatare në hyrje është 7.64;			
Konkluzione	<i>Sekretaria mësimore e UL-së është një nga strukturat më të rëndësishme për mbajtjen e statistikave në lidhje me studentin. Të dhënat përpunohen dhe ruhen si në format fizik (regjistrat themeltar, regjistrat e lëshimit të diplomave) dhe në versionin elektronik.</i> <i>Të dhënat në sistem përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke mundësuar edhe gjenerimin e të dhënave që shërbejnë për raportime të ndryshme.</i> <i>Veprimtaria e Sekretarisë mësimore dhe njësive të tjera administrative kontrollohet në mënyrë periodike nga strukturat e ngarkuara nga institucioni.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, në Rregulloren e përgjithshme si dhe Statut, rezulton se UL u mundëson studentëve përfaqësimin në organet e UL-së, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Ata marrin pjesë në të gjitha proceset e vendimmarrjes së UL-së, në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore. Statuti (neni 73) dhe Rregullorja e Fakultetit të Drejtësisë parashikon të drejtën e studentëve të organizohen në Këshilla Studentorë në nivel të Fakultetit dhe Universitetit si organizime të pavarura të studentëve. Studentët marrin pjesë: - Këshilli Studentor; - Senati Akademik; - Këshilli Etikës; - NJBSC; Referencë: <i>Evidenca 12-Statuti i UL;</i> <i>Evidenca 17 - Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë;</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konstaton se aktualisht UL përdor sistemin e pyetësorëve me studentët për vlerësimin e stafit akademik dhe lëndëve sipas programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Përpunimi i të dhënave të pyetësorëve realizohet nga zyra e NJBSC dhe përfundon me hartimin e një Raporti, i cili u komunikohet organeve drejtuese, individualisht secilit prej pedagogëve, dhe më pas përgjegjësit të njësisë bazë për të analizuar rezultatet dhe marrjen e masave përkatëse. Gjithashtu departamenti i përgjegjës për këtë program studimi, mirëpret sugjerimet, vërejtjet dhe rekomandimet e studentëve në çdo kohë, nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë dhe kordinatorit të programit të studimit. Referencë: <i>Evidenca Nr. 13 - Rregullore e Universitetit Luarasi;</i>

Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Fakulteti i Drejtejtësisë dhe veçanërisht Departamenti i së Drejtës Private, përgjegjës për këtë program studimi marrin në konsideratë mendimin dhe opinionin e studentëve (vërejtjet, sugjerimet, komentet) nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë, si dhe nëpërmjet kordinatorit të programit, në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ndërkohë zyra e NJSBC-së përpunon të dhënat e pyetësorëve, për lëndët që zhvillohen në këtë program. Ky feedback i jep mundësi reflektimi pedagogut të lëndës për problematika që mund të hasen, por edhe më gjerë pasi Përgjegjësi i Departamentit mund të kalojë për diskutim në mbledhje departamenti problematikave e ngritura duke marrë vendime përkatëse në hartim, rishikim dhe përmirësim programi. Programet e studimit i nënshtrohen në mënyrë periodike rishikimit në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi. Referencë: <i>VKM Nr. 879, datë 18.12.2019;</i> <i>Evidenca Nr. 10 – VSA për miratimin e Rregullores së këtij programi studimi.</i> <i>Rregullore e programit Master i Shkencave “E drejtë Civile dhe Tregtare”</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Procesi i vlerësimit dhe kontrollit të dijeve bazohet në aktet rregullatore të institucionit të cilat përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për të pasqyruar ndryshimet në aktet ligjore dhe nënligjore. Këto procedura synojnë të garantohet barazia dhe ndershmëria e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentëve u njihet e drejta e apelimit të rezultateve të provimit. Nëse studenti nuk është i kënaqur me vlerësimin përfundimtar, atëherë studenti ka të drejtë të paraqesë me shkrim kundërshtimin e rezultatit të provimit. Studentët mund të ushtrojnë të drejtën e ankimimit brenda tre ditëve nga marrja e dijeni mbi vlerësimin. Përgjegjësi i Departamentit ngre për këtë qëllim edhe një komision ad-hoc, i cili përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit.
	Referencë:

	<i>Evidenca Nr. 10 - VSA për miratimin e Rregullores së këtij programi studimi;</i> <i>Rregullore e programit Master i Shkencave "E drejtë Civile dhe Tregtare";</i>			
Konkluzione	<i>UL garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat, Këshillin e Etikës, NJSBC, si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm e përgatitjen e RVB.</i> <i>Studentët e UL janë të organizuar në Këshillin e Studentëve, duke mundësuar shprehjen e mendimeve dhe paraqitjen e propozimeve për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit.</i> <i>Tërheqja e mendimit të studentëve për programin e studimit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse të UL-së si dhe nëpërmjet përpunimit të pyetësorëve të vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në UL në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve funksionon Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës e cila shërben si një udhëzues për Studentin gjatë gjithë udhëtimit të tij akademik, duke ofruar shërbime që synojnë të përmirësojnë përvojën e studentëve në jetën në kampus, të mbështesin krijimtarinë dhe ambiciet e tyre, si dhe të ofrojnë zgjidhje për problemet e ndryshme me të cilat mund të përballen studentët. Kjo zyrë funksionon sipas një rregulloreje të veçantë. Nga takimet në këtë zyrë GVJ arriti në konkluzionin se ajo përbën një hallkë të rëndësishme në mbështetjen e studentëve.

	Në shërbim të informimit dhe shërbimit ndaj studentëve është dhe Sekretaria mësimore e UL-së. Referencë: <i>Evidenca Nr. 13 - Rregullore e Universitetit Luarasi</i> <i>Evidenca nr. 84 - Rregullore "Zyra e Studentit dhe e Karrierës".</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sekretaria Mësimore, Departamenti i së Drejtës Private si dhe personeli akademik ndjekin në vazhdimësi ecurinë e studentëve si dhe asistojnë studentët në çështje që lidhen me procesin mësimor. Pranë Sekretarisë Mësimore studentët marrin informacion dhe asistohen mbi aspekte të procesit mësimor gjatë gjithë vitit akademik. Njokohësisht, mund të kërkojnë realizimin e shërbimeve të tilla si: marrjen e dokumentacionit, vërtetimeve etj. Departamentet dhe personeli akademik gjatë kohëzgjatjes së procesit ndihmon, mbështet dhe asiston studentët mbi çështje që lidhen me mbarëvajtjen e programit të studimit. Universiteti ka ngritur për këtë qëllim edhe struktura të dedikuara. Referencë: <i>Evidenca nr. 84 - Rregullore "Zyra e Studentit dhe e Karrierës".</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të	Shërbimi i këshillimit të karrierës në UL mbulohet nga Zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës. Kjo zyrë ka si qëllim të mbështesë integrimin e studentëve në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës duke i ndihmuar ata në përgatitjen dhe ndjekjen e Karrierës së tyre për internshipe, punë, evente dhe panairë karriere, trajnime dhe Ëorkshop-e, me synim zhvillimin personal dhe profesional të karrierës. GVJ u informua për një numër aktivitete të kësaj zyre në shërbim të fitimit të kompetencave për t'u orientuar në tregun e punës. Kjo zyrë, mbështetur në marrëveshjet e bashkëpunimit që ka nënshkruar institucioni, kontribuon fuqishëm në krijimin e mundësive të zhvillimit të praktikës profesionale dhe në orientimin në tregun e punës.

tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Referencë: <i>Evidenca nr. 84 - Rregullore "Zyra e Studentit dhe e Karrierës".</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Një nga detyrat e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës është dhe ndjekja e studentëve pas diplomimit. Për këtë është konceptuar dhe është funksionale një databazë e të gjithë studentëve të cikleve të studimit të diplomuar, përfshirë pozicionin e tyre të punës apo nëse ata janë akoma në kërkim të punës. Këto të dhëna shërbejnë për të identifikuar nivelin e punësimit të të diplomuarve në nivel programi. Anëtarët e kësaj zyre janë certifikuar përmes programit të certifikimit ndërkombëtar GCDF – Global Career Development Facilitator. Kjo zyrë realizon kontakte të vazhdueshme me aktorë të ndryshëm të biznesit, kompani private, institucione publike, zyra noterie dhe avokatie etj, për t'ju mundësuar studentëve praktika profesionale, por dhe për t'ju ofruar mundësi punësimi. Referencë: <i>Evidenca nr. 84 - Rregullore "Zyra e Studentit dhe e Karrierës".</i> <i>Evidenca Nr. 85 - Të dhëna tabelore për punësimin real të studentëve.</i>
Konkluzione	<i>Në UL në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve funksionon Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, dhe Sekretaria Mësimore struktura të cilat janë shumë aktive dhe janë ndërtuar e funksionojnë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</i> <i>Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës në UL luan një rol të rëndësishëm në informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</i>

	<i>Studentëve të Universitetit "Luarasi" u mundësohet shërbimi i këshillimit të karrierës, mbështetja në zhvillimin e praktikës profesionale dhe orientimi drejt tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ konstatoi se programi i studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Civile dhe Tregtare" zhvillohet në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe kërkesave specifike shprehur në aktet rregullatore të UL-së dhe në objektivat strategjike të tij, në veçanti për këtë program studimi. Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit ka në fokusin e saj përkushtimin ndaj metodologjive të reja të mësimdhënies dhe risive me ndikim mësimor dhe kërkimor. Nga takimet me pedagogë të angazhuar në realizimin e programit të studimit GVJ u informua se personeli akademik, mbështetur dhe nga një infrastrukturë dhe mjete didaktike të kohës, ka në fokusin e tij përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Kontribut të veçantë në këtë drejtim kanë dhe shkëmbimet me institucione partnere jashtë vendit, në mënyrë të veçantë mobilitetet e personelit akademik në këto institucione.

	Referencë: <i>Evidenca Nr. 86 - Vendim mbi ngritjen e NJSBC;</i> <i>Evindenca nr. 6 - Plani Strategjik i Zhvillimit të UL-s 2021-2025</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	UL, në përputhje me e Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin dhe Rregulloren e institucionit, me Vendim të Senatit Akademik të UL, ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë. Institucioni bën monitorim të vazhdueshëm dhe vlerësim periodik të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik, kryesisht nëpërmjet bashkëpunimit të drejtuesve të departamenteve, fakulteteve, dhe të dhënave të mbledhura nga NJBSC. <u>Mekanizmat kryesorë që përdoren janë:</u> - pyetësi i studentëve (për stafin akademik dhe për lëndët e kurrikulës së programit); - monitorimi i procesit mësimor; - formulari i vlerësimit të performancës së stafit akademik; Departamenti si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit, mbikqyr gjithashtu cilësinë e misimdhënies të stafit akademik. Referencë: <i>Evidenca Nr. 88 - Formulari i vlerësimit të personelit akademik.</i> <i>Evidenca Nr. 89 - Rregullore e organizimit dhe funksionimit të NJBSC, miratuar me vendim të Senatit Akademik nr.10, datë 25.01.2024.</i> <i>Evidenca Nr. 90 - VSA nr.22 datë 13.11.2023 “Për Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”.</i> <i>Evidenca nr. 91 - Formular i vlerësimit të studentëve/stafit akademik dhe administrativ për UL.</i> <i>Evidenca Nr. 92 - Raporti i monitorimit të procesit mësimor në bazë semestri/viti akademik.</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e	Nga evidencat e paraqitura dhe takimet e zhvilluara me studentët, u konstatua se studentët ishin pjesmarrës aktivë në vlerësimin

studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	periodik të metodave të mësimdhënies dhe programeve të studimit. Gjithashtu, studentët kishin zërin e tyre në përbërje të organeve kolegjiale vendimmarrëse të UL-s. Kjo e bën angazhimin e tyre real dhe frytdhënës. Në takimin e zhvilluar me studentët GJV i pyeti ato për procedurën e ankimimit dhe rezultoj që ishin të mirëinformuar dhe se e drejta ankimimit ishte një e drejtë e rregulluar në përputhje me standardet ligjore në aktet e brendshme të IAL-së. Referencë: <i>Evidenca Nr. 12 - Statuti i UL-s</i> <i>Evidenca Nr. 75 - Udhërrëfyeti i Studimit 2023-2024.</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies përdoren një sërë instrumentash, ndër të cilat edhe pyetësi i studentëve. Rezultatet që dalin nga pyetësorët, NJSBC i pasqyron në raportin vjetor të vetvlerësimit. Personeli akademik përfshihet në procesin e vlerësimit të cilësisë edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në organet të tilla si NJSBC nëpërmjet përfaqësuesve të tij. NJSBC ka detyrim që rrjedh nga rregullorja e funksionimit të saj, komunikimin e procesit të vlerësimit. NJSBC u komunikon të gjitha njësive fillimin e procesit të vlerësimit që në momentet e para. Gjatë gjithë procesit të vlerësimit është gjithashtu detyrim përfshirja e të gjitha njësive. Referencë: <i>Evidenca Nr. 93 - Procesverbal i NJBSC nr.10 prot., datë 18.01.2024, Mbi zhvillimin e Pyetësorit Studentor.</i> <i>Evidenca Nr. 94 - Trajnimi i stafit akademik për metodat bashkëkohore të mësimdhënies, certifikata apo vërtetime përkatëse.</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për	U evidentua që në UL dhe specifikisht në Fakultetin e Drejtësisë, personeli akademik me kohë të plotë, të cilët kanë avancuar me fitimin e gradave shkencore dhe titujve akademik janë promovuar si drejtues njësie bazë apo zyre tjetër të rëndësishme të organigramës së Universitetit.

përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Referencë: <i>Evidenca 13-Rregullore e UL(part1);</i> <i>Evidenca 12-Statuti i UL;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se kriteret në lidhje me sigurimin dhe standardizimin e cilësisë në metodologjinë dhe procesin e mësimdhënies, përmbushen më së miri nga institucioni.</i> <i>NJBSC luan një rol aktiv dhe efikas në garantimin dhe vlerësimin e cilësisë në mënyrë periodike, duke evidentuar praktikën e mira dhe përmirësimet e mundshme në bashkëpunim me të gjitha strukturat e tjera të UL.</i> <i>NJBSC bën publike në mënyrë periodike raportet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë në mënyrë që të merren të gjitha masat për përmirësimin e saj në vijim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se statuti i UL (<i>kreu VIII nenet 82 & 83</i>) përcaktojnë që Institucioni harton politika dhe procedura në funksion të sigurimit të cilësisë. Në rregulloren e UL-së (<i>neni 15</i>) është përcaktuar që Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë është struktura përgjegjëse për garantimin dhe sigurimin e cilësisë së programeve të studimit që ofron UL. Ky komision funksionon në përputhje me ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", Statutin dhe në Politikën dhe Dimensionet e Cilësisë në UL. Referencë:

	<i>Evidenca nr. 95 - Politikat e sigurimit të cilësisë në UL.</i> <i>Evidenca Nr. 90 - VSA nr.22 datë 13.11.2023 "Për Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë".</i> <i>Evidenca 12-Statuti i UL;</i> <i>Evidenca 13-Rregullore e UL (part1);</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Referuar RVB-së, rezulton se në UL në funksion të sigurimit të cilësisë janë ngritur: - Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC), e cila monitoron dhe mbikëqyr realizimin në praktikë të plan-veprimit të vetëvlerësimit të cilësisë. NJBSC-ja koordinon të gjitha aktivitetet që kanë si qëllim sigurimin e cilësisë dhe promovon kulturën e cilësisë në njësitë përkatëse; - Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (GBV) të cilësisë në çdo fakultet, të cilët janë përgjegjëse për procesin e vetëvlerësimit dhe për implementimin e plan-veprimeve për sigurimin e cilësisë në kuadër të aktiviteteve që ato kryejnë. GBV-të në çdo fakultet bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme me NJBSC kur hartojnë Raportin e Vetëvlerësimit të Brendshëm të Cilësisë; UL ka hartuar Politikat dhe Dimensionet e Cilësisë në UL, ku evidentohet qartësisht që Universiteti është i përkushtuar për të siguruar cilësi dhe kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet procedurave efektive të menaxhimit dhe organizimit të strukturave, të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e proceseve akademike dhe kërkimore si edhe të veprimtarisë menaxheriale të Universitetit. Fokusi i Institucionit për ti bërë këto struktura sa më efektive doli në pah edhe gjatë takimeve të GVJ-së gjatë vizitës në UL. Pjesë e NJSBC janë edhe ekspertë të jashtëm. Gjithashtu studentët kanë përfaqësuesit e tyre në përbërjen e NJSBC. Referencë: <i>Evidenca Nr. 97 - Raportet vjetore të NJBSC.</i> <i>Evidenca nr. 95 - Politikat e sigurimit të cilësisë në UL.</i> <i>Evidenca 12-Statuti i UL;</i>

Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Universiteti “Luarasi” është akredituar për herë të parë me Urdhërin nr.71, datë 18.02.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për akreditimin institucional të programit dhe diplomës të SHLUJ “Luarasi”. Në vazhdim Universiteti “Luarasi” i është nënshtruar procesit të riakreditimit institucional si dhe të programeve të studimit që ofron. Rezulton se programi i studimit “Master i Shkencave” në “E drejtë Civile dhe Tregtare” ka kaluar dy procese të sukseshme akreditimi (i pari në vitin 2013 me vlefshmëri 6 vite akademike dhe i dyti në vitin 2020 me vlefshmëri 4 vite akademike). Aktualisht ky është procesi i tretë i akreditimit. Përveç këtyre proceseve nga GVJ është konstatuar se UL nëpërmjet NJBSC kryen raporte vlerësimi të cilësisë në mënyrë periodike të paktën 1 herë në vit. Gjithashtu, cdo njësi kryesore në përfundim të vitit akademik harton një raport vjetor të veprimtarisë akademike-shkencore, raport ky i cili bëhet pjesë e raportit vjetor që depozitohet në MAS. Referencë: <i>Evidenca nr. 20 - Raporti Vjetor i UL-s.</i> <i>Evidenca 13-Rregullore e UL (part1);</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ referuar dokumentave të dorëzuara dhe vizitës në Institucion, konkludon që NJSBC përpunon të dhënat duke llogaritur tregues sasior dhe cilësor në lidhje me cilësinë e procesit mësimor në këtë institucion. Raportet e përgatitur iu dërgohen të gjithë strukturave sipas përcaktimeve në rregulloren e kësaj njësie. Strukturat drejtuese dhe në veçanti Departamenti i së Drejtës Private përgjegjës për këtë program studimi, marrin vendimet përkatëse në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit studimor. Referencë: <i>Evidenca nr. 20 - Raporti Vjetor i UL-s.</i> <i>Evidenca 95 - Politikat e sigurimit të cilësisë në UL;</i>
Konkluzione	<i>Konstatohet se Institucioni harton politika dhe procedura në funksion të sigurimit të cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore dhe rregullatore.</i>

	<i>UL ka hartuar Politikat e sigurimit të cilësisë në UL, ku evidentohet përkushtimi ndaj cilësisë.</i> <i>NJSBC përgatit raporte me tregues sasiore dhe cilësor, dhe ua dërgon strukturave përkatëse, të cilat marrin vendime në funksion të përmirësimit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ vlerëson dhe identifikon të gjitha mekanizmat dhe procedurat e ndjekura nga NJBSC e UL për të mbikëqyrur dhe ruajtur standarde të larta cilësie në proceset e mësimdhënies në IAL, specifikisht në programin e studimit “Master i Shkencave” në “E drejtë Civile dhe Tregtare” Rezulton se NJBSC ka të dokumentuar të gjitha proceset e vlerësimit të cilësisë që ajo ka kryer në institucion dhe që bashkëpunon me strukturat më të lartë akademike për ndjekjen me rigorozitet të zbatimit në praktikë të standardeve shtetërore të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. NJBSC ka hartuar dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, të cilat janë të miratuara. Referencë: <i>Evidenca Nr 98 - Manual i NJBSC</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të	Nga evidencat e paraqitura dhe verifikimi që bëri në terren GVJ, rezulton se në çdo fund semestri akademik NJSBC në

përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	bashkëpunim me dekanatet e fakulteteve realizon anketimin e studentëve (Bachelor dhe Master), me anën e të cilit realizohet vlerësimi i stafit akademik. Lidhur me anketimin e studentëve, GVJ konstaton se numri i studentëve që marrin pjesë në anketim është disi i ulët. Aktiviteti i NJSBC-së ka një sistem raportimi vjetor dhe kryesisht në formën e një raporti analize mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, si dhe kurrikulën e çdo program studimi. Në raportet e vlerësimeve evidentohen problematikat si dhe propozohen zgjidhje për përmirësimin e treguesve të cilësisë. Raporti i vetvlerësimit i hartuar nga NJSBC shërben si burim për reflektim mbi komponentët ku duhet ndërhyrë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Referencë: <i>Evidenca nr. 99 - Raport mbi vëzhgimin e paparalajmëruar të stafit akademik.</i> <i>Evidenca nr. 100 - Formular vlerësimi nga studenti.</i> <i>Evidenca nr. 101 - Formulari i vlerësimit të performancës vjetore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të pedagogut</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime	Rezulton se Universiteti “Luarasi”, në kuadrin e vlerësimit të mbarëvajtjes së cilësisë së programeve të studimit përdor një sërë mekanizmash të vlerësimit dhe rivlerësimit të brendshëm të cilësisë. Për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, NJSBC në fund të çdo semestri organizon pyetësorin studentor, për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo program studimi. NJSBC përpunon pyetësorët e studentëve duke bërë një raportim me vlerësim për stafin akademik dhe kurrikulën e programit të studimit. Drejtuesi i Departamentit bazuar në raportin e NJSBC-së, si dhe raportin e kërkimit shkencor të departamentit, që përpunon të dhënat e vjela nga formularët e vetëvlerësimit të stafit akademik, realizon analizën vjetore të veprimtarisë së departamentit, ku merren vendime për ndryshime në funksion të përmirësimit të cilësisë.

ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	GVJ ka konstatuar se NJBSC si njësi kryesore e mbikqyrjes së cilësisë në UL kryen vlerësime periodike duke përdorur metoda të drejtpërdrejta dhe tërthorta sic janë: - Sondazhet e vlerësimit të mësimdhënies, lëndëve/kurrikulës dhe të të mësuarit; - Sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; - Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit, etj; Në këtë mënyrë të gjithë aktorët e përfshirë në zbatimin e programit të studimit, përfshihen gjithashtu në procesin e vlerësimit të cilësisë së programit si dhe dijeve dhe kompetencave të përfuara nga ky program. Referencë: <i>Evidenca nr. 100 - Formular vlerësimi nga studenti.</i> <i>Evidenca nr. 101 - Formulari i vlerësimit të performancës vjetore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të pedagogut;</i> <i>Evidenca 95 - Politikat e sigurimit të cilësisë në UL;</i>
Konkluzione	<i>UL ka një sistem raportimi që konsiston në llogaritje treguesish sasior dhe cilësor, bazuar në përpunimin e pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, si dhe kurrikulën e çdo programi studimi.</i> <i>GVJ vlerëson kërkesat e lartë që UL ka për cilësinë e mësimdhënies si dhe procedurat e ndjekura për garantimin e saj.</i> <i>Universiteti "Luarasi" në kuadrin e vlerësimit të mbarëvajtje së cilësisë së programeve të studimit përdor mekanizmat e nevojshëm të vlerësimit dhe rivlerësimit të brendshëm të cilësisë</i> <i><u>Sygjerojmë</u> në një punë më të mirë për të rritur numrin e studentëve që plotësojnë anketimin cdo semestër.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni ka ngritur strukturat që garantojnë sigurimin e cilësisë konform legjislacionit dhe rregulloreve përkatëse. Struktura më aktive në këtë proces është NJSBC-ja, e cila bashkëpunon ngushtë me të gjithë strukturat e tjera dhe veçanërisht me njësinë bazë, për përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me standardet e cilësisë së UL-së, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Strukturat e sigurimit të cilësisë kanë për detyrë të garantojnë politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë. Kjo strukturë përfshin personel akademik efektiv, personel ndihmës akademik, studentë si dhe aktorë të jashtëm si lektorë të ftuar apo bashkëpunëtorë në projekte të ndryshme, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Referencë: <i>Evidenca nr. 102 - Raporti vjetor i NJBSC viti akademik 2023-2024;</i> <i>Evidenca 98 - Manual i NJBSC;</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton	Evidentohet se UL ka si prioritet të saj në politikat e garantimit të cilësisë së ofrimit të arsimit të lartë në institucion, gjithëpërfshirjen. Kjo vihet re në strukturat përbërëse të IAL ku marrin pjesë përfaqësues të aktorëve të interesuar ku përfshihen, stafi akademik, stafi ndihmës akademik, staf administrativ, studentë dhe ekspertë të jashtëm, të cilët në bazë të roleve të tyre kanë përgjegjësi përkatëse të sanksionuara në aktet apo urdhërat

ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	e brendshëm që përcaktojnë angazhimin e tyre në strukturat përkatëse. Referencë: <i>Evidenca 98 - Manual I NJBSC;</i> <i>Evidenca 88 - Formulari I vlerësimit të personelit akademik;</i> <i>Evidenca 100 - Formular vlerësimi nga student;</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	UL ka ngritur Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila ka për detyrë monitorimin në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Pranë Fakultetit të Drejtësisë është ngritur Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, i cili përbën njësinë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në nivel të njësisë kryesore. Ky komision ka në përbërje pesë anëtarë, personel akademik pranë Fakultetit të Drejtësisë. Metodatat kryesore të mbledhjes së informacionit për vlerësimin e cilësisë të programeve të studimit janë anketimet dhe intervistat ku përfshihen, studentët, stafi akademik dhe ndihmës akademik si dhe ai administrativ. Referencë: <i>Evidenca 17 - Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë;</i> <i>Evidenca 16- Rregullore e Departamentit të së Drejtës Private;</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konstaton se personeli akademik përfshihet në mënyrë aktive në proceset e vlerësimit të programeve të studimit, duke respektuar të drejtat dhe integritetin akademik të secilit prej tyre dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Përzgjedhja e anëtarëve të grupeve të vlerësimit të brendshëm bëhet me vendim dekanati, me propozim nga anëtarët e këtij Fakulteti. Organizimi i pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi udhëhiqet nga disa parime të rëndësishme, pa krijuar paragjykim. Referencë:

	<i>Evidenca nr. 102 - Raporti vjetor i NJBSC Viti Akademik 2023-2024.</i> <i>Evidenca 4-Vendim Dekani FD, nr.32, date 30.05.2024;</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në funksion të rritjes së cilësisë janë lidhur një sërë marrveshesh në nivel Institucioni dhe në nivel njësie kryesore. Këto marrveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, mundësojnë organizmin e aktiviteteve të ndryshme si trajnime dhe ëorkshop-e, leksione të hapura, organizimin e panairit të punës, etj. Gjithashtu mundësojnë realizimin e praktikave profesionale për studentë, si dhe shpesh luajnë rol aktiv në punësimin e studentëve. Referencë: <i>Evidenca Nr. 90 - VSA nr.22, datë 13.11.2023 "Për Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë".</i> <i>Evidenca Nr. 4 - Urdher Dekani FD, Nr 32, datë 30.05.2024</i> <i>Evidenca 12-Statuti i UL;</i> <i>Evidenca 38 - Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit;</i> <i>Evidenca 52 - Marreveshjet Erasmus tabela;</i>
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se kriteret e parashikuara në këtë standard përmbushen nga IAL në të gjitha elementët e kërkuar në lidhje me aktivizimin e të gjithë aktorëve të interesuar për të marrë pjesë në garantimin e cilësisë së procesit mësimor në IAL.</i> <i>UL garanton dhe përfshin në proceset e vetvlerësimit dhe vlerësimit të cilësisë staf akademik me kohë të plotë dhe të pjesshëm, staf ndihmës akademik, staf administrative, studentë dhe ekspert të jashtëm, të cilët ndihmojnë në sigurimin e një standardi të lartë të cilësisë.</i> <i>Politikat dhe procedurat e sigurimit të cilësisë mundësojnë ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi për të gjithë palët e angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së këtij programi studimi.</i> <i><u>Sygjerojmë</u> në një punë më të mirë për të rritur numrin e studentëve që plotësojnë anketimin cdo semestër</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, si dhe të marrë gjatë vizitës në UL, GVJ konstaton se kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen Eëb të tij, të të gjitha veprimtarive (statute, rregullore) përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti. Personeli akademik përfshihet në mënyrë të drejtpërdrejtë në procedurat dhe veprimtaritë e sigurimit të cilësisë. Bazuar në rezultatet e vlerësimit të performancës UL promovon personelin akademik në pozicione drejtuese, përfshirë dhe mbështetje financiare. Referencë: <i>Evidenca nr. 103 - Formular i vlerësimit të studentëve për lëndën/pedagogun 2018-2019 deri në 2023-2024</i> <i>Evidenca 95 - Politikat e sigurimit të cilësisë në UL;</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Referuar RVB-së, konstatohet që njësia kryesore, FD, në përfundim të çdo viti akademik harton "Raportin vjetor", në të cilin bëhet vetëvlerësimi i brendshëm i veprimtarive akademike, shkencore dhe aktiviteteve jo akademike, ku theksohen gjetjet dhe përcaktohen rekomandime për të ardhmen. Ky raport është pjesë integrale e raportit vjetor institucional që dërgohet në MAS brenda muajit dhjetor, sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Referencë: <i>Evidenca 19 - Raporti vjetor i Veprimtarisë Akademike të FD-s,</i> <i>Evidenca 20 - Raporti Vjetor i Veprimtarisë të UL-s</i>

Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Departamenti përgjegjës për programin e studimit bën vlerësimin e ecurisë së programit të studimit “Master i Shkencave” në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”. Në përfundim të vlerësimit të programit bazuar në rekomandimet e dhëna, Dekanati, sipas rastit, harton politika, të cilat synojnë përmirësimin cilësor të këtij programi studimi. Referencë: <i>Evidenca Nr. 104 - Vlerësimi i programit të studimit nga Drejtuesi i Njesisë.</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Gjatë vizitës që patëm në institucion dhe, specifikisht, në takimet e zhvilluara me drejtuesin e departamentit të së drejtës private dhe dekanin e Fakultetit të Drejtësisë, u konfirmua se programi i studimit “Master i Shkencave” në “E Drejtë Civile dhe Tregtare” do të jetë objekt i analizave, diskutimeve dhe monitorimeve të vazhdueshme. Kjo ka si qëllim që të gjithë palët pjesëmarrëse në program: stafi akademik, studentët dhe partnerët e interesuar të ndërgjegjeshohen për rëndësinë e cilësisë, sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në Institucion GVJ konstaton se veprimtaritë periodike me personelin dhe studentët në funksion të këtij kriteri lidhen me aktivitete informuese me studentët, publikime në faqen Eeb të UL-së, platformën Pitagora, klasat e krijuara në Google Classrom, si dhe publikime në rrjetet sociale të administruara nga departamenti i së Drejtës Private, me qëllim ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të tyre në sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Referencë: <i>Evidenca 88 - Formulari I vlerësimit të personelit akademik;</i> <i>Evidenca 100 - Formular vlerësimi nga student;</i>
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se kriteret e parashikuara në këtë standard përmbushen nga IAL, i cili vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të</i>

	<i>cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</i> <i>Rezulton se UL në mënyrë periodike merr masa dhe plane veprimi për adresimin e rekomandimeve për përmirësimin e cilësisë nga strukturat përgjegjëse për të në institucion, por dhe në përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga struktura të tjera jashtë institucionit, të cilat kërkojnë garantimin e standardit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”

a. Pikat e forta:

1. Partneriteti me aktorë të fuqishëm ekonomik (shoqëri tregtare, OJF, institucione publike etj) nëpërmjet të cilëve siguron zhvillimin e praktikave profesionale për studentët e programit MSHDCT, si dhe garanton mbështetjen e tyre në tregun e punës;
2. Kuadër i plotë rregullator në nivel institucional, që garanton realizimin e politikave dhe procedurave të mbikqyrjes dhe vlerësimit të cilësisë, si dhe një sistem funksional të sigurimit të brendshëm të cilësisë;
3. Funksionaliti i strukturave që shërbejnë për informimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore;
4. Nxitja dhe mbështetja e studentëve për t'u angazhuar në projekte dhe aktivitete kërkimore;
5. Bashkëpunimi mes hallkave të ndryshme të institucionit në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me pranimin e studentëve. Ndjekja e politikave lehtësuese për studentët që vijnë nga disa kategori të veçanta sociale;

6. Kryerja e kërkimeve gjurmuese mbi nivelin e punësimit të studentëve Alumni, dhe administrimi i të dhëna statistikore mbi shkallën e përgjithshme të punësimit të studentëve të këtij programi, si dhe shkallën e përputhjes së punësimit të tyre me profilin e programit të studimit;
7. Vazhdimësia e të njëjtit personel akademik në Programin e studimit Master Shkencor në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”, si dhe eksperiencia profesionale e tyre, si një tregues pozitiv që reflekton jo vetëm përvojë në fushën e së drejtës, por edhe qëndrueshmëri ndër vite në procesin mësimdhënës;

b. Pikat e dobta:

1. Angazhimi në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi si titullarë të lëndëve, përveç personelit akademik te kategorisë “Profesor”, edhe të personelit akademik me gradën shkencore “Doktor” në ndryshim nga parashikim i nenit 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet niveli i kualifikimit akademik për titullarët e lëndëve/moduleve; (*Standarti III.1, kriteri 4*)
2. Literatura e detyrueshme dhe mbështetëse për programin e studimit nuk është e përditësuar me botime të viteve të fundit, si dhe duhet të rritet fondi fizik i bibliotekës; (*Standarti IV.3, kriteri 1 dhe 4*)
3. Në programin e studimit janë përfshirë thuajse në mënyrë të balancuar lëndë të së drejtës tregtare dhe civile nga njëra anë dhe lëndë të një spektri më të gjerë publik nga ana tjetër, ndërkohë që lëndët e grupit të parë do të duhet të ishin pakrahasimisht dominuese në program; (*Standarti II.1, kriteri 7*)

Rekomandime

1. Të rishikohen lëndët e programit duke përfshirë më shumë lëndë që lidhen me fushën tregtare si psh “Qeverisja e korporatave” apo “E Drejtë Tregtare Evropiane”, brenda kufijve të lejuar ligjor për ndryshime;
2. Të merren masa për kodifikimin e lëndëve të programit, të cilat nuk janë ta pajisura me kodin përkatës;
3. Të përditësohet rregullorja e programit të studimit, duke reflektuar në të gjuhën e huaj si kriter hyrës të studentëve;
4. Në përputhje me kriteret ligjore në fuqi, të merren masat për të mundësuar angazhimin si titullarë lëndësh në këtë program studimi të personelit akademik të kategorisë “Profesor”;
5. Të përditësohet literatura e detyrueshme dhe ndihmëse në funksion të programit të studimit, për sa është e mundur, (psh. me artikuj shencorë të botuara në revista shkencore juridike me ISBN); si dhe të sigurohen kopje të kësaj literature në bibliotekën e IAL-së;
6. Institucionin të vërë në dispozicion salla të tjera leximi;

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Civil and Commercial Law",

a. Strengths:

1. Partnership with powerful economic actors (commercial companies, NGOs, public institutions, etc.) ensures the conducting of professional practices for students of the MSHDCT program, as well as guarantees their support in the labor market;
2. A complete regulatory framework at the institutional level guarantees the implementation of quality supervision and assessment policies and procedures, as well as a functional internal quality assurance system;
3. The functionality of structures that serve to inform, advise and support students, under legal provisions and regulatory acts;
4. Encouraging and supporting students to engage in research projects and activities;
5. Cooperation between different bodies of the institution in the implementation of legal and sub-legal acts related to student admission. Pursuing facilitating policies for students coming from certain social categories;
6. Conducting tracking research on the employment rate of Alumni students, and managing statistical data on the overall employment rate of students of this program, as well as the degree of matching of their employment with the profile of the study program;
7. The continuity of the same academic staff in the Master of Science study program in "Civil and Commercial Law", as well as their professional experience, is a positive indicator that reflects not only experience in the field of law, but also consistency over the years in the teaching process;

b. Weak points:

1. Engagement in the teaching process in this study program as course heads, except academic staff of the category "Professor", also of the personnel academician with the scientific degree "Doctor" in contrast to the provision of Article 59/6 of Law No. 80/2015 which determines the level of academic qualification for subject/module teachers; (*Standard III.1, criterion 4*)
2. Mandatory and supporting literature for the study program is not updated with publications of recent years, and the physical fund of the library should be increased; (*Standard IV.3, criteria 1 and 4*)
3. The study program includes, in an almost balanced manner, commercial and civil law subjects on the one hand and subjects of a broader public spectrum on the other, while the subjects of the first group should be disproportionately dominant in the program; (*Standard II.1, criterion 7*)

Recommendations

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

1. Review the syllabus by including more subjects related to the commercial field, such as "Corporate Governance" or "European Commercial Law", within the legal limits for changes;
2. Measures should be taken to codify the curriculum subjects that are not equipped with the appropriate code;
3. Update the study program regulations, reflecting the foreign language as an entry criterion for students;
4. Based on the legal criteria in force, measures should be taken to enable the engagement of academic staff in the "Professor" category as course heads in this study program;
5. Updating the mandatory and auxiliary literature in function of the study program, as far as possible, (e.g. with scientific articles published in scientific legal journals with ISBN); and providing copies of this literature in the HEI library;
6. The institution should make other reading areas available;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

